

Konrad Adenauer Stiftung

IDSCS | Institute for Democracy Societas Civilis -Skopje

# MANUAL PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2017

**EDICIONI I DYTË I PËRDITËSUAR**

**POLITIKË**

# MANUAL PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË 2017

**EDICIONI I DYTË I PËRDITËSUAR**

# Impresum

**Titulli:**
Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë 2017

**Editor:**
Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë
Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup

**Autorë:**
Jane Dimeski
Marko Pankovski

**Koordinimi:**
Davor Pashoski
Johanes D. Rai

**Përkthimi:**
Blerina Starova Zllatku

**Disenji dhe përgatitja:**
Vinsent Grafika

Publikimi mund të shkarkohet falas në:
http://www.kas.de/mazedonien/mk
http://www.idscs.org.mk

**Vërejtje:**
**Qëndrimet e prezantuara në këtë Publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer dhe të Institutit për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup, por janë pikëpamje personale të autorëve.**

# Përmbajtja:


**1. Hyrje në zgjedhjet lokale 2017 — 6**
- Pjesëmarrësit e zgjedhjeve — 16
- Përgatitjet për zgjedhjet lokale 2017 — 17
- Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor — 20

**2. Historiku i zgjedhjeve lokale në Maqedoni (1996 – 2013) — 24**
- Zgjedhjet lokale të vitit 1996 година — 25
- Zgjedhjet lokale të vitit 2000 година — 25
- Zgjedhjet lokale të vitit 2005 година — 26
- Zgjedhjet lokale të vitit 2009 година — 27
- Zgjedhjet lokale të vitit 2013 година — 28

**3. Sistemi zgjedhor i Maqedonisë për zgjedhjet lokale — 32**
- Modeli zgjedhor — 33
- Organe zgjedhore — 34
- E drejta për t'u zgjedhur — 37
- Kufizime për funksionarët aktual — 38
- Numri i anëtarëve të këshillave — 40
- E drejta dhe procedura për paraqitjen e kandidaturave për kryetarë të komunave dhe listave për këshilltarë — 40
- Fushata zgjedhore — 41
- Roli i mediave publike — 44
- Vëzhgimi i zgjedhjeve — 47

**4. Partitë politike dhe koalicionet — 48**
- VMRO-DPMNE — 49
- Bashkimi demokratik për integrim — 52
- Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë — 54
- Opsioni Qytetar për Maqedoni – OPQM — 57
- Lëvizja BESA — 57
- Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve — 58
- Partia Demokratike Shqiptare — 59
- Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni — 61
- Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" (Uniteti, RDK) — 62
- Levica — 63
- Lëvizja Popullore për Maqedoni — 63
- Partia për Prosperitet Demokratik — 64
- Partia politike "Aleanca për Shqiptarët" — 65
- Lidhja e Romëve të Maqedonisë — 66
- Partia Social - Demokrate e Maqedonisë — 67
- Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas - BPRM — 67

**5. Pasqyra e kandidatëve për kryetarë të komunave në zgjedhjet lokale 2017 — 70**

**6. Zgjedhjet Lokale në Republikën e Maqedonisë të vitit 2017 - rezultate, fushata, vlerësime — 136**
- Hyrje — 137
- Fushata zgjedhore dhe financimi — 140
- Media — 145
- Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2017 — 154
- Mbrojtja e të drejtës së zgjedhjes — 158
- Vlerësimi i zgjedhjeve lokale nga vëzhguesit — 160
- Vlerësimi i zgjedhjeve nga partitë politike — 165
- Konkluzione — 169
- ANEKSI 1 - Këshilltarët e zgjidhur nga komunat — 175
- ANEKSI 2 - Këshilltarët e zgjidhur nga komunat — 179

**7. Arkivi zgjedhor i zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë nga viti 1990 deri më sot — 184**

**8. Burime — 188**

# HYRJE NË ZGJEDHJET LOKALE 2017

## HYRJE NË ZGJEDHJET LOKALE 2017

Zgjedhjet lokale, të gjashtat me radhë nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë, do të mbahen më 15 tetor të vitit 2017. Kryetari i Kuvendit, në kuadër të kompetencave të tij ligjore, zgjedhjet lokale i shpalli[1] më datë 6 gusht të vitit 2017.[2] Në zgjedhje do të zgjidhen kryetarët e komunave dhe këshilltarët në 80 vetëqeverisje lokale dhe në Qytetin e Shkupit.

Gjatë mandatit të fundit të vetëqeverisjes lokale, nga muaji mars 2013 deri në muajin maj 2017, numri më i madh i vendeve të kryetarëve të komunave i takonin partisë Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Nacional Maqedonas OBRM-PDUNM (VMRO-DPMNE), e cila fitoi 55 vende të kryetarëve të komunave dhe 559 vende të këshilltarëve. Partia e dytë më e suksesshme, në kontekst të vendeve të kryetarëve të komunave, në këto zgjedhje ishte Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), e cila fitoi 14 pozita të kryetarëve të komunave dhe 176 vende të këshilltarëve. LSDM e fitoi vendin e kryetarëve të komunave në 4 komuna, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2013 fitoi 395 vende të këshilltarëve. Partia e dytë për nga madhësia në elektoratin shqiptar, Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) fitoi dy vende të kryetarëve të komunave dhe 101 vende të këshilltarëve. Përveç këtyre partive, një kryetar komune fitoi Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM), Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni (PPS) dhe një vend e fitoi Lidhja e Romëve në Maqedoni

---

1 Emri i plotë i vendimit është: Vendim për shpalljen e zgjedhjeve lokale për anëtarë të këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarë të komunave dhe për kryetar të komunës së Qytetit të Shkupit

2 ”Zgjedhjet lokale do të mbahen më datë 15 tetor”, Akademik MK. I aksesshëm në: http://www.akademik.mk/lokalnite-izbori-ke-se-odrzhat-na-15-oktomvri/ (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

(LRM). PDTM fitoi 22 vende të këshilltarëve, LRM – 11, ndërsa PPS 7 vende në këshillat e vetëqeverisjeve lokale. Kandidatët e pavarur fituan 2 vende të kryetarëve të komunave dhe 55 vende të këshilltarëve. Vende të këshilltarëve në zgjedhje fituan edhe paritë e tjera politike. partia Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) fitoi 26 këshilltarë, Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (RDM) – 10, Lëvizja Popullore për Maqedoninë (LPM) – 9, Lëvizja për Unitetin Nacional të Turqve (LUNT) – 5, Partia për Ardhmëri Evropiane (PEI) – 5, Forcat e Bashkuara Demokratike të Romëve (FBDR) – 4, Unioni Socialdemokratik (USD) – 3, Partia Liberale (PL) – 2 dhe Partia Socialdemokratike e Maqedonisë (PSDM) - 1.

Në nivel nacional, VMRO-DPMNE ishte në pushtet nga viti 2006, meqë fitoi në katër cikle të njëpasnjëshme zgjedhore parlamentare, edhe atë më 1 qershor të vitit 2008, më 5 qershor të vitit 2011 dhe në 27 prill të vitit 2014. Në zgjedhjet e parakohshme të zhvilluara më 11 dhjetor të vitit 2016 Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 2 vende më shumë të deputetëve në krahasim me Koalicionin e udhëhequr nga LSDM, megjithatë nuk arriti të formoj shumicë parlamentare dhe qeveri.

Së këtejmi, zhvillimit të këtyre zgjedhjeve lokale në vitin 2017 u parapriu një periudhë turbulente dhe dinamike e ndërthurur me shumë kthesa politike, ngjarje dhe trazira. Pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016 kriza disavjeçare politike kulminoi me konstituimin e prolonguar të Parlamentit dhe zgjedhjen e kryetarit të ri të Parlamentit nga shumica e re parlamentare, thuaja se 5 muaj pas zgjedhjeve. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE në këto zgjedhje fitoi 51 mandate të deputetëve, ndërsa Koalicioni i udhëhequr nga LSDM 49. BDI fitoi 10, BESA 5, Aleanca për Shqiptarët (ASH) 3 dhe PDSH 2 vende të deputetëve.[3] Para fillimit të negociatave midis partive për formimin e koalicioneve për përbërjen e qeverisë së ardhshme, liderët e partive të shqiptarëve, ai i BDI – Ali Ahmeti, i BESA – Bilal Kasami dhe i Aleancës për Shqiptarët – Zijadin Sela, më 7 janar 2017 në Tiranë u takuan me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama në të cilin bashkërisht e nënshkruan të ashtuquajturën “Deklarata e partive shqiptare në Maqedoni”, e cila pastaj në publik u bë e njohur si “Platforma e Shqiptarëve” ose “Platforma e Tiranës”. Sipas nënshkruesve, qëllimi i Platformës ishte të siguroj se çështjet e pazgjidhura të shqiptarëve në Maqedoni do të jenë çështje prioritare për qeverinë e ardhshme, pavarësisht se kush do ta formojë. Dokumenti[4] i përgatitur në Tiranë përmbante shtatë pika të cilat përfshijnë kërkesa për barazi në përputhje me Marrëveshjen e Ohrit dhe Kushtetutën; zhvillim të barabartë rajonal; sundimin e së drejtës; krijimin e frymës së mirëbesimit në funksion të marrëdhënieve ndëretnike; zgjidhjen e kontestit me emrin; marrëdhënie të mira me fqinjët dhe integrimin e shpejtë euroatlantik.

Presidenti i Republikës, Gjorge Ivanov, konform kompetencave kushtetuese me 9 janar ia ndau mandatin për formimin e qeverisë së re Nikolla Gruevskit si lider i partisë e cila fitoi më së shumti vende në Parlament. VMRO-DPMNE i filloi menjëherë negociatat me partitë e shqiptarëve, me qëllim të formimit të shumicës parlamentare prej 61 deputetësh dhe qeverisë së re.

Partia BESA doli me qëndrim[5] se nuk do të negocioj për koalicion të mundshëm me partinë VMRO-DPMNE dhe BDI meqë anëtarët e të dy partive janë të inkriminuar në rastet të cilat janë në kompetencë të Prokurorisë Speciale Publike (PSP). Aleanca për Shqiptarët, gjithashtu, refuzoi të negocioj me VMRO-DPMNE siç theksuan për shkak të

3 “Rezultatet nga zgjedhja e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të mbajtura më datë 11 dhjetor të vitit 2016”, Kuvendi i RM. I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/izborni-rezultati-2016.nspx (Vizita e fundit: 29 gusht 2017)

4 “Platforma e përbashkët e partive shqiptare”, Fokus.mk. E aksesshme në: http://fokus.mk/zaednichkata-platforma-na-albanskite-partii/ (Vizita e fundit: 29.08.2017)

5 “BESA nuk negocion me politikanë të inkriminuar”, TV Telma. I aksesshëm në: http://telma.com.mk/vesti/besa-ne-pregovara-so-inkriminirani-politichari (Vizita e fundit: 30.08.2017)

„retorikës antishqiptare të anëtarëve të kësaj partie".[6] BDI e pranoi mundësinë që të negocioj me VMRO-DPMNE si partner shumëvjeçar në qeveritë e kaluara, kështu që ekipet e tyre, më datë 19 janar i filluan negociatat për vazhdimin eventual të koalicionit. Megjithatë, të dyja partitë më 30 janar publikuan se nuk kanë arritur marrëveshje për koalicionim dhe se kanë divergjenca në pozitat e tyre. VMRO-DPMNE doli me qëndrimin se nuk mund t'i tejkalojnë linjat e tyre të kuqe, që kanë të bëjnë me kërkesën e BDI për dygjuhësi në gjithë territorin e shtetit, si dhe me suspendimin e PSP, meqë është shndërruar në instrument partiak të LSDM. VMRO-DPMNE njëkohësisht kërkoi[7] shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare si zgjidhje e vetme për dalje nga kriza. Nga BDI deklaruan se nuk kanë marrë vendim për koalicionim, meqë në debatin e tyre të brendshëm partiak nuk ka pasur argumente të mjaftueshme në favor të koalicionit. Presidenti Ivanov më datë 1 shkurt deklaroi se nuk do t'ia jap mandatin për formimin e qeverisë liderit të LSDM, Zoran Zaevit, si parti e dytë për nga madhësia sipas numrit të vendeve në Parlament, derisa t'i paraqesë nënshkrimet si provë se e ka mbështetjen e shumicës së deputetëve në Kuvend. Ai, mes tjerash, kërkoi edhe garanci[8] se mandatari i ardhshëm do t'i mbroj interesat nacionale dhe do të zbatoj reformë sistemore të sistemit të sigurisë nacionale. Partia BESA dhe PDSH menjëherë reaguan me atë që ato janë të gatshme t'i japin nënshkrimet e deputetëve të tyre, me qëllim që Zaevi ta fitoj mandatin. Nga ana tjetër, LSDM më 6 shkurt i filloi negociatat me BDI për formimin e shumicës dhe qeverisë. Lideri i BDI, Ali Ahmeti, dhënien e nënshkrimeve të deputetëve të BDI e kushtëzoi me garanci të shkruar nga Zaevi, me të cilat LSDM do t'i pranoj kërkesat e "Deklaratës së partive shqiptare". Zaevi, garancitë e kërkuara, ia adresoi BDI-së më 13 shkurt, ndërsa të dyja partitë refuzuan ta publikojnë përmbajtjen e Dokumentit. Më 24 shkurt, BDI ia dërgoi LSDM-së nënshkrimet e deputetëve të tij si mbështetje për Zaevin që ta fitoj mandatin për përbërjen e qeverisë nga Presidenti Ivanov, me çka u sigurua prova se ai e ka mbështetjen e shumicës së deputetëve në Kuvend.

Më 26 shkurt, lideri i VMRO-DPMNE, Gruevski, përmes statusit të rrjetit social Fejsbuk deklaroi se, tanimë një kohë të gjatë shteti është sulmuar nga, siç i quajti, „qendrat e jashtme të fuqishme". Gruevski, theksoi se këto qendra e zbatojnë operacionin, qëllimi i të cilit është ta rrëzojnë VMRO-DPMNE nga pushteti dhe përmes vendosjes së Zaevit ta çlirojnë shtetin dhe ta ndryshojnë emrin dhe identitetin e Maqedonasve. Në statusin e tij ai e thirri popullin në mbrojtje të shtetit.[9] Ditën e ardhshme, më 27 shkurt, Zaevi ia depozitoi nënshkrimet Presidentit Ivanov, me kërkesë që sa më shpejtë ta marr mandatin për formimin e qeverisë së re. Po atë ditë, iniciativa e sapo krijuar "Për një Maqedoni të përbashkët"[10] filloi me protestat e përditshme nëpër rrugë kundër pranimit të "Platformës së shqiptarëve" nga ana e Zaevit, me kërkesë që e njëjta të hidhet poshtë, në mënyrë që të ruhet karakteri unitar i shtetit. Më 1 mars, Ivanovi përsëri refuzoi që t'ia jap mandatin Zaevit me arsyetimin[11] se është shkelur afati kushtetues, si dhe nuk do t'ia ndaj mandatin askujt që negocion për zbatimin e agjendave të shteteve të tjera duke aluduar në Platformën e shqiptarëve. Njëkohësisht, Ivanov, kërkoi edhe gjykim ndërkombëtar të kësaj platforme, e cila siç deklaroi "e rrezikon sovranitetin dhe unitarizmin e Maqedonisë".

6 "Besa dhe Aleanca për Shqiptarët tek Gruevski shohin anti-shqiptarin", Alsat-M. I aksesshëm në: http://www.alsat-m.tv/mk/Беса-и-Алијансата-за-Албанците-во-Груе/(Vizita e fundit: 25.09.2017)

7 "Gruevski nuk arriti të formoj qeveri dhe kërkon zgjedhje të reja", Radio Evropa e Lirë. I aksesshëm në: https://www.slobodnaevropa.mk/a/28266302.html (Vizita e fundit: 30.08.2017)

8 Deklarata pas konsultimeve me partitë politike të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë", Presidenti i RM. I aksesshëm në: http://president.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-07-19-10-40-39/4319.html (Vizita e fundit: 30.08.2017)

9 Deklarata e Nikolla Gruevskit, kryetar i VMRO-DPMNE, Fejsbuk. I aksesshëm në: https://www.facebook.com/NGruevski/posts/10155007364502716 (Vizita e fundit: 30.08.2017)

10 Iniciativa qytetare për Maqedoni të Përbashkët shpalli proklamatë: Erdhi koha për Ilindenin e Katërt, Kurir. I aksesshëm në: http://kurir.mk/makedonija/vesti/graganska-ta-initsijativa-za-zaednichka-makedonija-objavi-proglas-dojde-vreme-za-chetvrtiot-ilinden/ (Vizita e fundit: 30.08.2017)

11 "Fjalimi i Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Dr. Gjorge Ivanov", President i RM. I aksesshëm në: http://president.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-07-19-10-40-39/4353.html (Vizita e fundit: 30.08.2017)

Në këtë periudhë shtetin e vizituan përfaqësues të Komisionit Evropian, Johanes Han Komisar për Zgjerim i BE-së, Frederika Mogerini, Përfaqësuese e Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së dhe Brajan Hojt Ji Zëvendës Ndihmës Sekretar Shtetëror i SHBA, me qëllim që të bëjnë presion për tejkalimin më të shpejtë të krizës, konstituimin e parlamentit të ri dhe formimin e qeverisë së re. Mogerini, gjatë vizitës së saj, u përpoq ta bind Ivanovin që t'ia ndaj mandatin shumicës së re parlamentare për formimin e qeverisë. Në këtë periudhë, përmes një reagimi, u prononcua edhe Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës Ruse.[12] MPJ e Rusisë situatën në Maqedoni e përshkroi si rezultat i ndërhyrjes së NATO dhe BE, me qëllim që Maqedonia ta pranoj "Platformën e Tiranës", e cila mbështetet në hartat e Shqipërisë së madhe. Megjithatë, vizitat e përfaqësuesve të lartë nga jashtë nuk kishin ndonjë ndikim të veçantë mbi protagonistët politikë të shtetit, shumica e të cilëve mbetën në pozitat e tyre.

Më 27 mars të vitit 2017 vazhdoi seanca konstituive e Kuvendit, e cila filloi më 30 dhjetor të vitit 2016, me të cilën kryesonte ish-kryetari i Parlamentit, Trajko Veljanovski nga VMRO-DPMNE. Në ndërkohë deputetët e partive më të mëdha në Parlament, VMRO-DPMNE dhe LSDM nuk paraqitën kërkesë për formimin e grupeve të deputetëve, me ç'rast secili deputet nga radhët e tyre kishte mundësinë t'i anashkaloj kufizimet e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit në lidhje me numrin dhe kohëzgjatjen e diskutimeve. Deputetët e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE e shfrytëzuan këtë mundësi që ta zvarrisin diskutimin dhe pikën për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime, e cila i paraprin zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit deri më 27 prill. Zgjedhja e Kryetarit është e nevojshme në mënyrë që të konvokohet seanca për zgjedhjen e qeverisë së re. Njëkohësisht, gjatë gjithë periudhës vazhduan protestat e përditshme

12 „Comment by the Information and Press Department on the Greater Albania threat to stability in the Balkans", MPB e Federatës Ruse. I aksesshëm në: http://www.mid.ru/en/web/guest/maps/al/-/asset_publisher/U6Ix5jp8oEzV/content/id/2735157 (Vizita e fundit: 25.09.2017)



të iniciativës "Për një Maqedoni të përbashkët", të cilat për çdo ditë përfundonin para godisë së Kuvendit. Protestat, deri në këtë datë, kryesisht u zhvilluan në një atmosferë të qetë. Megjithatë, më 27 prill, pasi që kryesuesi Veljanovski, në orën 17, vendosi ta ndërpres seancën e Kuvendit, shumica e re parlamentare vendosi ta vazhdoj seancën me votim që të kalohet në pikën e radhës të rendit të ditës, përkatësisht në pikën Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit. Deputetët e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE duke bërë përpjekje për ta penguar këtë, e rrethuan dhe e okupuan foltoren në sallën e seancave plenare. Në një atmosferë të tensionuar dhe kaotike, deputetët e shumicës, në pjesën e tyre të sallës, megjithatë, e votuan kalimin në pikën e radhës të rendit të ditës, dhe menjëherë pas kësaj e propozuan dhe e votuan Kryetarin e ri, deputetin Talat Xhaferi nga BDI.

Për shkak të zhvillimit të këtillë të ngjarjeve, një pjesë e protestuesve nga "Për një Maqedoni të përbashkët" të cilët në ato momente ishin para godinës së Parlamentit e shpërthyen gardhin mbrojtës dhe kordonin policor, ndërsa pastaj arritën edhe të hyjnë brenda në objektin e Kuvendit në të cilin ishin deputetët. Në situatën në fjalë, ishte evident reagimi i mefshtë i policisë dhe sigurimit në pengimin e hyrjes në Kuvend. Një pjesë e turmës, e cila hyri në Kuvend, së shpejti sulmoi një pjesë të deputetëve dhe gazetarëve, të cilët në ato çaste ishin në sallën për pres-konferencë të Kuvendit. Në këtë incident u lëndua një pjesë e deputetëve nga shumica e sapo formuar parlamentare dhe disa gazetarë. Në mesin e të lënduarve ishte edhe kryetari i LSDM dhe mandatari i qeverisë së ardhshme Zoran Zaev, ndërsa lëndime më të rënda iu shkaktuan Zijadin Selës lider i Koalicionit "Aleanca për Shqiptarët". Pas këtij sulmi, Sela u transportua në spital ku qëndroi për mjekim disaditor.

Përfaqësuesit e shumicës në Kuvend, të udhëhequr nga LSDM, këtë hyrje të dhunshme në Kuvend të demonstruesve e karakterizuan si "tentativë për vrasje" të deputetëve të tyre, të orkestruar nga VMRO-DPMNE dhe përpjekje që të nxiten përleshje në rrugë midis

qytetarëve, me qëllim që të shpallet gjendje e jashtëzakonshme në vend. Përfaqësuesit e opozitës së re, të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, këtë ngjarje e karakterizuan si "shkelje të Kushtetutës dhe grushtet" të organizuar nga LSDM, ndërkaq demonstruesit kanë qenë të provokuar nga LSDM që të hyjnë në objektin e Kuvendit. Mediat, këtë incident e emërtuan si "e enjtja e zezë". Të gjitha partitë politike dhe komuniteti ndërkombëtar i dënuan ngjarjet e 27 prillit, ndërsa organet e hetuesisë i analizojnë ngjarjet.

Sipas Kodit Zgjedhor,[13] mandatet e këshilltarëve të zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013 duhej të skadonin në muajin prill, ndërsa mandatet e kryetarëve të komunave deri më 15 maj të vitit 2017. Sipas kësaj, zgjedhjet e reja lokale duhej të mbahen në gjysmën e parë të muajit maj 2017. Megjithatë, për shkak të prolongimit të konstituimit të Parlamentit u shkel afati i fundit për shpalljen e zgjedhjeve i cili skadoi më 6 mars.[14] Në mënyrë që të tejkalohen kundërthëniet e mundshme ligjore për shkak të skadimit të mandateve, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Kongresi i Përbotshëm Maqedonas deri në Gjykatën Kushtetuese paraqitën dy nisma[15] për rishikimin e kushtetutshmërisë së neneve nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe nga Kodi Zgjedhor. Me njërën nismë u përfshi neni i Ligjit për vetëqeverisje lokale, me të cilin këshilltarëve iu skadon mandati më herët sesa kryetarëve të komunave dhe kërkohej anulimi i tij meqë ka krijuar mos-barazi midis kohëzgjatjes së mandateve të funksionarëve të zgjedhur në nivel lokal.

13 Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar) (Versioni jozyrtar i përgatitur nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/content /Избори/ИЗБОРЕН%20ЗАКОНИК%20-%20ПРЕЧИСТЕН%20ТЕКСТ_%20МАЈ%202016.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

14 "Zgjedhjet lokale para prolongimit", "Nova Makedonia", 07 mars 2017. I aksesshëm në: http://novamakedonija.com.mk/ NewsDetail?title=Локалните-избори-пред-одложување-&id=cbe251d9-f7b6-4658-a754-e89b0f50ef17 (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

15 Vendim (U. Numër 29/2017-0-0) nga data 10 maj 2017. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë. I aksesshëm në: http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)



Me nismën për Kodin Zgjedhor u kërkua të shlyhet dispozita se zgjedhjet do të mbahen "në gjysmën e parë të muajit maj". Gjykata Kushtetuese, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj, i hodhi poshtë të dyja nismat dhe vendosi se nenet e kontestuar të të dy ligjeve janë në përputhje me Kushtetutën. Një ditë më parë, më 9 maj, Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale - BNJVL[16] në të cilën janë anëtarë të gjitha komunat dhe kryetarët e komunave kërkoi që Kuvendi ta vazhdoj mandatin e funksionarëve të zgjedhur duke pohuar se nëse një gjë e këtillë nuk bëhet, komunat nuk do të mund t'i ushtrojnë funksionet e tyre themelore, ndërsa të gjitha vendimet dhe aktvendimet nuk do të jenë të ligjshme.

Pas ngjarjeve të 27 prillit VMRO-DPMNE refuzoi ta njoh zgjedhjen e Kryetarit të ri të Kuvendit Talat Xhaferi nga BDI, me arsyetimin se gjatë procedurës është shkelur Kushtetuta. Kjo çoi deri në zvarritjen e marrjes formale të funksionit deri më 9 maj kur në Gazetën Zyrtare u publikua Vendimi për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit.

Më 1 maj në Maqedoni sërish arriti Zëvendës Ndihmësi i Sekretarit Shtetëror të SHBA Hojt Ji, i cili u takua me Presidentin Ivanov dhe liderët e partive politike në lidhje me zhvillimet e fundit të ngjarjeve në vend. Kabineti i Ivanov-it pas takimit njoftoi se nëse ka liderizëm të mirëfilltë nga kryetarët e partive parlamentare, pengesat juridike dhe politike për përcaktimin e mandatit për përbërjen e Qeverisë janë të tejkalueshme. Në komunikatën[17] nga kabineti i Presidentit, nga Zaevi u kërkuan garanci për fuqizimin e unitarizmit të shtetit dhe se çdo gjë do të jetë në përputhje me Kushtetutën. Më 17 maj, lideri i LSDM dërgoi garanci me shkrim për mbrojtjen e rendit kushtetues të vendit

16 "BLVNJ: Kuvendi ta vazhdoj mandatin e kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve", Telma, 9 maj 2017. I aksesshëm në: http://telma.com.mk/vesti/zels-sobranieto-da-go-prodolzhi-mandatot-na-gradonachalnicite-i-sovetnicite (Vizita e fundit: 24 gusht 2017)

17 "Takim me Ndihmës Zëvendësin e Sekretarit Shtetëror për Çështje Evropiane dhe të Euroazisë të SHBA, z. Hojt Brajan Ji", Presidenti i RM, 1 maj 2017. I aksesshëm në: http://president.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-09-03-11-41-54/4428.html . (Vizita e fundit: 31.08.2017)

dhe pas kësaj Ivanov ia ndau mandatin[18] për formimin e Qeverisë së re. Parlamenti e vazhdoi punën e tij më 30 dhe 31 maj me seancën për zgjedhjen e Qeverisë së re[19] të mandatarit Zoran Zaev nga LSDM.

Kuvendi, më 1 qershor[20] i miratoi ndryshimet e Kodit Zgjedhor me të cilat termini për mbajtjen e zgjedhjeve lokale u ndërrua nga muaji maj 2017 në tetor të vitit 2017, me ç'rast u vazhdua edhe mandati i këshillave dhe kryetarëve të komunave ekzistues.

## PJESËMARRËSIT E ZGJEDHJEVE

Në zgjedhjet lokale, në mënyrë të pavarur ose në koalicion, si parashtrues të listave të kandidatëve për kryetar të komunave paraqiten 19 subjekte politike, por asnjëri nuk nominon kandidatë për kryetarë të komunave në të gjitha 81 njësitë e vetëqeverisjes lokale. Më së shumti kandidatura paraqiti Koalicioni i udhëhequr nga LSDM – 70, prej të cilave 6 janë femra. Nga partitë më të mëdha VMRO-DPMNE me koalicionin e tij, ndërsa në një rast edhe në mënyrë të pavarur, kanë nominuar gjithsej 68 kandidatë për kryetarë të komunave, prej të cilëve 4 janë femra. BDI ka nominuar 18 kandidatë për kryetarë të komunave, prej të cilëve vetëm një është femër, BESA nominoi 10, prej të cilëve, po ashtu vetëm një është femër, ndërsa PDSH dominoi 7 kandidatë për kryetarë të komunave prej të cilëve asnjë nuk është femër. Partia politike "Aleanca për Shqiptarët" paraqiti 6 kandidatë, Partia Socialdemokrate e Maqedonisë (PSDM) 4 kandidatë, Levica 3, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët, Lëvizja Popullore për Maqedoninë

[18] "Presidenti Ivanov e dorëzoi mandatin për përbërjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë", Presidenti i RM, 17 maj 2017. I aksesshëm në: http://president.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-09-03-11-36-59/4441.html . (Vizita e fundit: 31.08.2017)

[19] "Zgjidhet Qeveria e re e Republikës së Maqedonisë", Qeveria e RM, 1 qershor. I aksesshëm në: http://vlada.mk/node/12802 (Vizita e fundit: 31.08.2017)

[20] "Zgjedhjet lokale do të mbahen më datë 15 tetor", TV Nova, 2 qershor 2017. I aksesshëm në: http://tvnova.mk/vesti/makedonija/lokalnite-izbori-ke-se-odrzhat-na-15-ti-oktomvri/ (Vizita e fundit: 24 gusht 2017)

(LPM) dhe Partia Demokratike e Turqve nga Maqedonia (PDTM) me nga 2 kandidatë, Partia Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM), Lëvizja për Unitetin Nacional të Turqve (LUNT), Opsioni Qytetar për Maqedoninë (OPQM), Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Lidhja e Romëve nga Maqedonia (LRM) me nga një kandidat për kryetar komune. Janë paraqitur gjithsej 26 lista të kandidatëve të pavarur për kryetarë të komunave nga grup zgjedhësish. Nga kandidatët e pavarur vetëm dy janë femra. Nga gjithsej 224 kandidatë për kryetarë të komunave, vetëm 16 janë femra (7%). Për dallim nga norma ligjore, e cila i obligon partitë që çdo i treti kandidatë, në listat e propozuara të kandidatëve për këshilltarë, të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar, një obligim i ngjashëm nuk përcaktohet për kandidatët për kryetar të komunave.[21] Të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje e kanë përmbushur këtë kusht, duke e marrë parasysh atë se nëse obligimet ligjore nuk janë përmbushur administrata zgjedhore do ta hedhë poshtë listën.

Gjithashtu, nga të gjitha partitë, grupet dhe koalicionet gjithsej janë parashtruar 373 lista të kandidatëve për këshilltarë.

## PËRGATITJET PËR ZGJEDHJET LOKALE 2017

Si fillim të përgatitjeve për zgjedhjet mund të konsiderohet ndryshimi në Kodin Zgjedhor në pjesën e nenit 16 ku data e mbajtje së zgjedhjeve nga muaji maj 2017 është zëvendësuar me 15 tetor 2017. Kuvendi i miratoi këto ndryshime më 1 qershor të vitit 2017. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, në kuadër të kompetencave të tij, më 6 gusht i shpalli zgjedhjet lokale. Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 5 shtator e miratoi "Angazhime deklarative për zgjedhje të ndershme dhe demokratike",[22] me të cilat, siç thuhet "angazhohet për avancimin e procesit zgjedhor

[21] Neni 64 nga Kodi Zgjedhor.

[22] "Angazhime deklarative për zgjedhje të lira dhe të ndershme", Qeveria e RM. I aksesshëm në: http://vlada.mk/sites/default/files/Декларативни%20заложби%20за%20слободни%20и%20фер%20избори.pdf (Vizita e fundit: 25.09.2017)

dhe për parandalimin e presioneve mbi qytetarët". Në Deklaratë Qeveria parashikon formimin e trupit koordinativ, i cili do ta kontrolloj respektimin e ndalimeve të cilat burojnë nga Kodi Zgjedhor në periudhën nga shpallja deri në përfundimin e zgjedhjeve. Në Deklaratë, mes tjerash, theksohet edhe ajo se Qeveria do të publikoj një listë me projekte të filluara të cilat janë aktivitete të rregullta dhe rrjedhëse dhe se të njëjtën do ta kërkoj nga të gjitha komunat dhe Qyteti i Shkupit.

Sipas Kalendarit për zbatimin e zgjedhjeve, pjesëmarrësit në fushatë mund të hapnin llogari të transaksionit më së hershmi nga data 8 gusht 2017 (48 orë pas shpalljes së zgjedhjeve), ndërsa më së voni 48 orë pas verifikimit të Listës së kandidatit, përkatësisht Listës së kandidatëve. Llogaritë mbyllen në afat prej 4 muajsh pas përfundimit të zgjedhjeve.

Qysh para fillimit të fushatës zgjedhore, e cila sipas Kodit Zgjedhor filloi më 25 shtator, partitë më të mëdha filluan të promovojnë një pjesë të kandidatëve të tyre për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë. Ndër të parët, që më 3 shtator, Arben Taravari ministër i Shëndetësisë, e konfirmoi kandidaturën për kryetar komune nga radhët e Aleancës për Shqiptarët. LSDM dhe koalicioni më 5 shtator promovuan një pjesë të kandidatëve për kryetarë të komunave të Shkupit dhe Qytetit të Shkupit. Koalicioni i VMRO-DPMNE zyrtarisht filloi t'i promovoj kandidatët e vet për kryetarë të komunave më 13 shtator, kur edhe publikoi një pjesë të emrave për komunat e Shkupit dhe për Qytetin e Shkupit. Pastaj partitë pjesërisht i publikonin edhe emrat e tjerë të kandidatëve për kryetarë të komunave. VMRO-DPMNE procesin e publikimit të kandidatëve e rrumbullakoi me një Konventë të madhe, e cila u mbajt në Shkup më 23 shtator, në të cilën partia i promovoi të gjithë kandidatët bashkë. Lëvizja BESA kandidatët e vet i promovoi më 24 shtator në Sheshin e Tetovës. Nga ana tjetër, BDI, po atë mbrëmje, i publikoi dhe i prezantoi kandidatët e vet në Konventën e cila u mbajt në Shkup. Aleanca për Shqiptarët ngjarjen promovuese e mbajti më 25 shtator në Tetovë. LSDM kandidatët e vet i prezantoi në disa ngjarje më të vogla në nivel lokal.

Grumbullimi i nënshkrimeve para personave të autorizuar nga KSHZ për propozimin e Listës së kandidatit për kryetar komune, përkatësisht Qytetit të Shkupit dhe lista të kandidatëve për anëtarë të Këshillit komunal, përkatësisht për Këshillin e Qytetit të Shkupit nga grup zgjedhësish, fillon në ditën e 15 nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjatë 15 ditë. Afati i grumbullimit të nënshkrimeve para KSHZ filloi më 21 gusht, ndërsa përfundoi më 4 shtator 2017.

Në periudhën kohore nga 21 gusht deri më 9 shtator të vitit 2017, Lista e zgjedhësve ishte në këqyrje publike, me ç'rast çdo qytetar kishte mundësi ta kontrolloj gjendjen e të dhënave të tij. Lista e zgjedhësve i përfshin të gjithë qytetarët e moshës madhore (mbi 18 vjet) me vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë të cilët posedojnë dokumente personale biometrike. Gjithashtu, në Listën e zgjedhësve janë regjistruar shtetas të RM-së të cilët qëndrojnë ose janë me punë të përkohshme jashtë vendit, por posedojnë dokumente të vlefshme të udhëtimit.

Sipas kalendarit, 23 ditë para ditës së zgjedhjeve, KSHZ duhet t'i publikoj listat e kandidatëve për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë në vendvotimet e komunave.[23]

Sipas afateve të përcaktuara ligjore dhe sipas Kalendarit të KSHZ për zbatimin e zgjedhjeve fushata fillon më 25 shtator, ndërsa përfundon më 13 tetor, ndërkaq për rrethin e dytë fushata përfundon më 27 tetor të vitit 2017 në mesnatë.[24]

---

23 Listat e plota të kandidatëve për anëtarë të këshillave dhe kryetarëve të komunave janë të aksesshme në linkun si vijon: https://kandidati.sec.mk/Default.aspx

24 Afati për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e Zgjedhjeve Lokale 2017 për anëtarët e këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarët e komunave dhe për kryetarin e Komunës së Qytetit të Shkupit, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 07 gusht 2017. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zRHM2Qy1ndEM0VHM/view (Vizita e fundit: 05 shtator 2017)

## NDRYSHIMET E FUNDIT TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR[25]

Ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor ishin rezultat i Marrëveshjes së Përzhinos. Në Seancën e 75 të Kuvendit, me procedurë të shkurtuar, u miratua pakoja e ligjeve, përfshirë këtu edhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor[26] të cilët rezultojnë nga Marrëveshja e Përzhinos dhe nga takimi i liderëve, ndërkaq kishin për qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e zgjedhjeve të ndershme dhe legjitime të parakohshme parlamentare. Këto ndryshime kishin të bëjnë me aspektet esenciale të procesit zgjedhor, si vijon:

- Ndalohet shfrytëzimi i hapësirave të zyrave, pajisjeve dhe automjeteve zyrtare të organeve shtetërore për nevojat e fushatës zgjedhore, përveç me akte të veçanta normative.
- Si pjesë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor parashikohet edhe Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike[27] i cili do të nënshkruhet nga partitë politike, pjesëmarrëse në zgjedhje nga dita e shpalljes së zgjedhjeve. Me Kodeksin, pjesëmarrësit obligohen të mos bëjnë presion mbi të punësuarit në administratën publike dhe shtetërore ose mbi institucione të tjera të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Përveç kësaj, Kodeksi ka për qëllim të garantoj se mbështetja, përkatësisht mos-mbështetja e cilësdo parti politike ose kandidati nga ana e qytetarëve, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor nuk do ta shfrytëzojnë si objekt për kërcënim sa i përket vendit të punës ose sigurisë sociale. Për zgjedhjet lokale të vitit 2017, Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 5 shtator të vitit 2017 i miratoi Angazhimet deklarative për zgjedhje të lira në të cilat, mes tjerash, u referohet edhe rekomandimeve të Pribes dhe Marrëveshjeve nga Përzhino nga 2 qershori i vitit 2015 dhe nga 20 korriku i vitit 2016. Sipas kësaj Deklarate parashikohet formimi i trupit koordinativ, i cili do ta kontrolloj procesin e respektimit konsekuent të Kodit Zgjedhor. Me këtë Deklaratë, Qeveria ngarkohet ta publikoj listën e projekteve tanimë të filluara për të cilat janë ndarë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.[28]
- Përbërja e KSHZ u ndryshua, nga 7 anëtarë sa numëronte paraprakisht në 9 anëtarë. Në këtë përbërje bën pjesë kryetari, nënkryetari dhe 7 anëtarë. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KSHZ u ndryshua. Me ndryshimet e reja, 3 anëtarë propozojnë partitë politike në pushtet, me ç'rast partia në pushtet, me numër më të madh të deputetëve në Kuvend, propozon 2 anëtarë, ndërkaq partia e dytë për nga numri i deputetëve në pushtet propozon 1 anëtar. Partitë opozitare propozojnë 3 anëtarë, me ç'rast partia opozitare me numër më të madh të deputetëve në Kuvend propozon 2 anëtarë, kurse partia opozitare e dyta për nga madhësia për nga numri i deputetëve propozon 1 anëtar. Tre anëtarë do të zgjidhen përmes konsensusit, të cilët do ta përfaqësojnë publikun ekspert. Me ndryshimet u inkorporua funksioni Sekretar i Përgjithshëm i KSHZ që ka për qëllim fuqizimin e pjesës administrative. Sekretari i Përgjithshëm nuk bën pjesë në përbërjen e KSHZ dhe nuk ka të drejtë vote.
- Ndryshimet plotësuese të Kodit Zgjedhor përfshijnë edhe dispozita që kanë të bëjnë me Listën e zgjedhësve. KSHZ përcaktohet si institucion i vetëm kompetent për udhëheqjen dhe azhurnimin e Listës së zgjedhësve. KSHZ siguron qasje elektronike deri te Lista e zgjedhësve, në përputhje me aktet normative. KSHZ në ueb

25 KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-2-30.pdf?161206080843

26 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 196 nga 10 nëntori 2015. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com. mk/Issues/63cc34eb402342698f7e82e59629175a.pdf (Vizita e fundit: 09 shtator 2017).

27 Kodeksi për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, nëntor 2016. I aksesshëm në: https://drive.google. com/file/d/0B8ZpCwro9h-zTGdoMmZIZjV4UkE/view (Vizita e fundit: 05 shtator 2017).

28 Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Angazhime deklarative për zgjedhje të lira dhe të ndershme, shtator 2017. I aksesshëm në: http://vlada.mk/sites/default/files/Декларативни%20заложби%20за%20слободни%20и%20фер%20избори.pdf (Vizita e fundit: 25 shtator 2017)

faqen e vet e publikon Listën e zgjedhësve, me ç'rast çdo qytetar ka të drejtë të paraqes kërkesë deri në KSHZ që adresa e tij të mos shpallet publikisht për shkaqe sigurie. KSHZ e azhurnon Listën e zgjedhësve një herë në muaj, ndërsa në çdo 6 muaj shpall thirrje publike deri te qytetarët për këqyrjen e të dhënave të tyre. Gjithashtu, me qëllim të përcaktimit të autenticitetit të Listës së zgjedhësve, çdo anëtar i KSHZ mund të kërkoj të bëhet këqyrje në evidencën e MPB për lëshimin e dokumenteve biometrike, si dhe në bazat e të dhënave dhe evidencave të qytetarëve të organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore. KSHZ miraton Rregullore për metodologjinë e udhëheqjes dhe azhurnimit të Listës së zgjedhësve e cila mbështetet në kontrolle dhe analiza statistikore, kontrolle të kryqëzuara të bazave të ndryshme të të dhënave dhe evidencave, kontrolle të pakufizuara në terren dhe metoda të tjera të njohura adekuate të kontrollit, si dhe Rregullore për metodologjinë për qasje të plotë, kryerje të ndryshimeve dhe shlyerje të të dhënave në Listën e zgjedhësve, si dhe procedurë për zbatimin e kontrolleve në terren me qëllim të azhurnimit të të njëjtës.

- Ndryshimet e Kodit Zgjedhor parashikojnë rritje të procesit të përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar në listat e paraqitura për kandidatë për deputetë dhe për anëtarë të këshillit të komunës dhe Qytetit të Shkupit, nga 33 % aktual parashikohet rritje në 40 %, përkatësisht në çdo tre vende më së paku një vend i përket gjinisë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese edhe më së paku nga një vend në çdo dhjetë vende.

- Në kategorinë prezantimi mediatik, me ndryshimet e Kodit Zgjedhor, për herë të parë numërohen edhe mediat elektronike (internet portalet), të cilat njësoj si edhe mediat radiodifuzive dhe të shkruara, të cilat e mbulojnë procesin zgjedhor, janë të obliguara të punojnë në përputhje me Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, ndalohet financimi dhe donimi i partive politike nga ana e mediave dhe personave të ndërlidhur me ta, si dhe inkorporohet ndalimi për emetimin e reklamave të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor fokusi u vendos mbi mundësimin e qasjes së barabartë dhe të balancuar të parive politike në hapësirën reklamuese.

Në vitin 2017 u bënë dy ndryshime të Kodit Zgjedhor. Fillimisht ndryshimi i Kodit Zgjedhor u bë për shkak të zhvendosjes së datës së parashikuar për zhvillimin e zgjedhjeve lokale nga muaji maj në muajin tetor, me ç'rast Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ua vazhdoi mandatin anëtarëve të këshillave dhe kryetarëve të komunave nga zgjedhjet e zhvilluara më 24 mars të vitit 2013 deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj të këshilltarëve dhe kryetarëve të komunave, në gjysmën e parë të muajit tetor.[29] Më 11 shtator të vitit 2017, u miratua ndryshimi i ri i Kodit Zgjedhor sipas së cilit parashikohet se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e harmonizon përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, më së voni 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.[30]

[29] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 67 nga data 1 qershor 2017.
[30] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 125/17.

# HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË MAQEDONI (1996 – 2013)

## HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË MAQEDONI (1996 – 2013)

**Zgjedhjet e para lokale** në Republikën e pavarur të Maqedonisë u mbajtën në vitin 1996, me ç'rast jehona mesatare e votuesve për zgjedhjen e këshilltarëve të komunave ishte 60.17%, ndërsa për Qytetin e Shkupit 53.20%. Jehona mesatare e votuesve për zgjedhjen e kryetarit të komunave ishte 60.28%, ndërsa për Qytetin e Shkupit 53.20%. Në këto zgjedhje ndodhi anulimi i votimit në disa komuna të caktuara, kështu që këto të dhëna nuk i përshijnë rezultatet e zgjedhjes së kryetarëve të komunave ose anëtarëve të këshillave në gjithsej 9 komuna. Këto zgjedhje lokale u zhvilluan sipas organizmit territorial nga vitit 1996, sipas së cilit u formuan 123 komuna dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë.[31] Së këtejmi, LSDM e fitoi numrin më të madh të vendeve të kryetarëve të komunave 51, VMRODPMNE dhe MAAK-Konservative 27, ndërsa Partia Socialiste 19.[32] Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1 495 288 zgjedhës.

Në **zgjedhjet lokale të vitit 2000** u vërejt një numër i konsiderueshëm i shkeljeve të procesit zgjedhor dhe të standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike. Në këto zgjedhje u vërejt një numër i madh incidentesh, dhunë dhe frikësim të votuesve. Në disa komuna: Gostivar, Tetovë, Llabunishtë, Xhepçishtë dhe Hanet e Mavrovës, gjatë zgjedhjeve ka pasur edhe incidente të armatosura. Në disa vende

---

31 Ligji për ndarje territoriale të Republikës së Maqedonisë dhe përcaktimin e rajoneve të njësive të vetëqeverisjes lokale. "Gazeta Zyrtare e RM"-së, 49 nga 14.09.1996. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/Issues/CAFFB1AA376347A0B1E3044B8FAC16C6.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

32 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet lokale 1996: Rezultatet përfundimtare nga zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave dhe anëtarë të këshillave të komunave dhe Qytetit të Shkupit. Shkup viti 1997. I aksesshëm në: http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/Локални%20избори%201996/5_Извештај%20од%20избори/Извештај%20од%20локални%20избори%201996_ДИК.pdf (Vizita e fundit: 24 shtator 2017)

zgjedhore, në komuna të tjera, kutitë e votimit janë hapur me dhunë dhe janë shkatërruar. Dhuna u përsërit në vende të ndryshme edhe gjatë rrethit të dytë të votimit. Misioni i OSBE/ODIHR ka reaguar për votim grupor në 25% të vendeve që i ka vëzhguar, në 8% ka vërejtur votim të hapur dhe në 5% votim në emër të tjetrit. Pas këtyre zgjedhjeve, KSHZ nuk publikoi rezultate gjithëpërfshirëse dhe të plota për zgjedhjet. Në rrethin e parë, Koalicioni "Bashkë për Maqedoninë", i udhëhequr nga LSDM, fitoi 38% të votave për kryetarë të komunave, Koalicioni i VMRODPMNE dhe Alternativa Demokratike (AD) 27%, PDSH 13%, ndërkaq PPD 6%. Rezultatet finale rezultuan me fitore të Koalicionit të VMRO-DPMNE dhe Alternativës Demokratike "Për ndryshime" në 48% të komunave, përkatësisht ata fituan 59 vende të kryetarëve të komunave, ndërsa Koalicioni i udhëhequr nga LSDM "Bashkë për Maqedoninë" fitoi 32 vende të kryetarëve të komunave.[33] Në këto zgjedhje, të drejtë vote kishin 1 634 859 zgjedhës.[34]

**Zgjedhjet lokale të vitit 2005** sërish nuk i plotësuan standardet kryesore ndërkombëtare për universalizëm, barazi dhe fshehtësi të së drejtës së votës. Për dallim nga zgjedhjet paraprake, në këto zgjedhje nuk pati dhunë, por u vërejt një numër i madh parregullsish në pjesën perëndimore, veriperëndimore të vendit dhe në Shkup. Njëherësh, zgjedhjet e vitit 2005 janë zgjedhjet e para që u zbatuan sipas organizimit territorial të vitit 2004, sipas së cilit u formuan 84 komuna në territorin e Maqedonisë dhe u ruajt statusi i Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.[35] Nga Misioni i OSBE/ODIHR u vërejtën 30 raste të mbushjes së kutive të votimit dhe mbi 50 raste të votimit në emër të tjetrit. Në 9 komuna, në mesin e të cilave edhe Qyteti

33 Ibid

34 OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights. Former Yugoslav Republic of Macedonia Municipal Elections 10 September 2000. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, 2000. I aksesshëm në: http://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2015/09/finalen-izvestaj-OSCE-ODIHR-2000.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

35 Ligji për organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale. "Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 55/2004 nga 16.08.2004. I aksesshëm në: http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=204 (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

i Shkupit, si rezultat i ankesave të cilat kishin të bënin me parregullsi të votimit në rrethin e parë, i njëjti u desh të përsëritet. Në këto vende, po ashtu, duhej të zbatohej edhe rrethi i dytë i votimit, që rezultoi me rreth të dytë të vonuar, i cili u mbajt më 10 prill të vitit 2005. Jehona e votuesve në rrethin e parë ishte 56.36%, në rrethin e dytë më 27 mars ishte 53.66%, ndërsa më 10 prill ishte 35.6%. Në këto zgjedhje fitoi Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, i cili fitoi 36 vende të kryetarëve të komunave. VMRO-DPMNE dhe Koalicioni fituan 21 vende të kryetarëve të komunave, BDI 15, VMRO-PP 3, PDSH 2 dhe Lidhja e Romëve 1. Shtatë kandidatë të pavarur u bënë kryetarë të komunave, në mesin e të cilëve edhe kandidati për Qytetin e Shkupit Trifun Kostovski, i cili u mbështet nga VMRO-DPMNE.[36] Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1 711 293 zgjedhës.

**Zgjedhjet lokale të vitit 2009**, të cilat u mbajtën në ditën e njëjtë me zgjedhjet presidenciale, janë zgjedhjet e para lokale që u zhvilluan në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare dhe standardet e OSBE-së për zgjedhje demokratike. Mirëpo edhe për këto zgjedhje Misioni i OSBE/ ODIHR kishte vërejtje të mëdha në lidhje me frikësimin e votuesve. Raporti vëzhgues flet për frikësimin dhe presionet ndaj votuesve, veçanërisht mbi të punësuarit në administratën publike dhe ndaj shfrytëzuesve të ndihmës sociale, të cilët kanë qenë nën kërcënime që të votojnë për partinë në pushtet.[37] Edhe në zgjedhjet e vitit 2009 është vërejtur votimi familjar, votimi në emër të tjetrit (në 3% të

36 OSBE/ODHR Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Zgjedhjet lokale 12 dhe 27 mars dhe 10 prill 2005. Raporti përfundimtar i Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR. Varshavë, 2005. I aksesshëm në: http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/Локални%20избори%202005/6_Извештаи%20од%20меѓународни%20и%20домашни%20набљудувачи/Финален%20набљудувачки%20извештај%20локални%20избори%202005_Македонија_ОБСЕ-ОДИХР_МКД_оригинал.pdf (Vizita e fundit: 24 shtator 2017)

37 OSBE/ODIHR Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Zgjedhjet lokale 22 mars dhe 5 prill 2009. Raporti përfundimtar i Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR. Varshavë, 2009. I aksesshëm në: http://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/Локални%20избори%202009/6_Извештаи%20од%20меѓународни%20и%20домашни%20набљудувачи/Финален%20набљудувачки%20извештај%20претседателски%20и%20локални%20избори%202009_Македонија_ОБСЕ-ОДИХР_МКД_оригинал.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

rasteve), një person i njëjtë t'u ""ndihmojë" më shumë votuesve (4%), tentativë që të ndikohet mbi votuesit (4%), frikësim i votuesve dhe anëtarëve të këshillave zgjedhorë (KZ) (1%), nënshkrime identike në ekstraktin e Listës së Zgjedhësve (2%) dhe votime të shumëhershme (1%).[38] VMRO-DPMNE ishte fitues në 56 komuna, BDI në 15, LDM në 7, ndërkaq PDSH, DR, PDTM, LR, PSDM fituan nga një kryetar komune. Dy kandidatë të pavarur fituan vende të kryetarëve të komunave. Në këto zgjedhje të drejtë vote kishin 1 792 082 zgjedhës.

Në këtë kontekst rekomandimet prioritare nga viti 2009, të cilat përsëriten në Raportin për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, kërkojnë nga Qeveria të ndërmarr masa dhe të përballet me presionet dhe frikësimet ndaj votuesve. Përveç kësaj, Raporti i ODIHR/OSBE sugjeroi edhe pesë rekomandime të tjera prioritare: të ndahet shteti nga partia; të korrigjohen të gjitha mangësitë dhe dykuptimësitë në Kodin Zgjedhor; rishikim dhe korrigjim të Listës së Zgjedhësve; të ndërmerren masa me të cilat do të zgjidhen konfliktet e interesit ndërmjet personave të përfshirë në politikë, ndërkaq të cilët ushtrojnë kontroll mbi radiodifuzerët privat dhe përcaktimin e afateve brenda të cilëve gjykata duhet të merr vendime sa u përket kundërshtimeve të Këshillit të Radiodifuzionit. Në të dy raportet OSBE/ODIHR apelojnë për rishikimin e Listës së Zgjedhësve, që është njëri nga rekomandimet e përmbushur. Bashkimi Evropian konsideron se Republika e Maqedonisë ka arritur progres në zbatimin e zgjedhjeve dhe i përsëritë konkluzionet dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR. Ambasadori i atëhershëm i SHBA-ve, Filip Riker i vlerësoi zgjedhjet si mirë të realizuara.[39]

**Zgjedhjet lokale të vitit 2013,** u zhvilluan në atmosferë të qetë, duke fituar vlerësime pozitive për zbatimin efikas të tyre edhe pse u vunë në dukje mangësi të caktuara. Mangësitë, në pjesën më të madhe,

38 Ibid
39 Popovski, R. Interview with Philip T. Reeker, U.S. Ambassador to the Republic of Macedonia. X/0 talks show, Kanal 5 TV. 8 qershor 2011



ishin në drejtim të kushteve të pamjaftueshme për sigurimin e një fushe të barabartë të garës midis kandidatëve. Në këtë kontekst, janë shënuar vërejtje në pjesën e mbivendosjes së aktiviteteve shtetërore dhe partiake, financimit të fushatave zgjedhore, kornizës ligjore, si dhe informimit mediatik.[40] Edhe pse në raste të rralla, megjithatë, vërejtjet, gjithashtu, përfshinin shkelje të votimit të fshehtë, votimit familjar dhe shkatërrimit të materialit të fushatës. Vërejtje serioze janë konstatuar tek mediat, në të shumtën e rasteve në drejtim të ndarjes së tyre sipas linjës etnike dhe partiake.[41] OSBE/ODIHR përgatitën një sërë rekomandimesh për tejkalimin e vërejtjeve të theksuara. Rekomandimet e përgjithshme përfshijnë rritjen e saktësisë së Listës së zgjedhësve, mbrojtjen nga frikësimi i zgjedhësve dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Sa i përket financimit, rekomandimet lëvizin në drejtim të ndryshimit të proporcionit të donacioneve, i cili ekziston midis personave juridikë dhe fizikë, precizimit nëse kufizimet e shpenzimeve për fushatë vlejnë edhe për dy rrethet zgjedhore dhe më shumë detaje në raportet e paraqitura.[42] Në pjesën e mediave, rekomandimet janë në drejtim të sigurimit të prezantimit më të balancuar të kandidatëve përmes përmirësimit të Kodit Zgjedhor, Ligjit për veprimtari radiodifuzive dhe adresimit të jokonsekuencave të cilat ekzistojnë midis tyre.[43] Në këto zgjedhje, të drejtë vote kishin 1 743 403 votues, të shpërndarë përmes gjithsej 2976 vendeve zgjedhore. Në këto zgjedhje hyri në fuqi Ligji i ri për vetëqeverisje lokale, me çka për herë të parë zgjidhen kryetarët e komunave dhe këshilltarët në 81 komuna, sepse komunat: Vraneshticë,

40 OSBE/ODHR Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Zgjedhjet lokale 24 mars dhe 7 prill 2013. Raporti përfundimtar i Misionit për Monitorimin e Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR. Varshavë, 2013. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/103832?download=true (Vizita e fundit: 24 gusht 2017)
41 Për më shumë informacione, shih: KAS, IDSCS Manual për zgjedhjet zgjedhore në Republikën e Maqedonisë 2013, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_33811-1522-2-30.pdf?130315120539
42 OSBE/ODHR Zyra e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Zgjedhjet lokale 24 mars dhe 7 prill 2013. Misionit për Monitorimin e Zgjedhjeve i OSBE. Varshavë, 2013. I aksesshëm në: http://www.osce.org/mk/odihr/elections/103832?download=true (Vizita e fundit: 25 gusht 2017)
43 Ibid

Drugovë, Zajas dhe Osllomej iu bashkuan Komunës së Kërçovës.[44] Dalja në këto zgjedhje ishte relativisht e lartë. Në rrethin e parë zgjedhor ajo ishte 67%, ndërsa në rrethin e dytë, i cili u zhvillua në 29 komuna dalja ishte 59%. Rivotim kishte në Komunën e Dollnenit, ndërsa për shkak të rezultateve të anuluara, rivotim të rrethit të dytë kishte në katër komuna: Qendër, Dollnen, Strugë dhe Gjorçe Petrov. Dalja në ditën e tretë zgjedhore ishte 65%.[45] Partia më dominuese e këtyre zgjedhjeve ishte VMRO-DPMNE e cila fitoi më shumë kryetarë të komunave në krahasim me partitë e tjera. VMRO-DPMNE 56, pastaj BDI 14 LSDM 4, PDSH 2, 2 kandidatë të pavarur, ndërkaq LRM, PDTM dhe PPSM nga një kryetar komune, ndërsa u zgjodh edhe një kandidatit i pavarur.[46]

Tabela 1: Jehona në zgjedhjet lokale nga viti 1996 deri në vitin 2013,[47] për rrethin e parë dhe të dytë[48]

| **Viti** | **1996** | **2000** | **2005** | **2009** | **2013** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Jehona** | 60% (51%) | 59% (53%) | 56% (53%) | 57% (43%) | 67% (65%) |

44 MOST, Raporti final, Monitorimi vendor i zgjedhjeve lokale 2015. Shkup. I aksesshëm në: http://most.org.mk/images/MOST/Final%20Report_Local%20Elections%202013_MKD.PDF (Vizita e fundit 25 gusht 2017)

45 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ZGJEDHJE LOKALE 2013: http://www.sec.mk/lokalni-izbori-2013/

46 Për më shumë informacione për rezultatet e zgjedhjeve, shih: KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet lokale të Republikës së Maqedonisë 2013, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_33811-1522-2-30.pdf?130315120539

47 Ibid

48 Përqindja e parë ka të bëjë me jehonën në rrethin e parë, ndërsa e dyta me jehonën e rrethit të dytë. Përqindjet janë rrethuar.

# SISTEMI ZGJEDHOR MAQEDONAS I ZGJEDHJEVE LOKALE

## SISTEMI ZGJEDHOR MAQEDONAS I ZGJEDHJEVE LOKALE[49]

### MODELI ZGJEDHOR

Në Republikën e Maqedonisë, zgjedhjet për **kryetarë të komunave** në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL) zbatohen sipas modelit zgjedhor të shumicës, ndërsa zgjedhjet **për anëtarë të këshillave në njësitë e vetëqeverisjes lokale** sipas modelit proporcional. Zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe për anëtarë të këshillave mbahen, në **çdo katër vjet**, njëkohësisht në të gjitha komunat, në gjysmën e dytë të muajit tetor.[50] Kryetari i Kuvendit zgjedhjet i shpall me akt përkatës, i cili publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", me ç'rast nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më shumë se 90 ditë, përkatësisht më pak se 70 ditë.

**Zgjedhja e kryetarit të komunës** në njësitë e vetëqeverisjes lokale zbatohet sipas **modelit zgjedhor të shumicës**. Për kryetar komune është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicë votash në rrethin e parë të votimit, nëse në zgjedhje kanë dal së paku një e treta e zgjedhësve të regjistruar në Listën e Zgjedhësve të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes lokale. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk e plotëson kushtin e nevojshëm,

---

49 Sipas Kodit Zgjedhor (tekst i spastruar) (Versioni jozyrtar i përpiluar nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: https://www.sobranie.mk/content/Избори/ИЗБОРЕН%20ЗАКОНИК%20-%20ПРЕЧИСТЕН%20ТЕКСТ_%20МАЈ%202016.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017).
Janë marrë parasysh edhe ndryshimet e fundit të datës 01 qershor dhe 11 shtator 2017 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 67/17 dhe 125/17)

50 Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor të muajit qershor 2017, u ndryshua neni 16 paragrafi 1 në të cilin fjalët "në gjysmën e dytë të majit" u zëvendësuan me fjalët "gjysmën e parë të tetorit". Në këtë mënyrë u mundësua Zgjedhjet lokale 2017 të mbahen në gjysmën e parë të tetorit.

zgjedhjet përsëriten në rrethin e dytë për ata dy kandidatë të cilët kanë fituar numër më të madh të votave. Nëse në zgjedhje merr pjesë vetëm një kandidat, ndërkaq i njëjti nuk e fiton shumicën e nevojshme, procedura zgjedhore përsëritet. Rrethi i dytë i votimit zbatohet 14 ditë pas përfundimit të rrethit të parë. Në rrethin e dytë zgjidhet ai kandidat i cili ka fituar numër më të madh të votave.

Gjatë **zgjedhjes së këshilltarëve** në NJVL zbatohet **modeli proporcional**, me ç'rast shpërndarja e mandateve bëhet sipas formulës së D'Hondt-it. Sipas kësaj formule, numri i përgjithshëm i votave të fituara për listat e propozuara të kandidatëve pjesëtohet me vargun e përpjesëtuesve 1,2,3... kështu deri në numrin e anëtarëve të këshillit të cilët zgjidhen në NJVL konkrete. Herësit e fituar në këtë mënyrë radhiten sipas madhësisë, me ç'rast merren parasysh ata herës më të mëdhenj aq sa zgjidhen anëtarë të këshillit. Një listë e kandidatëve fiton aq anëtarë të këshillit sa ka herës më të mëdhenj prej atyre që janë marrë parasysh.

## ORGANE ZGJEDHORE

Organe të cilat i zbatojnë zgjedhjet janë: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), komisionet komunale të zgjedhjeve (KKZ) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhorë (KZ), si dhe këshillat zgjedhorë në përfaqësitë diplomatike-konsullore.[51] Sipas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të parashikuara me Marrëveshjen e Përzhinos,[52] Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përbëhet nga nëntë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me dy të tretën e shumicë së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale me mandat prej pesë vitesh dhe e kanë të drejtën e rizgjedhjes. Anëtarët e KSHZ zgjidhen në afat prej 30 ditësh para skadimit të afatit të përbërjes ekzistuese. KSHZ ka përbërje partiake eksperte, me ç'rast gjashtë anëtarë të tij janë përfaqësues të partive politike të përfaqësuara në Kuvend, ndërsa tre anëtarë zgjidhen sipas propozimit të përbashkët të partive në pushtet dhe partive opozitare, përkatësisht nga radhët e kandidatëve të paraqitur. Së këtejmi, partia në pushtet me numër më të madh të deputetëve propozon dy anëtarë, partia e dytë sipas madhësisë në pushtet propozon një anëtar. Partia më e madhe politike në opozitë propozon dy anëtarë, ndërsa partia e dytë për nga madhësia në opozitë propozon një anëtar. Kryetari dhe nënkryetari i KSHZ zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e anëtarëve të propozuar sipas propozimit të përbashkët nga partitë në pushtet dhe nga ato opozitare, me ç'rast kryetari ose nënkryetari duhet të jetë nga radhët e pjesëtarëve të bashkësisë më të madhe e cila nuk është në shumicë. KSHZ emëron sekretar të përgjithshëm i cili udhëheq me shërbimin profesional i cili i kryen punët profesionale – administrative dhe punët organizative - teknike.[53] Me ndryshimet e fundit të datës 11 shtator 2017, është shtuar nen i ri në Kodin Zgjedhor, në të cilin parashikohet se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e harmonizon përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve me rezultatet e zgjedhjeve të fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më së voni 30 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.[54]

KSHZ është përgjegjëse për **mbajtjen e Listës së Zgjedhësve** në të cilën regjistrohen të gjithë qytetarët që kanë mbushur moshën 18 vjeçare, të cilët kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, duke i përfshirë edhe ata të cilët janë me qëndrim të

[51] Në përfaqësitë diplomatike-konsullore qytetarët të cilët janë me punë ose qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, mund të votojnë vetëm në zgjedhje për zgjedhjen e Presidentit të Republikës dhe deputetëve të Kuvendit të RM, ndërsa në zgjedhjet lokale votohet vetëm në juridiksionin e komunës, përkatësisht Qytetin e Shkupit.

[52] European Comission, Agreement between the four political parties 20 July 2016. I aksesshëm në: http://eeas.europa.eu/archives/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/press_corner/all_news/news/2016/2016-07-20_agreement_en.htm (Vizita e fundit: 24 shtator 2017)

[53] KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshem në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-61-30.pdf?161201145621

[54] Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 125/17.

përkohshëm jashtë vendit, të cilët kanë letërnjoftim të vlefshëm ose dokument të vlefshëm udhëtimi. Në Listën e Zgjedhësve nuk regjistrohen ata qytetarë të cilët e kanë humbur aftësinë e punës me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Komisionet komunale zgjedhore (KKZ), të cilat formohen në nivel të çdo komune, ngarkohen për zbatimin e zgjedhjeve në territorin që është në kompetencë të tyre dhe kryejnë mbikëqyrje mbi punën e këshillave zgjedhorë. Ato përbëhen nga pesë anëtarë, prej të cilëve njëri është kryetar, ndërsa secili nga anëtarët ka zëvendës. Anëtarët dhe zëvendësit e KKZ zgjidhen nga radhët e të punësuarve në administratën shtetërore, publike dhe komunale, me arsim të lartë për mandat prej pesë vitesh. Zgjedhjen e tyre e bën KSHZ sipas zgjedhjes së rastësishme pas pranimit të evidencës me të dhënat për administratën shtetërore dhe komunale, administratën e Qytetit të Shkupit dhe administratës publike.[55]

Përbërja e **këshillave zgjedhorë** paraqet një kombinim të të punësuarve në administratën shtetërore dhe komunale (kryetari, zëvendëskryetari, dy anëtarë dhe zëvendës të tyre), si dhe përfaqësues të partive politike. Një anëtar dhe zëvendësin e tij e propozojnë partitë opozitare, të cilat kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Gjithashtu, nga një anëtar dhe zëvendës të tyre propozojnë partitë që e kanë fituar pushtetin në zgjedhjet e fundit parlamentare. Mandati i anëtarëve të këshillave zgjedhorë është 4 vjeçar. Zgjedhjen e rastësishme të anëtarëve të këshillave zgjedhorë (nga radhët e administratës) e bën KKZ dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit për rajonin për të cilin janë përgjegjës, sipas aktit paraprak të KSHZ-së.[56]

55 KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshem në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-2-30.pdf?161206080843

56 Për më tepër detaje, shih: Udhëzimi për mënyrën e emërimit të anëtarëve të këshillave zgjedhore me propozim të partive politike për Zgjedhjet lokale, të cilat do të zhvillohen më 15 tetor 2017. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zdzFKTTFuTldBTGM/view (Vizita e fundit: 04 shtator 2017)



Në ato komuna, në të cilat jetojnë më së paku 20% të qytetarëve që u takojnë bashkësive jo shumicë, zbatohet principi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat gjatë përbërjes së KKZ-së dhe këshillave zgjedhorë. Ligji parashikon përfaqësim prej më së paku 30% të çdo gjinie në përbërjen e organeve zgjedhore. Anëtarët e KKZ-së dhe të këshillave zgjedhorë nuk mund të jenë funksionarë të zgjedhur ose të emëruar nga Qeveria, Kuvendi dhe persona të punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, Mbrojtjes, Punëve të Brendshme, Sekretariatit Ligjvënës, Entit Shtetëror të Statistikës, Qendrës për Menaxhim me Kriza, shërbimet profesionale të Gjykatës Administrative, KSHZ-së dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

Organet zgjedhore punojnë dhe marrin vendime nëse në mbledhjet e tyre merr pjesë shumica e anëtarëve. Në rast të mungesës së anëtarit të KKZ-së, Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe Këshillit Zgjedhor, në punime marrin pjesë zëvendësit e atyre anëtarëve, po ashtu të zgjedhur nga KSHZ. Vendimet në të gjitha organet zgjedhore merren me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

## E DREJTA PËR T'U ZGJEDHUR

**Kandidat për kryetar të komunës ose për anëtar të këshillit** mund të jetë personi i cili ka mbushur moshën18 vjeçare dhe është i aftë për punë. Personi i cili është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, me dënim pa kusht me burgim prej mbi 6 muajsh, vuajtja e të cilit nuk ka filluar, ose gjendet në vuajtje të dënimit për vepër të kryer penale, nuk mund të jetë kandidat për këto pozita. Përveç këtyre kushteve, kandidati për kryetar komune ose për anëtar të këshillit duhet të ketë vendbanim të përhershëm në NJVL në të cilën kandidohet.

Për dallim nga zgjedhjet e kaluara lokale, për këto zgjedhje lokale nuk ekzistojnë kufizime plotësuese, të cilat ishin parashikuar me Ligjin për përcaktimin e kushtit plotësues për ushtrimin e funksionit publik (i njohur si Ligji për lustracion) sepse ligji tanimë nuk është në fuqi.

## KUFIZIME PËR FUNKSIONARËT AKTUAL

Funksioni anëtar i këshillit dhe kryetar i komunës ushtrohet në mënyrë profesionale dhe ai nuk është në pajtim me funksionin President i Republikës, Kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministër, gjyqtar, prokuror publik, Avokat i Shtetit, Avokat i Popullit dhe me bartës të tjerë të funksioneve të cilët i zgjedh ose i emëron Kuvendi dhe Qeverisa e Republikës së Maqedonisë. Funksioni kryetar i komunës, gjithashtu, nuk është në pajtim me funksionin deputet, me kryerjen e punëve profesionale dhe administrative në organet e administratës shtetërore, me kryerjen e veprimtarive profitabile ekonomike dhe veprimtarive të tjera profitabile, me anëtarësimin në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike, institucioneve publike, fondeve, agjencive, enteve dhe në persona të tjerë juridikë, si dhe me zgjedhjen e përfaqësuesit të kapitalit shtetëror dhe shoqëror në shoqëritë tregtare. Në mënyrë plotësuese, funksioni kryetar i Qytetit të Shkupit dhe funksioni anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit nuk është në pajtim me funksionin kryetar i komunës dhe me funksionin anëtar i këshillit komunal në juridiksionin e Qytetit të Shkupit.

Anëtarë të Qeverisë dhe zëvendësministra, nëse kandidohen për kryetarë të komunave ose këshilltarë të këshillave (e njëjta ka të bëjë nëse janë kandidatë për President të Republikës ose për deputetë), janë të kufizuar në kryerjen e aktiviteteve të tyre në kuadër të funksioneve të cilat i kanë. Ushtruesi i këtij funksioni, i cili është kandidat nuk mund të ketë në dispozicion mjete buxhetore të Republikës, të fondeve publike të komunave dhe Qytetit të Shkupit, mjete të ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe personave të tjerë juridikë të cilët kanë në dispozicion kapital shtetëror, si dhe të objekteve të tjera të cilat kryejnë veprimtari shoqërore (kopshte të fëmijëve, shkolla, fusha sportive dhe ngjashëm). Këta persona nuk mund të bëjnë pagesa të jashtëzakonshme të pagave, pensioneve, asistencës sociale, si dhe pagesa të tjera me mjete buxhetore ose nga fondet publike. Njëkohësisht, këta persona nuk mund të lidhin marrëveshje për tjetërsimin e kapitalit shtetëror e as të nënshkruajnë marrëveshje kolektive. Këto kufizime aktivizohen nga dita e marrjes së vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve për kryetarë të komunave dhe këshilltarë, përkatësisht deri në konstituimin e këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit.

Po ashtu, në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në mbajtjen e tyre nuk mund të fillohet procedurë për punësim ose për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionet publike dhe shtetërore, ndërsa procedurat e filluara pezullohen. Në një periudhë prej 20 ditësh, para fillimit të fushatës zgjedhore, nuk mund të paguhen subvencione të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, të organizohen ngjarje për promovimin e ndërtimit ose lëshimin në përdorim të objekteve për të cilat janë parashikuar financa publike. Ministria e Financave e ka për detyrë të gjitha pagesat buxhetore të cilat nuk janë paga, t'i shpall publikisht në një bazë të veçantë, ndërkaq e ka për detyrë të paraqes raport financiar parazgjedhor i cili do të publikohet në ueb-faqen e tyre.[57]

---

57 Neni 8-a nga Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar) (Versioni jozyrtar i përgatitur nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sobranie.mk/content /Избори/ИЗБОРЕН%20ЗАКОНИК%20-%20ПРЕЧИСТЕН%20ТЕКСТ_%20МАЈ%202016.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017)

## NUMRI I ANËTARËVE TË KËSHILLAVE

Numri i anëtarëve të këshillit të çdo njësie të vetëqeverisjes lokale përcaktohet sipas numrit të popullsisë që jeton në kuadër të tyre. Komunat të cilat kanë deri në 5000 banorë formojnë këshilla të përbërë nga 9 anëtarë, komunat të cilat kanë ndërmjet 5001 dhe 10000 – 11 anëtarë, ato komuna që kanë ndërmjet 10001 dhe 20000 – 15 anëtarë, ato që kanë ndërmjet 20001 dhe 40000 – 19 anëtarë, ndërmjet 40001 dhe 60000 – 23 anëtarë, prej 60001 dhe 80000 – 27 anëtarë, ndërmjet 80001 dhe 100000 – 31 anëtarë dhe mbi 100000 – 33 anëtarë. Këshillin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë 45 anëtarë.[58]

## E DREJTA DHE PROCEDURA PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE DHE LISTAVE PËR KËSHILLTARË

**Të drejtë për paraqitjen e listave të kandidatëve për këshilltarë** dhe kandidatit për kryetar të komunës kanë partitë e regjistruara politike në mënyrë të pavarur ose në koalicion, si dhe grupe të zgjedhësve. Varësisht nga madhësia e NJVL-së, grupet e zgjedhësve duhet të grumbullojnë numër të caktuar të nënshkrimeve: nga 100 nënshkrime për NJVL-të deri në 10 000 banorë, prej më së paku 450 për NJVL-të me mbi 100 001 banorë, ndërkaq për kandidimin për Qytetin e Shkupit nevojiten 1 000 nënshkrime.

Në kuadër të listës së kandidatëve për këshilltarë, në çdo vend të tretë doemos duhet të nominohet kandidat i cili është pjesëtar i asaj gjinie e cila është më pak e përfaqësuar në listë.

[58] Neni 34 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 05/16.



Lista e kandidatëve për anëtar të këshillit dhe për kandidat për kryetar të komunës paraqitet në formular të përcaktuar nga KKZ, më së voni 35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. KKZ-ja i publikon këto lista më së voni 25 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

## FUSHATA ZGJEDHORE[59]

Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe mund të zgjas deri 24 orë para fillimit të zgjedhjeve. Fushatë zgjedhore nuk guxon të zhvillohet në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Fushata zgjedhore për këto zgjedhje lokale do të filloj më 25 shtator të vitit 2017 në orën 00:00. Fushata zgjedhore për rrethin e parë përfundon më 13 tetor 2017 në ora 24:00, ndërsa fushata zgjedhore për rrethin e dytë përfundon më 27 tetor 2017 në ora 24:00.[60]

Organizatorët e fushatës zgjedhore, më së voni 48 orë pas verifikimit të listave të kandidatëve, duhet të hapin llogari të veçantë bankare dhe vetëm përmes saj mund të financohet fushata dhe nuk mund të shfrytëzohet për dedikime të tjera. Së këtejmi, fushata mund të financohet edhe nga pagesa e anëtarësisë së partive politike dhe nga donacionet të cilat nuk mund të jenë më të larta se 3.000 euro për persona fizikë dhe 30.000 euro për persona juridikë. Fushata mund të financohet me para, sende dhe shërbime, vlera e të cilave nuk guxon

[59] Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i përgatitur nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16) I aksesshëm në: https://www.sobranie.mk/content/Избори/ИЗБОРЕН%20ЗАКОНИК%20-%20ПРЕЧИСТЕН%20ТЕКСТ_%20МАЈ%202016.pdf (Vizita e fundit: 28 gusht 2017).
KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-2-30.pdf?161206080843

[60] Kalendari për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve lokale të vitit 2017 për anëtarë të këshillave të komunave dhe për Këshillin e Qytetit të Shkupit, si dhe për kryetarë të komunave dhe për kryetar të Qytetit të Shkupit, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 07 gusht 2017. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zRHM2Qy1ndEM0VHM/view (Vizita e fundit: 05 shtator 2017)

t'i tejkalojë këto shuma. Nëse lartësia e donacionit është më e madhe nga shuma e lejuar, pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë që, në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të donacionit, dallimin ndërmjet vlerës së lejuar dhe të donuar ta bartë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrësit e fushatës zgjedhore kanë të drejtë të shpenzojnë më së shumti deri më 110 denarë për një zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore për të cilën ka paraqitur listë të kandidatëve, 70 denarë më pak sesa që ishte e lejuar në zgjedhjet e vitit 2014.

Fushatat zgjedhore nuk mund të financohen me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, nga mjetet e kompensimeve të shpenzimeve për zgjedhje të cilat i posedojnë organizatorët e fushatës zgjedhore. Nuk mund të financohet as nga mjetet e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, nga mjetet e shoqatave të qytetarëve, komuniteteve fetare, grupeve religjioze dhe fondacioneve, nga mjetet e qeverive të huaja dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe nga mjetet e ndërmarrjeve me kapital të përbashkët ku kapitali i huaj është dominant, por edhe nga burime të paidentifikuara. Me ndryshimet e reja ligjore radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit), si dhe personat e tyre të ndërlidhur nuk guxojnë të financojnë ose t'u dhurojnë partive politike, përfshirë edhe fushata. Së këtejmi, si persona të ndërlidhur konsiderohen anëtarët e familjes, të familjes së bashkëshortit - bashkëshortes ose shokut jashtë martesor, personat të cilët kanë hise në pronësi, personat të cilët marrin pjesë në menaxhim, personat të cilët një periudhë të gjatë kohore me marketing ose me kontratë tjetër realizojnë më shumë se 30 % nga të ardhurat e reklamimit, teleshopingut dhe sponsorimit.[61]

[61] Nocioni "persona të ndërlidhur në mënyrë të saktë është përkufizuar në Ligjin për shërbime meidatike audio dhe audiovizive, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184 nga data 26 dhjetor 2013. I aksesshëm në: http://www.slvesnik.com.mk/ Issues/ b063254742a44129b8dfe1221762ddb4.pdf (vizita e fundit: Vizita e fundit: 5 shtator 2017)

Në rast se kandidatura nuk realizohet, organizatorët e fushatës zgjedhore e kanë për detyrë donacionet e pashpenzuara në afat prej 60 ditësh tua kthejnë donatorëve. Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore e ka për detyrë menjëherë dhe më së voni në afat prej 30 ditësh, nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore, të paraqes raport financiar për mjetet e grumbulluara dhe të shpenzuara gjatë fushatës. Kandidatët e zgjedhur për anëtarë të këshillit, përkatësisht kandidatë për kryetar komune ose të gjithë ata të cilët kanë fituar më së paku 1,5 % të votave nga qytetarët që kanë dalë të votojnë në njësinë zgjedhore kanë të drejtë kompensimi nga buxhet shtetëror në lartësi prej 15 denarë për një votë të fituar. Këto mjete paguhen më së voni deri në tre muaj pas paraqitjes së raportit financiar për fushatën.

Si pjesë të ndryshimeve ligjore të inkorporuara me Marrëveshjen e Përzhinos, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe deri në përfundimin e tyre, radiodifuzerët, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit) nuk guxojnë të publikojnë reklama të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe të gjithë personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike.

Nëse gjatë prezantimeve publike ose raportimeve publike cenohet të drejtat e disa kandidatëve, të njëjtit kanë të drejtë menjëherë të ngrenë procedurë gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Për padi të këtillë gjykata kompetente themelore vendos në afate urgjente, ndërsa vendimi publikohet në mediat publike.

## ROLI I MEDIAVE PUBLIKE[62]

Gjatë fushatës mediat private, duke i përfshirë edhe mediat elektronike (portalet e internetit) dhe servisin radiodifuziv publik e kanë për detyrë të mundësojnë qasje të barabartë për prezantimin e programeve zgjedhore dhe të kandidatëve në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të balancuar. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAA)[63] e ka për detyrë ta monitoroj prezantimin zgjedhor të partive dhe kandidatëve në mediat radiodifuzive dhe elektronike (portalet e internetit) nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e votimit në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve. Në rast të cenimit të parimit të qasjes së barabartë, Agjencia e ka për detyrë të ngre procedurë për kundërvajtje kundër medias përgjegjëse.

Redaktorë, gazetarë, udhëheqës të programeve dhe prezantues, të angazhuar në përgatitjen e programeve të radiodifuzerëve nuk guxojnë të marrin pjesë në aktivitete parazgjedhore të partive politike, koalicioneve, grupeve të zgjedhësve dhe përfaqësuesve të tyre, përkatësisht të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore. Nëse vendosin të marrin pjesë në aktivitete të kësaj natyre, angazhimi i tyre në programet e radiodifuzerëve iu pezullohet nga dita e shpalljes deri në përfundimin e zgjedhjeve.

Difuzeri publik, Radiotelevizioni Maqedonas (RTVM), e ka për detyrë pa kompensim t'i njoftojë qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. RTVM duhet të sigurojë qasje të balancuar në programin informativ. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor sipas Marrëveshjes nga Përzhino, kjo nënkupton se 30 % e programit duhet t'i referohet ngjarjeve nga vendi dhe bota, 30 % aktiviteteve të partive të përfaqësuara në pushtet, 30 % të kohës për aktivitetet e partive në opozitë dhe 10 % të kohës për aktivitetet e partive politike jashtëparlamentare.

Gjatë kohës së fushatës zgjedhore RTVM e ka për detyrë të transmetojë prezantim politik falas pjesëmarrësve në procesin zgjedhor në përputhje me parimin e balancit, përkatësisht proporcionalitetit sipas numrit të listave të verifikuara të kandidatëve për deputetë, ndërsa Kanali i Kuvendit duhet të sigurojë prezantim politik falas në kohëzgjatje prej tre orësh edhe për opozitën edhe për partitë në pushtet, në përputhje me rezultatet nga zgjedhjet e fundit parlamentare, dhe një orë për paraqitësit e listave të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvend. Së këtejmi, prezantimi politik falas duhet të shënohet në mënyrë përkatëse dhe të dukshme si "prezantim politik falas" gjatë gjithë kohëzgjatjes së transmetimit. Për dallim nga RTVM, radiodifuzerët nuk guxojnë të transmetojnë prezantime politike falas nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e tyre.

Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore ndalohet reklamimi politik falas. Nga dita e njëjtë ndalohet edhe publikimi i reklamave të financuara nga buxheti shtetëror dhe komunal. Në periudhën e njëjtë, radiodifuzerët e kanë për detyrë ta incizojnë programin e tyre, ndërsa incizimet t'i ruajnë më së paku 30 ditë pas përfundimit të zgjedhjeve, me qëllim që t'ia dërgojnë ASHMAA nëse ajo i kërkon.

---

[62] Kodi Zgjedhor (tekst i spastruar), versioni jozyrtar i përgatitur nga Shërbimi Profesional i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16). I aksesshëm në: http://www.sec.mk/izboren-zakonik/ (Versioni i fundit: 4 shtator 2017).
KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-2-30.pdf?161206080843

[63] Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë". 184/2013. I aksesshëm në: http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0697/Zakon_za_audio_i_audiovizuelni_uslugi_132_2014.pdf (Vizita e fundit: 05 shtator 2017).

Mediat duhet të përcaktojnë listë të çmimeve[64] për reklamimin politik në afat prej pesë ditësh nga shpallja e zgjedhjeve dhe t'i shpallin publikisht, ndërkaq të njëjtat nuk guxon të ndryshohen gjatë fushatës. Radiodifuzerët të cilët i mbulojnë zgjedhjet mund të transmetojnë më së shumti 18 minuta kohë shtesë për reklamim për orë reale program të transmetuar të dedikuar kryesisht për reklamime politike falas, me ç'rast veçanërisht për partitë politike në pushtet dhe për partitë opozitare parlamentare mund të ndajnë më së shumti nga tetë minuta, ndërsa për partitë parlamentare politike, të cilat nuk kanë grup deputetësh dhe për partitë politike jashtëparlamentare, mund të ndajnë nga një minutë. Kur ekziston interesim për bashkimin e blloqeve për kohën shtesë për reklamim të një partie politike në dy orë reale të njëpasnjëshme, media duhet të siguroj përfaqësim të alternuar të partive politike nga pushteti dhe opozita, në dy orë. Radiodifuzerët dhe mediat e shkruara e kanë për detyrë të paraqesin raport për hapësirën e reklamimit të shfrytëzuar nga secili prej pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore dhe për mjetet e paguara ose të cilat duhet të arkëtohen mbi këtë bazë.

Rezultatet e sondazhit të opinionit publik në lidhje me kandidatët nuk guxon të publikohet përmes mediave publike gjatë 5 ditëve të fundit para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Gjatë publikimit të rezultateve nga sondazhi i opinionit publik, lidhur me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, mediat e kanë për detyrë t'i theksojnë të dhënat për emrin e porositësit i cili e ka kërkuar dhe paguar sondazhin, emërtimin e institucionit që e ka realizuar sondazhin, metodologjinë e aplikuar, madhësinë dhe strukturën e modelit të sondazhit dhe periudhën brenda së cilës është zbatuar sondazhi. Rezultatet e sondazhit të opinionit publik, të zbatuar në ditën e zgjedhjeve nuk guxon të publikohen para orës 19:00, përkatësisht para mbylljes së vendeve të votimit.

[64] Listat e çmimeve të mediave për reklamimin e paguar politik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor për zgjedhjet lokale të vitit 2017 janë të aksesshme në ueb-faqen e KSHZ, në linkun në vijim: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zTVJ4cmlUYzFWUFU/view (Vizita e fundit: 27 shtator 2017)



## VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE[65]

Të drejtë vëzhgimi të zgjedhjeve kanë organizatat e akredituara vendore, të huaja dhe ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, me ç'rast autorizimin për vëzhgim e lëshon KSHZ. Akreditim për vëzhgues mund të marrin edhe organizata qytetare vendore të regjistruara së paku një vit para mbajtjes së zgjedhjeve, të cilat në statusin e tyre e kanë inkorporuar parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Paraqitësit e listave, gjithashtu, kanë të drejtë që përfaqësues të autorizuar prej tyre ta monitorojnë punën e organeve zgjedhore.

[65] KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-2-30.pdf?161206080843

# PARTITË POLITIKE DHE KOALICIONET

## PARTITË POLITIKE DHE KOALICIONET[66]

### VMRO-DPMNE

VMRO-DPMNE është parti e cila deklarohet si parti popullore e qendrës së djathtë, me proveniencë ideologjike demokristiane. Në vitin 2017 partia paralajmëroi se do t'i ruaj vlerat e veta, megjithatë do të fokusohet në legjitimimin më të gjerë si parti e djathtë qytetare. Nga pavarësimi e deri më sot, VMRO-DPMNE është njëra nga dy partitë më të mëdha në Maqedoni. Ka marrë pjesë thuaja se në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale, me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1994, kur e bojkotuan rrethin e dytë. Në zgjedhjet e treta parlamentare të mbajtura në vitin 1998 me 49 mandate të fituara, në koalicion me Alternativën Demokratike, e cila fitoi 13 deputetë, dhe PPDSH-PPD (më vonë PDSH) me 11 mandate, si dhe disa parti më të vogla, VMRO-DPMNE për herë të parë formoi Qeveri. VMRO-DPMNE mbeti në pushtet deri në vitin 2002, por gjatë kohës së konfliktit, nga muaji maj deri në nëntor të vitit 2001, u formua Qeveria e koalicionit të gjerë, e cila përfshiu edhe ministra nga LSDM dhe PLD. Në vitin 2002 VMRO-DPMNE bashkë me partnerët e Koalicionit fitoi 33 mandate të deputetëve, i humbi zgjedhjet dhe funksiononte si opozitë deri në vitin 2006. Në vitin 2006 bashkë me Koalicionin "Për një Maqedoni më të

66 Logo-t e partive janë marrë nga internet – faqet e partive përkatëse. Për të gjitha logo-t dhe fotografitë si burim është shfrytëzuar interneti. Për shkak të mungesës të të dhënave zyrtare për disa parti të caktuara politike nuk janë prezantuar informacione të plota për kontakt.
Radhitja e partive politike është bërë sipas alfabetit. Fillimisht janë prezantuar tre partitë më të mëdha parlamentare, pjesëmarrëse në zgjedhje.
Të gjitha rezultatet zgjedhore janë marr nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Të aksesshme në: http://www.sec.mk/izbori-arhiva/

mirë" sërish fitoi në zgjedhjet parlamentare duke fituar gjithsej 45 vende të deputetëve dhe formoi Qeveri. Në këto zgjedhje, partia për herë të parë doli me program konkret dhe me afate konkrete, e që ishte risi në garat zgjedhore. Që atëherë e deri më sot VMRO-DPMNE fitoi edhe në tre cikle zgjedhore, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008, 2011 dhe 2014. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 bashkë me Koalicionin "Për një Maqedoni më të mirë" fitoi 63 vende rekord të deputetëve. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011 bashkë me Koalicionin kjo parti fitoi gjithsej 56 vende të deputetëve. VMRO-DPMNE në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 fitoi 52 deputetë, ndërsa bashkë me partnerët e Koalicionit kishte 61 deputetë nga gjithsej 123 vende në Kuvend. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2016, VMRO-DPMNE fitoi 51 vende të deputetëve, me ç'rast është partia më e përfaqësuar politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Megjithatë, për shkak të koalicionit të lidhur midis LSDM dhe BDI, VMRO-DPMNE kaloi në opozitë.

Nga themelimi deri në vitin 2003 kryetar i VMRO-DPMNE ishte Lubço Georgievski. Në Kongresin partiak të mbajtur më muajin maj 2003, Georgievski dha dorëheqje, ndërsa në vendin e tij u zgjodh Nikolla Gruevski, i cili në krye të kësaj partie është deri më sot. Nga viti 2006 deri në janar të vitit 2016 Gruevski ishte kryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Në zgjedhjet e para lokale të vitit 1996, VMRO-DPMNE bashkë me MAAK-konservatore, fituan 27 komuna. Në zgjedhjet e ardhshme lokale të vitit 2000 fitoi 59 vende të kryetarëve të komunave, por në vitin 2005 humbi 37 vende, përkatësisht bashkë me partnerët e Koalicionit dhe mbështetjen e kandidatit të pavarur për Shkupin fitoi 22 vende të kryetarëve të komunave. Në zgjedhjet e ardhshme lokale, të mbajtura në vitin 2009 fitoi 56 vende të kryetarëve të komunave dhe bindshëm kthehet në pushtet në nivelin lokal. Me rezultatin e zgjedhjeve lokale të vitit 2009, VMRO-DPMNE u imponua si parti dominante në pushtet, në nivel nacional dhe lokal. Në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2013, Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 57 vende të kryetarëve të komunave nga gjithsej 80 komuna, përfshirë këtu edhe Qytetin e Shkupit. Partia, gjithashtu, fitoi 537 vende të këshilltarëve në 68 komuna.




Për këto zgjedhje lokale, Koalicioni i VMRO-DPMNE përbëhet nga 18 parti:[67] VMRO-DPMNE (VMRO – Partia Demokratike për Unitetin Maqedonas Nacional), Partia Socialiste e Maqedonisë, Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Opsioni Qytetar për Maqedoni-OPQM, Lidhja e Romëve të Maqedonisë, Partia e Drejtësisë, Partia e Aksionit Demokratik e Maqedonisë, Partia e Vllahëve të Maqedonisë, Partia Punëtore Bujqësore e Republikës së Maqedonisë, Partia e Re Liberale, Partia e Demokratëve të Bashkuar të Maqedonisë, Aleanca Maqedonase, Partia Demokrate e Turqve të Maqedonisë, VMRO-PD (VMRO-Partia Demokrate), Aksioni Maqedonas (MAAK), Forcat Demokratike të Romëve, Romët e Bashkuar të Maqedonisë, Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve, Lidhja e Forcave të Majta të Titos.[68]

**VMRO-DPMNE**
Sheshi VMRO 1
1000 Shkup
contact@vmro-dpmne.org.mk
www.vmro-dpmne.org.mk

67 Përbërja e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka ndryshime minimale në komuna të ndryshme, ndërsa në komunën e Tearcës, VMRO-DPMNE në mënyrë të pavarur ka nominuar kandidat të vet për kryetar të komunës. Përveç Komunës së Tearcës, në kuadër të të gjitha koalicioneve të ndryshme, VMRO-DPMNE me kandidatë të vet do të garoj edhe në 67 komuna dhe në Qytetin e Shkupit.

68 Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë. I aksesshëm në: http://crm.com.mk/DS/default.aspx?MainId=3 (Vizita e fundit: 20 shtator 2017)

## BASHKIMI DEMOKRATIK PËR INTEGRIM

Bashkimi Demokratik për Integrim u formua nga ish-pjesëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila e filloi konfliktin e armatosur në vitin 2001. Nga aspekti ideologjik, BDI deklarohet si parti e qendrës së majtë, e cila angazhohet për të drejta më të mëdha të shqiptarëve dhe për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Partia u themelua në vitin 2002 dhe për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të po atij viti, në të cilat fitoi numrin më të madh të votave në mesin e elektoratit etnik shqiptar, me ç'rast siguroi gjithsej 16 vende të deputetëve dhe i bë pjesë e Qeverisë së udhëhequr nga LSDM. BDI ishte pjesë e Qeverisë nga viti 2002 deri në vitin 2006, me ç'rast u përfaqësua me numër më të madh të ministrave që deri atëherë i kishte fituar një parti shqiptare në Qeverinë e RM. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, BDI përsëri e fitoi numrin më të madh të votave në mesin e elektoratit shqiptar (12,2 %) dhe 17 vende të deputetëve, megjithatë pas negociatave të pasuksesshme me VMRO-DPMNE nuk u përfshi në Koalicionin e atëhershëm qeveritar. Si rezultat i kësaj, BDI e bojkotoi punën e Kuvendit një periudhë më të madhe, nga viti 2006 deri në vitin 2008, kur edhe u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2008 BDI fitoi 12,8 % të votave dhe 18 vende të deputetëve, dhe si parti më e madhe politike, e cila i përfaqëson shqiptarët etnikë, hyri në Qeveri në krye të së cilës ishte Nikolla Gruevski. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2011, BDI është përsëri parti e tretë për nga madhësia në Maqedoni duke fituar 14 vende të deputetëve. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 BDI fitoi 19 vende të deputetëve dhe e formoi Qeverinë bashkë me VMRO-DPMNE. Në zgjedhjet e kaluara parlamentare, të zhvilluara në vitin 2016, BDI shënoi rezultat dukshëm më të dobët, duke fituar vetëm 10 deputetë, pjesërisht për shkak të rritjes së Aleancës për Shqiptarët dhe BESA, si dhe për shkak të kalimit të votave në drejtim të LSDM. Megjithatë përmes koalicionimit me LSDM, BDI përsëri është pjesë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Nga themelimi i saj e deri më sot kryetar i partisë është Ali Ahmeti.

Deri më sot, BDI ka marrë pjesë në dy cikle zgjedhore për pushtetin lokal. Edhe në zgjedhjet e vitit 2005 edhe në ato të vitit 2009, BDI fitoi 15 vende të kryetarëve të komunave, por në vitin 2009 e humbi Tetovën dhe Gostivarin, komuna këto me shumicë të popullsisë etnike shqiptare. Pas zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013, BDI ka 14 kryetarë të komunave nga gjithsej 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit.




BDI në zgjedhjet lokale do të garoj si parti e pavarur me kandidatë të vet në 18 komuna, ndërsa në Manastir, Gazi Babë dhe Ohër do të dalin me lista të përbashkëta të këshilltarëve me BESA dhe Aleancën për Shqiptarët.

**Bashkimi Demokratike për Integrim**
Rr. "Reçicë e Vogël
1200 Tetovë
tel. 044 334 398
press@bdi.mk
bdi.mk

## LIDHJA SOCIALDEMOKRATE E MAQEDONISË

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti e qendrës së majtë, me proveniencë ideologjike socialdemokrate. Ajo aktualisht është partia e dytë për nga madhësia në Maqedoni. U themelua në Kongresin e mbajtur më 21 prill 1991 si trashëgimtare juridike e Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik (LKM - PTD). Po atë vit, partia e ndryshon emrin në LSDM dhe ideologjinë nga komuniste në socialdemokrate. Ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale nga pavarësia deri më sot. Në vitin 1992, pas shpërndarjes së Qeverisë së parë të ekspertëve, LSDM edhe pse nuk kishte shumicë në Kuvend e fitoi mandatin dhe e formoi Qeverinë e parë politike të Republikës së Maqedonisë. Në periudhën kohore nga viti 1994 deri në vitin 1998 partia e kishte edhe shumicën në Kuvend kur bashkë me partnerët e saj të koalicionit në zgjedhjet e vitit 1994 fitoi 85 vende të deputetëve, por pastaj në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998 e humbi pushtetin duke fituar 27 vende të deputetëve. LSDM është partia më e madhe opozitare deri në vitin 2002, kur përsëri fitoi në zgjedhje me 60 vende të fituara të deputetëve bashkë me partnerët e koalicionit, kështu që ishte në pushtet deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2006. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 Koalicioni i LSDM fitoi 32 vende të deputetëve. Që atëherë, LSDM është në opozitë, pasi që i humbi zgjedhjet edhe në tre cikle zgjedhore, në vitin 2008, 2011 dhe në vitin 2014. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008, bashkë me koalicionin fitoi 27 vende të deputetëve, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, LSDM me koalicionin fitoi 42 vende të deputetëve. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, LSDM fitoi 27 vende të deputetëve, ndërsa me koalicionin gjithsej 34 vende të deputetëve. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, LSDM fitoi 49 vende të deputetëve, me ç'rast në masë të konsiderueshme e përmirësoi rezultatin e vet nga zgjedhjet paraprake parlamentare në të cilat fitoi 34 vende të deputetëve. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM edhe pse fitoi dy deputetë më pak nga Koalicioni i VMRO-DPMNE, prapë se prapë, arriti të formoj Qeveri përmes krijimit të shumicës parlamentare bashkë me BDI dhe Aleancën për Shqiptarët.

Kryetar i partisë, nga pavarësia e shtetit dhe transformimi nga LKM-PTD në LSDM në vitin 1991 e deri në vitin 2004 ishte Branko Cërvenkovski. Nga kjo pozitë u tërhoq për shkak të fitores në zgjedhjet e jashtëzakonshme presidenciale të vitit 2004 kur edhe u bë President i RM. Në Kongresin e jashtëzakonshëm të LSDM në nëntor të vitit 2004 për kryetar u zgjodh Vllado Buçkovski, i cili ishte në krye të partisë deri në humbjen në zgjedhjet e vitit 2006. Pas zgjedhjeve, Buçkovskit iu votua mosbesim dhe në Kongresin e jashtëzakonshëm në nëntor të vitit 2006 për kryetare u zgjodh Radmilla Shekerinska. Në pozitën e kryetares së LSDM, Radmilla Shekerinska qëndron deri në qershor të vitit 2008 kur edhe jep dorëheqje të parevokueshme për shkak të humbjes në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në shtator të vitit 2008 në Kongresin e 8 të kësaj partie për u.d. kryetar u zgjodh Zoran Zaevi. Në vitin 2009, pas skadimit të mandatit të kryetarit në Kongresin partiak, sërish në krye të LSDM kthehet Branko Cërvenkovski. Ai do të jetë lider i partisë deri në vitin 2013, kur edhe tërhiqet nga pozita, ndërsa në vendin e tij përsëri zgjidhet kryetari aktual i partisë Zoran Zaevi.

Në zgjedhjet lokale të vitit 1996 LSDM fitoi 54 vende të kryetarëve të komunave, me ç'rast ishte partia me më shumë mandate të fituara në ato zgjedhje. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 32 vende të kryetarëve të komunave, ndërsa në vitin 2005 suksesi shënon rritje dhe LSDM fitoi 36 vende të kryetarëve të komunave, me çka u bë parti dominante për nga numri i kryetarëve të komunave. Në vitin 2009, LSDM humbi një numër të madh të

komunave në të cilat ishte në pushtet, fitoi 6 vende të kryetarëve të komunave plus një vend të kryetarit të komunës, si pjesë e Koalicionit. Pas zgjedhjeve të fundit lokale të vitit 2013, LSDM e ka pushtetin në 4 nga gjithsej 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit.

Në këto zgjedhje lokale, koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) me kandidatë për kryetarë komune do të paraqitet në 70 komuna. Koalicioni përbëhet nga 22 parti politike: Partia e Re Socialdemokrate-PRSD, Partia Liberal Demokrate - PLD, Lidhja Demokratike e Vllahëve në Maqedoni – LDVM, Alternativa e Re – AR, Partia e Pensionistëve dhe Qytetarëve të Bashkuar të Maqedonisë – PPQBM, Unioni Socialdemokratik – USD, Partia Liberale e Maqedonisë – PL, Lidhja Demokratike – LD, Partia Përparimtare Serbe në Maqedoni – PPSM, Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë – RDM, Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve në Maqedoni – PERM, Partia Politike Dinjiteti – PPD, Partia për Ndryshime Ekonomike – PNE 21, Aleanca për Maqedoni Pozitive – AMP, Partia për Ardhmëri Evropiane – PAE, Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni – PLT, Partia Serbe në Maqedoni - PSM, Partia Demokratike e Romëve – PDR, Partia e Bashkuar për Barazinë e Romëve - PBBR, të Bashkuar për Maqedoni – BM, Organizata për Bashkimin Reformator Maqedonas-Partia Punëtore-OBRM.[69]

**Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë**
Rr. "Bihaqka" nr.8
1000 Shkup
web@sdsm.org.mk
www.sdsm.org.mk

69 Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë. I aksesshëm në: http://crm.com.mk/DS/default.aspx?MainId=3 (Vizita e fundit: 20 shtator 2017)



## OPSIONI QYTETAR PËR MAQEDONI - OPQM

Opsioni Qytetar për Maqedoni (OPQM) është parti politike e qendrës, e cila është formuar në vitin 2014. Kryetar i partisë dhe themelues i saj është Stevçe Jakomovski. Partia për herë të parë mori pjesë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 kur kandidat i saj ishte Zoran Popovski, i cili fitoi 3,6% nga numri i përgjithshëm i votave. Në zgjedhjet parlamentare të po atij viti, partia u paraqit e pavarur, me ç'rast fitoi një vend të deputetit. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, partia OPQM është pjesë e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DMNE. Këto zgjedhje lokale do të jenë zgjedhjet e para për këtë parti, e cila do të garoj e pavarur me kandidat të vet për kryetar komune në komunën e Karposhit.

**Opsioni Qytetar për Maqedoni - OPQM**
Rr. "Franklin Ruzvelt" nr. 5-a,
1000 Shkup
info@grom.mk
www.grom.mk

## LËVIZJA BESA

Partia politike Lëvizja BESA u themelua më 23 mars të vitit 2015 në Shkup. Lëvizja BESA ka për qëllim t'i promovoj interesat e të gjithë qytetarëve dhe veçanërisht të shqiptarëve. Përcaktimet kryesore bazohen mbi barazinë, drejtësinë, lirinë dhe mirëqenien. Lëvizja si pikënisje e ka organizimin asimetrik të shtetit ndaj popujve të vet. Në vend të asimetrisë, shteti

duhet të bazohet mbi: parimet e lirisë, barazisë, drejtësisë, mirëqenies, luftës kundër korrupsionit. Për ti arritur këto qëllime, BESA angazhohet për ndryshimin e funksionimit të sistemit në vend, zhvillimin e vlerave universale të humanizmit, përmirësimin e demokracisë në vend, eliminimin e çdo lloji të diskriminimit, ndërtimin e shtetit ligjor etj. Kjo parti, për herë të parë, mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 në të cilat fitoi gjithsej 5 deputetë, nga një në njësinë e parë dhe të dytë zgjedhore dhe tre deputetë në njësinë e gjashtë zgjedhore (4,86% të votave në nivel nacional). Në këto zgjedhje lokale, partia do të garoj e pavarur me kandidatë të vet për kryetarë të komunave në 19 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Për Komunën e Manastirit, Ohrit dhe Gazi Babës, BESA do të marr pjesë me lista të përbashkëta për këshilltarë me BDI dhe Aleancën për Shqiptarët.

**Lëvizja BESA**
Bul. "Kërste Misirkov" nr. 7 lokali 68 A
1000 Shkup
kontakt@levizjabesa.mk
www.levizjabesa.mk

### LËVIZJA PËR UNITET NACIONAL TË TURQVE

Lëvizja për Unitetin Nacional të Turqve (LUNT) është njëra nga partitë politike që i përfaqëson të drejtat e minoritetit turk në Republikën e Maqedonisë. Nga aspekti ideologjik, kjo parti politike është pozicionuar në qendër. Kryetar i partisë është Erdogan Saraç. Partia për herë të parë ka marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006. Si në këto zgjedhje ashtu edhe në ato të radhës të vitit 2008, kjo parti nuk ka shënuar ndonjë rezultat të dukshëm. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, LUNT bëhet pjesë e koalicionit të udhëhequr nga LSDM kur edhe fiton një mandat të deputetit. Në zgjedhjet e vitit 2014 kjo parti nuk merr pjesë në zgjedhje, ndërsa në vitin 2016 merr pjesë në Koalicionin me VMRO-DMNE. Në zgjedhjet e kaluara lokale LUNT fitoi 9 vende të këshilltarëve në Komunën e Dibrës, Qendrës së Zhupës dhe Shuto Orizarës. Në këto zgjedhje lokale, LUNT do të paraqitet në Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DMNE, me përjashtim të Komunës së Dollnenit në të cilën do të garoj me kandidat të vet për kryetar komune.

**Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve**
Rr. "Leningradska" nr. 2
1230 Gostivar
tmbh-2006@t-home.mk
http://tmbh.org.mk

### PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE

Partia Demokratike Shqiptare u themelua në tetor të vitit 1997 me bashkimin e Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH) dhe Partisë Demokratike Popullore (PDP). PPDSH u themelua në vitin 1994, pasi që krahu radikal i Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD), Arben Xhaferi dhe Menduh Thaçi e braktisën partinë amë. PDSH deklarohet si parti e qendrës së djathtë dhe angazhohet për të drejta më të mëdha të shqiptarëve në Maqedoni dhe për ridefinimin e kornizës kushtetuese, të vendosur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Në zgjedhjet e vitit 1998, PDSH fitoi 11 vende të deputetëve dhe u bë pjesë e Qeverisë së RM e udhëhequr nga VMRO-DMNE. Gjatë kohës së konfliktit në vitin 2001, PDSH ishte pjesë e Qeverisë së Koalicionit të gjerë e cila më vonë e nënshkroi Marrëveshjen

Kornizë. Nënshkrues i Marrëveshjes Kornizë nga PDSH ishte kryetari i atëhershëm Arben Xhaferi. Pas shpërndarjes së asaj Qeverie, PDSH mbetet në koalicionin qeveritar. Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2002, PDSH fitoi 5,2 % të votave dhe 7 mandate dhe u bë parti opozitare në Kuvend. PDSH përsëri kthehet në pushtet kur pas zgjedhjeve të vitit 2006 i përfundon me sukses negociatat me VMRO-DMNE, e cila e fitoi mandatin për formimin e Qeverisë. Në këto zgjedhje PDSH kishte fituar 7,5 % të votave dhe 11 mandate, që ishte më pak në krahasim me mandatet e partisë rivale BDI. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008, PDSH përsëri fitoi 11 mandate. Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008 partia më e madhe parlamentare VMRO-DMNE e ndërpreu partneritetin tradicional me PDSH dhe bëri koalicion me partinë më të madhe shqiptare në parlament BDI. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, PDSH fitoi 8 mandate, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 fitoi 7 vende të deputetëve. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2016, PDSH fitoi 2.6% të votave në nivel nacional duke fituar 2 deputetë në njësinë zgjedhore 6, kështu që kishte 5 deputetë më pak nga zgjedhjet paraprake parlamentare.

Kryetar i PDSH është Menduh Thaçi, i cili në këtë funksion është zgjedhur më 30 qershor të vitit 2007. Thaçi vjen në këtë funksion pas dorëheqjes së kryetarit paraprak Arben Xhaferi.

Në zgjedhjet e vitit 2005, PDSH në Koalicion me PPD fitoi dy vende të kryetarëve të komunave, ndërsa në zgjedhjet e ardhshme të vitit 2009 fitoi një vend të kryetarit të komunës në Tetovë. Në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2013 partia e fitoi vendin e kryetarit të komunës në Komunën e Strugës, në të cilën kryetar komune u bë Ziadin Sela, i cili pastaj u nda nga partia. Krahas njërit vend të kryetarit të komunës, PDSH fitoi edhe 103 vende të këshilltarëve. Në këto zgjedhje lokale, Partia Demokratike Shqiptare do të garoj me kandidatë të vet për kryetarë të komunave në 16 komuna dhe Qytetin e Shkupit.

**Partia Demokratike Shqiptare**
Sheshi "Iliria" 15/1
1200 Tetovë
info@gurra-pdsh.org
www.pdsh.info

## PARTIA DEMOKRATIKE E TURQVE NË MAQEDONI

Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM) është gjithashtu parti politike e cila i përfaqëson turqit etnikë në Republikën e Maqedonisë. Në krye të partisë është Bejkan Iljas. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, PDTM u paraqit në Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE, me ç'rast fitoi një vend të deputetit. Në zgjedhjet paraprake lokale të vitit 2013, partia fitoi 20 vende të këshilltarëve. Në këto zgjedhje lokale partia do të merr pjesë në Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE me përjashtim të Komunës Vrapçishtë dhe Qendra Zhupë ku PDTM në mënyrë të pavarur ka propozuar kandidatë për kryetarë të komunave.

**Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni**
Rr. "Stiv Naumov" nr 1
1000 Shkup
info@tdp.org.mk
www.tdp.org.mk/

## KOALICIONI "ALEANCA PËR SHQIPTARËT" (UNITETI, RDK)

Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" u formua nga partitë politike Lëvizja për Reforma në PDSH, Uniteti dhe RDK. Koalicionin e udhëheq lideri i Lëvizjes për Reforma në PDSH Ziadin Sela, kryetari i Rilindjes Demokratike Kombëtare Vesel Memedi dhe kryetari i Unitetit, Gëzim Ostreni. Angazhimet kryesore të Koalicionit ishin për barazi të plotë të shqiptarëve në Maqedoni, gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare në Maqedoni, shpërndarja e drejtë e buxhetit dhe rregullimi me Kushtetutë i PSP. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ky koalicion fitoi 3 vende të deputetëve, prej të cilëve një deputet në njësinë zgjedhore 5 dhe dy deputetë në njësinë zgjedhore 6. Kjo parti politike u bë pjesë e Koalicionit qeveritar.

Në vitin 2017, Ziadin Sela u largua nga Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" dhe e formoi partinë politike "Aleanca e Shqiptarëve", me ç'rast në këtë koalicion mbetën partitë politike Uniteti dhe RDK. Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët" me kandidat të vet për kryetarë të komunave do të garoj në Komunën e Gostivarit dhe Dibrës.

**Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët (Uniteti, RDK)**
www.uniteti.org
www.rdk.mk

## LEVICA

Levica është parti e re politike e themeluar në fund të vitit 2015. Partia ka ideologji majtiste dhe angazhohet për vlera majtiste, në mesin e të cilave antikapitalizmi, antinacionalizmi, antimilitarizmi, dhe antikonservativizmi. Në fokusin e partisë janë të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat themelore të njeriut, ndërsa si parti, para së gjithash, angazhohet për të varfrit, për të paprivilegjuarit, për të margjinalizuarit dhe për ata të cilëve u është shkaktuar padrejtësi. Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të vitit 2016 ishin zgjedhjet e para për këtë parti politike në të cilat fitoi 12120 vota, përkatësisht 1.02% të votave në nivel nacional. Në këto zgjedhje lokale, kjo parti do të garoj me kandidatë për kryetar të Qytetit të Shkupit, të Komunës së Gazi Babës dhe Qendrës.

**Levica**
Rr. "Gjuro Gjakoviq" nr. 20, hyrja 1, kati 3, nr. lok.12
1000 Shkup
contact@levica.mk
www.levica.mk

## LËVIZJA POPULLORE PËR MAQEDONI

Lëvizja Popullore për Maqedoni u themelua më 18 maj të vitit 2002 si parti me orientim nacional e bazuar mbi traditën e popullit maqedonas, e cila angazhohet për shtet social dhe tatim për të pasurit. Kryetar i LPM është Janko Baçev. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 partia fitoi 9 vende të këshilltarëve në 8 komuna. Partia nuk mori

pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 meqë Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i hodhi poshtë listat e kandidatëve të kësaj partie. Në këto zgjedhje lokale partia do të marr pjesë si e pavarur me kandidatë për kryetarë të komunave në 11 komuna dhe në Qytetin e Shkupit.

**Lëvizja Popullore për Maqedoni**
Rr. "Dame Gruev" nr. 10
1000 Shkup
ndm@ndm.org.mk
www.ndm.org.mk

## PARTIA PËR PROSPERITET DEMOKRATIK

Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) është partia më e vjetër e shqiptarëve në Maqedoni e themeluar në vitin 1990 ndërsa funksionoi deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011 kur iu bashkua PDSH. Partia u riaktivizua në janar të vitit 2014, ndërsa në krye të saj ishte Abdyladi Veseli, deputet në tre legjislatura paraprake të Kuvendit. Në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, PPD ishte partia më e madhe parlamentare e cila i përfaqësonte shqiptarët e Maqedonisë dhe disa herë ishte partner i koalicionit në qeveritë e LSDM. Pas ndarjes së të ashtuquajturit krahu radikal, në vitin 1994, nga i cili u formua PDSH, PPD konsiderohet si parti politike e matur. PPD angazhohet për barazinë e plotë të shqiptarëve në planin politik, ekonomik, social dhe kulturor në Maqedoni, për gjuhën e tyre kombëtare, për marrëdhënie harmonike ndëretnike, të mbështetura mbi parimet demokratike të barazisë dhe drejtësisë së mirëfilltë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 Partia për Prosperitet Demokratik fitoi gjithsej 1143 vota (0,1%) nga votat e përgjithshme në nivel nacional, kështu që nuk fitoi asnjë vend të deputetit.

Në zgjedhjet lokale të vitit 1996, partia garoi e pavarur dhe fitoi 12 kryetarë të komunave nga gjithsej 44 kandidatë të nominuar. Në zgjedhjet lokale të vitit 2000 do të shënoj rezultat më të dobët në krahasim me zgjedhjet e vitit 1996, meqë PPD fitoi vetëm 3 vende të kryetarëve të komunave. Në zgjedhjet lokale të vitit 2005, PPD mori pjesë në koalicion me PDSH kështu që fituan 2 vende të kryetarëve të komunave, në komunën e Zhelinës dhe Sarajit. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009 partia fitoi vetëm 328 vota, kështu që nuk fitoi asnjë vend të kryetarit të komunës. Në vitin 2013, PPD nuk mori pjesë në zgjedhjet lokale.

Në zgjedhjet lokale të vitit 2017, PPD do të garoj me kandidat të vet për kryetar komune në Komunën e Bogovinjës, ndërsa me lista të këshilltarëve do të garoj në komunën e Gazi Babës, Zhelinës, Likovës, Studeniçanit dhe Tetovës.

**Partia për Prosperitet Demokratik**
Rr. "Karaorman" nr. 62
1200 Tetovë
https://www.facebook.com/PPDzyrtare/?ref=br_rs

## PARTIA POLITIKE "ALEANCA PËR SHQIPTARËT"

Aleanca për Shqiptarët është parti politike e udhëhequr nga Ziadin Sela e cila u nda nga Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët". Kjo parti rezulton nga Lëvizja për Reforma në PDSH, ndërsa si parti politike është regjistruar para zgjedhjeve lokale me emrin "Aleanca për Shqiptarët" e që u kontestua nga lideri i Unitetit dhe RDK-së. Aleanca për Shqiptarët" në këto zgjedhje do të garoj e pavarur me kandidatë për kryetarë të komunave në 15 komuna dhe në

Qytetin e Shkupit. Në komunat: Manastir, Gazi Babë dhe Ohër, me lista të këshilltarëve do të paraqitet bashkë me partitë BDI dhe BESA.

**Partia Politike "Aleanca për Shqiptarët"**
Rr. "Ilinden" p.n.
1200 Tetovë
info@ndryshe.eu
www.ndryshe.eu

## LIDHJA E ROMËVE TË MAQEDONISË

Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM) është parti e cila i përfaqëson interesat e bashkësisë etnike rome në Maqedoni, aktive në skenën politike nga viti 1996. Kryetar i partisë është Amdi Bajram. Në periudhën kohore nga viti 1998 deri në vitin 2002, kjo parti merrte pjesë në punimet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me një deputet. Nga viti 2006 e deri më sot LRM përsëri ka një vend të deputetit në Kuvend si pjesë e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, LRM fitoi 6 vende të këshilltarëve dhe një vend të kryetarit të komunës në Komunën e Shuto Orizarës. Vendin e njëjtë të kryetarit të komunës e fitoi edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2013, si dhe 11 vende të këshilltarëve. Në këto zgjedhje lokale, LRM është pjesë e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Megjithatë, në Komunën e Shuto Orizarës kjo parti do të garoj e pavarur me kandidat të vet për kryetar të komunës dhe me listë të vet për këshilltarë.

**Lidhja e Romëve të Maqedonisë**
Shuto Orizarë 50
1000 Shkup
https://www.facebook.com/partija.srm.5

## PARTIA SOCIAL - DEMOKRATE E MAQEDONISË (PSDM)

Partia Social-Demokrate e Maqedonisë (PSDM) u formua në vitin 1990. Kryetar i parë ka qenë Sllavko Millosavlevski. PSDM është parti e qendrës së majtë dhe në mënyrë deklarative e pranon ideologjinë social-demokrate si bazë për veprimin e saj. Kryetar aktual është Branko Janevski, i cili është në krye të partisë në mandatin e tij të tretë të njëpasnjëshëm. Kjo parti ka marrë pjesë në më shumë cikle zgjedhore në Maqedoninë pluraliste, por pa suksese evidente. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, PSDM fitoi 1807 vota (0.16%) në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, PSDM mori pjesë si parti e pavarur, me kandidatë të vet për kryetarë të komunave dhe me lista të veta të këshilltarëve, me ç'rast nuk fitoi asnjë vend të kryetarit të komunës dhe asnjë vend të këshilltarit. Partia nuk mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 për shkak të refuzimit të listave të tyre të kandidatëve nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Në këto zgjedhje lokale, PSDM do të marr pjesë me kandidatë për kryetarë të komunave në Komunën e Gostivarit, Zërnovcit, Koçanit dhe Makedonski Brodit.

**Partia Social-Demokrate e Maqedonisë**
Bul. "APJ" nr. 54 ndërtesa nr. 1, hyrja 1 përdhes
Shkup

## BASHKIMI I PËRHERSHËM RADIKAL MAQEDONAS - BPRM

Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM) është parti politike maqedonase e themeluar në vitin 2002. Nga aspekti ideologjik partia është me orientim djathtist

duke i promovuar vlerat e konservativizmit dhe patriotizmit maqedonas, duke e kuptuar shtetin e Maqedonisë si shtet nacional të popullit maqedonas. Kryetar dhe themelues i partisë është Vanço Shehtanski. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 dhe 2008 partia arriti rezultate të papërfillshme. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, partia u bë pjesë e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE në të cilin mori pjesë edhe në zgjedhjet e vitit 2014 dhe 2016. Në këto zgjedhje lokale, BPRM do të garoj si parti e pavarur, me kandidat të vet për kryetarë të komunave në Komunën e Kavadarit dhe në Qytetin e Shkupit.

**Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas - BPRM**
Bul. "Jane Sandanski" 116-3/10
1000 Shkup
t_tmro@yahoo.com
http://tmro-mk.weebly.com/

# PASQYRA E KANDIDATËVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE NË ZGJEDHJET LOKALE 2017

## PASQYRA E KANDIDATËVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE[70]

Rajonet statistikor dhe komunat në Republikën e Maqedonisë




Organizimi territorial i Republikës së Maqedonisë
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës

Në këtë pjesë janë prezantuar kandidatët për kryetarë të komunave në zgjedhjet lokale të vitit 2017. Personat e nominuar në 29 komuna dhe Qytetin e Shkupit[71] janë prezantuar me fotografitë dhe

---

[70] Për të gjitha fotografitë si burim është shfrytëzuar interneti me link saktësisht të potencuar të burimit përkatës. Më së shpeshti janë shfrytëzuar fotografitë nga profilet zyrtare të Fejsbuk-ut të kandidatëve për kryetar të komunave. Për fotografitë e kandidatëve të VMRO-DPMNE-së është përdorur ueb faqja http://novaera.mk/, ndërsa për kandidatët e LSDM-së është përdorur ueb faqja http://zivotzasite.mk/.

[71] Prezantimi i kandidatëve për kryetar të komunave në 29 komuna dhe Qytetin e Shkupit është bërë sipas alfabetit të shkronjës së parë të mbiemrit të kandidatëve.

biografitë,[72] e tyre, ndërsa kandidatët e komunave të tjera janë prezantuar me emrat dhe mbiemrat e tyre, si dhe me paraqitësin e kandidaturës.

Në pasqyrën gjithëpërfshirëse janë përfshirë vetëm komunat më të mëdha të cilat janë të pozicionuara në mjediset urbane, duke i përfshirë edhe të gjitha komunat në kuadër të Qytetit të Shkupit. Kriteret për përfshirjen e komunave në modelin ishin: Statusi urban, Numri i banorëve (me ç'rast numri më i madh është përfshirë), Struktura etnike e popullsisë (me ç'rast mbahej llogari që të përfshihen sa më shumë komuna multietnike) dhe Numri i kandidatëve të nominuar për kryetarë të komunave.



*Qyteti i Shkupit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 1854 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 506 926 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (66,75%)<br>Shqiptarë (20,49%)<br>Romë (4,36%)<br>Serbë (2,82%)<br>Turq (1,7) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 45 |
| Buxheti për vitin 2016[73] | 6 651 736 000 |
| Adresa | Ilinden nr. 82<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 3 297 255<br>02/ 3 297 536<br>02/ 3 297 265<br>02/ 3 297 236 |
| Ueb-faqja | http://www.skopje.gov.mk |

72 Për shkak të mungesës së informacioneve, tek disa kandidatë nuk janë prezantuar biografitë dhe/ose fotografi. Pasqyra e kandidatëve për kryetarë të komunave u referohet kandidatëve të publikuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Lista zyrtare është e aksesshme në: https://kandidati.sec.mk

73 Buxhetet e të gjitha komunave të prezantuara në këtë manual janë shprehur me denarë.



## KANDIDATË PËR KRYETAR TË QYTETIT TE SHKUPIT



*Naim Bajrami (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[74] me profesion është jurist. Ai ka diplomuar në shkencat politike pranë Fakultetit Juridik – Shkup "Justiniani I" në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup. Në vitin 2017, Naim Bajrami është caktuar për zëdhënës të dytë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, si kuadër i partisë Politike Aleanca për Shqiptarët.



*Koce Trajanovski (VMRO-DPMNE)*[75] është kryetar aktual i Qytetit të Shkupit tanimë dy mandate, përkatësisht nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Paraprakisht, nga viti 2005 deri në vitin 2009 ishte kryetar i Komunës së Gazi Babës. Nga viti 2008 është kryetar i Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL). Nga viti 1998 deri në vitin 2005 ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Para se të filloj të merret me politikë ka poseduar firmë kompjuterike, ndërsa 15 vjet ka punuar në EMT-Hepos. Trajanovski ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë në Shkup. Ai ka 61 vjet.



*Gjorgji Todorov (Lëvizja Popullore për Maqedoni)*[76] është anëtar i Komitetit Ekzekutiv të LPM. Todorov ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në legjislaturën 1998-2002 nga partia politike VMRO-Maqedonase. Ka kryer fakultetin teknik, drejtimi i komunikacionit. Ka punuar si udhëheqës në Qendrën Dispeçerike në Ndërmarrjen e Transportit Publik - Shkup. Gjithashtu ka qenë nënkryetar i komunikacionit në Komitetin e Qytetit për urbanizëm, për punë komunale-banimi, komunikacion dhe mbrojtje të mjedisit jetësor në Qytetin e Shkupit. Ka lindur në vitin 1958 në Shkup.

74 https://www.facebook.com/naim.bajrami.10

75 https://www.facebook.com/koce.trajanovski/

76 https://www.facebook.com/Народно-Движење-За-Македонија-1017491648264591/



*Bekim Fazliu (PDSH)*[77] është ish-deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga radhët e PDSH. Ai e ka ushtruar funksionin e deputetit në legjislaturat e vitit 2011-2014 dhe 2014-2016. Para se të bëhet deputet, Bekim Fazliu në një mandat ka qenë kryetar i Komunës së Sarajit. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup. Ka lindur në vitin 1979 në Shkup.



*Nafie Selmani (BESA)*[78] është e punësuar në administratën e Qytetit të Shkupit në Sektorin për mbështetjen e Kryetarit të Komunës për marrëdhënie me publikun.



*Marija Xhons (Levica)*[79] më shumë se 10 vjet punon si përkthyese nga gjuha maqedonase në gjuhën angleze dhe nga gjuhën angleze në atë maqedonase. Ka punuar edhe si gazetare rinore për kulturë në "Mllad Borec" dhe "Studentski Zbor" dhe në radio më të vogla në Shkup. Ka punuar edhe si shitëse dhe kuzhiniere në Shkup; si pastruese hoteli, kameriere, agjente e marketingut për hapësira publicitare në një revistë financiare në Londër; si mësimdhënëse e gjuhës maqedonase për të huaj dhe për gjuhën angleze në Shkup dhe si mësimdhënëse e gjuhës angleze për të huaj në Marok, Hungari dhe në Britaninë e Madhe. Ka studiuar për regji dramaturgjike, drejtësi, letërsi komparative, gjuhë angleze dhe art figurativ në Shkup dhe Londër. Ka 39 vjet.

77 http://www.sobranie.mk/demokratska-partija-na-albancite-ns_article-bekim-fazliu-11.nspx
78 https://www.facebook.com/nafie.selmani
79 https://levica.mk/gradonachalnik-skopje/





*Petre Shilegov (LSDM)*[80] është nënkryetar i LSDM, deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa paraprakisht ishte zëdhënës i partisë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, Petre Shilegov ishte bartës i njësisë zgjedhore 2, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 ishte bartës në NJZ6. Ka lindur në vitin 1969 në Shkup. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Para se të bëhet deputet, Shilegov ka punuar si avokat.



*Vanço Shehtanski (BPRM)* [81] është kryetar dhe themelues i partisë Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM). Ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Ciliri e Metodi" në Shkup në vitin 1996, ndërsa provimin e jurisprudencës e ka dhënë në vitin 1998. Me profesion është avokat. Në vitin 2009 u emërua si drejtor i parë i Agjencisë për Menaxhim me Pronën e Sekuestruar, ndërsa në periudhën 2010-2017 ka qenë drejtor i Inspektoratit Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale. Ka qenë kryetar i KF Vardar në vitin 2008 dhe 2010. Ka lindur në Shkup në vitin 1972.

80 https://www.facebook.com/p.shilegov/
81 https://www.facebook.com/TMROMK

Komuna e Aerodromit

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 21 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 72 009 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (89,4%)<br>Serbë (4,28%)<br>Shqiptarë (1,41%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 27 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 072 418 000 |
| Adresa | Jane Sandanksi nr. 1096<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 2 400 970 |
| Ueb-faqja | http://www.aerodrom.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË AERODROMIT



*Ivica Konevski (VMRO-DPMNE)*[82] është kryetar i komunës së Aerodromit nga viti 2009. Paraprakisht, prej vitit 2006 deri në zgjedhjen për kryetar të komunës, e ka ushtruar funksionin drejtor i përgjithshëm i Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Hapësirat e Banimit dhe Afariste në Republikën e Maqedonisë. Në vitin 2005 dhe 2006 ka qenë anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit. Konevski është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës. Ai ka 34 vjet.



*Zllatko Marin*[83] është kryetar i Organizatës Komunale të LSDM në Aerodrom dhe anëtar shumëvjeçar i partisë. Me profesion është profesor i edukatës fizike dhe edukatës shëndetësore.

82 https://www.facebook.com/IvicaKonevski/
83 https://www.facebook.com/Zlatko.Marin

Komuna e Butelit

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 55 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 36 154 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (62,25%)<br>Shqiptarë (25,19%)<br>Turq (3,61%)<br>Serbë (4,28%)<br>Boshnjakë (2,68%)<br>Romë (1,55%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | 433 925 000 |
| Adresa | Butelska nr. 4<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 2 600 506 |
| Ueb-faqja | http://www.opstinabutel.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË BUTELIT

*Vllatko Damjanovski (LPM)*



*Darko Kostovski (VMRO-DPMNE)*[84] është këshilltar në Komunën e Butelit, i zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Ai është i punësuar në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa kohë më parë ka filluar ta ushtroj edhe funksionin e zëdhënësit të VMRO-DPMNE. Kostovski është politikolog i diplomuar. Ka 29 vjet.

84 https://www.facebook.com/darkokostovskizabutel/



*Ermond Miftari (PDSH)*[85] punon si logoped në Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve. Miftari ka diplomuar për defektologji në Fakultetin e Defektologjisë (drejtimi Logopedi) në Universitetin e Zagrebit.



*Velimir Smilevski (LSDM)*[86] është kryetar aktual i Organizatës Komunale të LSDM - Butel. Ai është këshilltar i LSDM në Këshillin e Komunës Butel. Smilevski është sipërmarrës dhe pronar i kompanisë.



*Naser Curri (BESA)*[87] është pedagog i diplomuar në Fakultetin Pedagogjik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" – në Shkup. Në periudhën nga viti 1996 deri në vitin 2004, Naser Curri ka punuar në shkollën fillore "Emin Duraku"- Shkup. Nga viti 2004 është punësuar në shkollën fillore "Zhivko Brajkovski" në Butel si mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në periudhën kohore 2005-2009, Curri ka qenë anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit si përfaqësues i Partisë Demokratike Kombëtare.

85 https://www.facebook.com/ermond.miftari
86 https://www.facebook.com/velimiramsmilevski
87 https://www.facebook.com/NaserCurri2017/

*Komuna e Gazi Babës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 92 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 72 617 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (73,67%)<br>Serbë (17,22%)<br>Shqiptarë (2,89%)<br>Romë (2,87) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 27 |
| Buxheti për vitin 2016 | 924 385 000 |
| Adresa | Arhimedova nr. 2<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 3 226 655 |
| Ueb-faqja | http://www.gazibaba.gov.mk/ |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GAZI BABËS



*Borçe Georgievski (LSDM)*[88] është Kryetar i Organizatës Komunale të LSDM në Gazi Babë. Ai, gjithashtu, është edhe këshilltarë në Komunën e Gazi Babës nga viti 2013.

88 https://www.facebook.com/BorceGeorgievskiZaGaziBaba/



*Toni Trajkovski (VMRO-DPMNE)*[89] është në kryerje e sipër të mandatit të tij të dytë si kryetar i Komunës së Gazi Babës. Deri në zgjedhjen për kryetar të komunës në vitin 2009 ka qenë i punësuar në SHA "ELEM", ndërsa paraprakisht ka punuar edhe si inxhinier në SHA "EEM". Në vitin 2005 u bë anëtar i Këshillit të Komunës së Gazi Babës, ndërsa në vitin 2008 u zgjodh për kryetar të Këshillit Komunal. Trajkovski ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë në vitin 2001 në Shkup. Ai ka 43 vjet.



*Zoran Trpçevski (LEVICA)*[90] është ish-nënoficer në ARM. Ai është pensionist i luftës nga viti 2007. Ka kryer shkollë të mesme ushtarake në Sarajevë. Pensionist lufte është nga viti 2007. Ai ka 53 vjet.

89 https://www.facebook.com/profile.php?id=1080561723
90 https://levica.mk/gradonachalnik-gazi-baba/



*Komuna e Gjorçe Petrovit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 67 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 41 634 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (85,16%)<br>Serbë (4,16%)<br>Shqiptarë (3,84%)<br>Romë (3%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 500 994 000 |
| Adresa | Gjorçe Petrov nr. 73<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 2 039 307 |
| Ueb-faqja | http://www.opstinagpetrov.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GJORÇE PETROVIT



*Vllado Misajllovski (VMRO-DPMNE)*[91] është ish-ministër i Transportit dhe Lidhjeve në Qeverinë e VMRO-DPMNE-së në periudhën nga muaji maj i vitit 2015 deri në maj të vitit 2017. Në atë pozicion vjen nga funksioni drejtor i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore. Paraprakisht, Misajllovski e ka ushtruar funksionin sekretar shtetëror në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, gjithashtu ka qenë sekretar shtetëror në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Misajllovski është politikolog i diplomuar, me studime të magjistraturës për Politikë dhe Diplomaci Evropiane dhe Ndërkombëtare. Ai ka 32 vjet.

91 https://www.facebook.com/misajlovskivlado/



*Aleksandar Naumoski (LSDM)*[92] është drejtor i Burgut Hetues Shkup në Shuto Orizarë nga muaji gusht i vitit 2017. Kjo është kandidatura e dytë me radhë e Naumoskit për kryetar të Komunës së Gjorçe Petrovit. Paraprakisht ka punuar në kompani të sigurimeve, si drejtor në sektorin privat dhe si sipërmarrës privat. Në periudhën kohore 2006-2011 ka qenë bashkëpunëtor në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa gjithashtu, ka punuar edhe si këshilltar i drejtorit të përgjithshëm për çështje juridike në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë. Naumoski ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Juridik "Justiniani I" në Shkup. Ka lindur në vitin 1977 në Shkup.

92 https://www.facebook.com/AleksandarNaumoskizaGorce/





*Komuna e Karposhit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 35 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 59 666 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (88,51%)<br>Shqiptarë (3,27%)<br>Serbë (3,66%)<br>Romë (1,03%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 978 462 000 |
| Adresa | Radika nr. 9<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 3 061 353 |
| Ueb-faqja | http://www.karpos.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KARPOSHIT



*Stefan Bogoev (LSDM)*[93] është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në legjislaturën aktuale, si dhe në legjislaturën paraprake të deputetëve në periudhën kohore 2014-2016. Ai, gjithashtu, është ish-kryetar i Rinisë Socialdemokrate të Maqedonisë. Stefan Bogoev është ekonomist i diplomuar, magjistrant në ekonominë aplikative pranë Universitetit Amerikan Kolexh – Shkup. Ka lindur në vitin 1989 në Shkup.

93 https://www.facebook.com/bogoevstefan/



*Stefçe Jakimovski (OPQM)*[94] është në kryerje e sipër të mandatit të tretë si kryetar i Komunës së Karposhit. Mandatin e parë si kryetar komune e ka ushtruar në periudhën kohore nga viti 2000 deri në vitin 2003, ndërsa mandatin e dytë e ka ushtruar në periudhën kohore 2009-2013. Në vitin 2003 u nominua si ministër i Ekonomisë, ndërsa nga muaji dhjetor i vitit 2004 deri në vitin 2006 e ka ushtruar funksionin e ministrit për Punë dhe Politikë Sociale. Pas kryerjes së mandatit të ministrit ka punuar në firmën e tij private. Para fillimit të karrierës politike është marr me biznes privat, ndërsa ka qenë drejtor i Katllanovë Turs. Jakimovski ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Shkup. Ka 56 vjet.

94 https://www.facebook.com/stevco.jakimovski.12






*Komuna e Kisella Vodës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 47 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 57 236 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (91,69%)<br>Serbë (2,49%)<br>Romë (1,25%)<br>Vlleh (1,13%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 000 135 000 |
| Adresa | Petar Deljan 17<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 2 785 400 |
| Ueb-faqja | http://www.kiselavoda.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KISELLA VODËS



*Johan Tarçullovski (VMRO-DPMNE)*[95] është deputet në Kuvendin e RM i zgjedhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016. Para se të zgjidhet për deputet ai ka punuar si sipërmarrës. Tarçullovski në periudhën kohore nga viti 1999 deri në vitin 2004 ka qenë inspektor për shoqërim në Shërbimin për sigurimin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski. Për shkak të aktiviteteve në konfliktin e vitit 2001 është akuzuar dhe dënuar nga Prokuroria e Tribunalit të Hagës për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës. U ekstradua në Hagë, më 16 mars të vitit 2005. Ai vuajti gjashtë vjet burgim në Sheveningen, ndërsa dy vitet e tjera në qytetin Dic, Gjermani. Në prill të vitit 2013, Tarçullovski u lirua dhe u kthye në Maqedoni, ku e ushtron funksionin sekretar organizativ i VMRO-DPMNE.

95 https://www.facebook.com/Johan.Tarculovski/



*Filip Temellkovski (LSDM)*[96] është kryetar i Organizatës Komunale të LSDM Kisella Vodë nga viti 2013. Në periudhën kohore nga viti 2008 deri në vitin 2009, Filip Temellkovski ishte sekretar i përgjithshëm i rinisë socialdemokrate të Maqedonisë. Ka kryer edhe funksione tjera partiake. Jashtë nga politika Filip Temellkovski punon në sektorin e hotelerisë.

96 https://www.facebook.com/TemelkovskiFilip/



*Komuna e Sarajit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 241 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 35 408 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (91,53%)<br>Maqedonas (3,89%)<br>Boshnjakë (3,16%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | / |
| Adresa | Qendra Rekreative Saraj p.n.<br>Komuna e Sarajit |
| Telefoni | 02/ 2 057 990<br>02/ 2 057 996 |
| Ueb-faqja | http://www.saraj.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SARAJIT



*Ekrem Alija (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[97]



*Sefedin Aliu (PDSH)*[98]

97 https://www.facebook.com/Ekrem-Alija-Faqja-Zyrtare-1963399940651792/
98 https://www.facebook.com/Saraj.co/



*Bashkim Bakiu (BESA)*[99] është hulumtues dhe themelues i Institutit për Hulumtimin e Politikave dhe për Qeverisje të Mirë në Shkup. Bakiu ka diplomuar për shkenca politike në Fakultetin Juridik "Justiniani I" në Shkup, ndërsa ka magjistruar në temën: Zhvillimi komparativ lokal në programin për magjistra të koordinuar nga Universiteti i Trento-s – Itali. Për momentin Bakiu është doktorant në Universitetin "Shën Cirili e Metodi" në Shkup.



*Blerim Bexheti (BDI)*[100] është anëtar i Kryesisë Qendrore të BDI. Në vitin 2009 u zgjodh për kryetar komune të Sarajit dhe anëtar i Këshillit Drejtues të BNJVL. Këto funksione i ka ushtruar deri në vitin 2011 kur u emërua për ministër të Drejtësisë. Paraprakisht, në periudhën kohore nga viti 2006 deri në vitin 2009 dy herë u zgjodh për deputet në Kuvendin e RM nga BDI. Në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2006 ka punuar në zyrën e tij të avokatisë, ndërsa nga viti 2002 deri në vitin 2005 ka punuar si këshilltar i lartë në Ministrinë e Drejtësisë. Bexheti është jurist i diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës. Ka 41 vjet.

99 https://www.facebook.com/bashkimbakiuofficial/
100 https://www.facebook.com/bexhetii/



*Komuna Qendër*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 10 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 45 412 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (85,4%)<br>Serbë (4,49%)<br>Shqiptarë (3,23%)<br>Romë (2,14%)<br>Turq (1,08%)<br>Vlleh (1,01%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 503 504 000 |
| Adresa | Mihaill Cokov p.n.<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 3 203 600 |
| Ueb-faqja | http://www.opstinacentar.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS QENDËR



*Sasha Bogdanoviq (LSDM)*[101] ka lindur në vitin 1985 në Postojnë, Slloveni. Është anëtar i LSDM nga viti 2001, ndërsa nga viti 2009 u bë anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Organizatës Komunale të LSDM Qendër, kurse në vitin 2014 u bë kryetari i saj. Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Për momentin ai është drejtor i Ndërmarrjes Publike Parkingje të Komunës Qendër.

101 https://www.facebook.com/sasha.bogdanovikj/



*Dejan Jovanovski (VMRO-DPMNE)*[102] është anëtar i Komitetit Ekzekutiv të VMRO-DPMNE nga viti 2017. Paraprakisht, në vitin 2016, për një kohë të shkurtër është emëruar për sekretar të përgjithshëm të Federatës Maqedonase të Basketbollit (FMB), por vetëm pas një muaji u tërhoq nga funksioni. Jovanovski në periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2013 ishte drejtor sportiv i KB "Rabotniçki", ndërsa pastaj ka punuar në Agjencinë për Rini dhe Sport. Ai është ish-basketbollist profesionist i cili ka luajtur për më shumë klube në Maqedoni dhe jashtë Maqedonisë dhe ka qenë anëtar i reprezentacionit basketbollis. Jovanovski ka 44 vjet.



*Aleksandar Mitrov (LEVICA)*[103] punon si ciceron turistik në gjuhën spanjolle dhe angleze dhe si instruktor për tango argjentinase. Ka përvojë pune në fusha të ndryshme duke filluar nga shitja, hoteleria, institucione financiare për transfert të shpejtë të parave, në projekte nga fusha e promovimit dhe avancimit të të drejtave të punëtorëve, inkorporimit të ditarit elektronik në kopshtet e RM etj. Njëri nga themeluesit e Lëvizjes për Drejtësi Sociale "Lenka" në vitin 2008 prej kur edhe ka filluar angazhimi i tij aktiv në politikë. Mitrov ka diplomuar për shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Ai ka 34 vjet.

102 https://www.facebook.com/DejanTimCentar/
103 https://levica.mk/gradonachalnik-centar/

*Komuna e Çairit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 4 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 64 773 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (57%)<br>Maqedonas (24,13%)<br>Turq (6,95%)<br>Romë (4,76%)<br>Boshnjakë (4,55%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 27 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 363 866 359 |
| Adresa | Hristian Todorovski nr. 5<br>Shkup |
| Telefoni | 02/ 5 101 855 |
| Ueb-faqja | http://cair.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË ÇAIRIT



*Faruk Avdiu (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[104] punon si profesor në shkollën e mesme SHMQSH "Arseni Jovkov" në Shkup nga viti 2010. Në vitin 2009, ka diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës. Ka lindur në vitin 1985 në Shkup.



*Ismail Bojda (LPM)*[105] është kryetar i Lidhjes së Maqedonasve me religjion islam dhe kryetar i Lidhjes së Goranëve. Ka lindur në vitin 1954 në fshatin Brod në zonën Gora në Kosovë.

104 https://www.facebook.com/faruk.avdiu.7
105 http://facebook.com/ibojda




*Visar Ganiu (BDI)*[106] e ushtron funksionin e zëvendësministrit të Arsimit dhe Shkencës. Me paraqitjen e kandidaturës për kryetar të Komunës së Çairit ai dha dorëheqje nga pozita e zëvendësministrit. Paraprakisht, nga viti 2004 ka punuar në Universitetin Shtetëror të Tetovës si asistent i ri dhe asistent në lëndën: Teoria dhe metodologjia e ushtrimeve sportive. Në vitin 2009 u zgjodh për docent, ndërsa nga viti 2014 është profesor inordiner. Ka diplomuar në Fakultetin për Kulturë Fizike pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës. Ka lindur në vitin 1978 në Shkup.



*Zeqirija Ibraimi (BESA)*[107] është deputet në Kuvendin e RM i zgjedhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016. Ai është anëtar i Kryesisë Qendrore të partisë. Para se të zgjidhet në funksionin e deputetit ai ka punuar si bashkëpunëtor shkencor në Institutin për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup. Zeqirija Ibraimi është filolog, ka diplomuar në Fakultetin Filologjik. Ai ka 40 vjet.



*Idriz Orana (PDSH)*[108] është doktor-kirurg në Qendrën Klinike të Shkupit. Ai është këshilltar në përbërjen e fundit të Këshillit të Qytetit të Shkupit si anëtar i PDSH. Deri në vitin 2017, Orana është kryetar i Dhomës së Mjekëve të Maqedonisë.

106 https://www.facebook.com/VisarGaniu.Cair/
http://www.mia.mk/en/Inside/RenderSingleGalleryTest/133852564/1?month=9&year=2017&day=12&desc=1

107 http://sobranie.mk/dvizenje-besa-2016-ns_article-zekjirija-ibrahimi-16.nspx

108 https://www.facebook.com/idriz.orana.1





*Nermin Tellovska (VMRO-DPMNE)*[109] është anëtare e Komitetit Ekzekutiv të VMRO-DPMNE. Ajo është defektologe logopede, kryetare e Këshillit të Logopedëve pranë Lidhjes së Defektologëve të Maqedonisë. Tellovska është specialiste për reduksionin dhe relaksimin psikomotorik, për çrregullime disfluente të të folurit, magjistre e shkencave të defektologjisë – grupi logopedi dhe magjistre në fushën e administratës komparative publike të Bashkimit Evropian. Ajo ka 52 vjet.

109 https://www.facebook.com/Nermin.Telovska.Makedonija/

*Komuna e Shuto Orizarës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 7 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 22 017 |
| Struktura etnike e popullsisë | Romë (60,6%)<br>Shqiptarë (30,32%)<br>Maqedonas (6,53%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | 248 393 000 |
| Adresa | Vietnamska p.n.<br>1000 Shkup |
| Telefoni | 02/ 2 650 584 |
| Ueb-faqja | http://www.sutoorizari.org.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SHUTO ORIZARËS



*Elvis Bajram (LRM)*[110] është kryetar i Komunës së Shuto Orizarës nga viti 2009. Para se të bëhet kryetar i komunës ka qenë kryetar i Këshillit të Komunës së Shuto Orizarës. Merret me biznes familjar. Ka kryer arsim fillor. Ka 36 vjet.



*Kurto Dudush (LSDM)*[111] është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga viti 2016. Ai ka diplomuar për Biznes menaxhment në Universitetin MIT në Shkup. Ka lindur në vitin 1974 në Shkup.

110 https://www.facebook.com/Elvis-Bajram-1609731929079429/
111 https://www.facebook.com/kucoo.dudush



*Faik Sadiki (PDSH)*

*Muhamed Curri (BESA)*



*Xhelal Çajani (BDI)*[112] punon si nëpunës në Sekretariatin për Implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Ai është jurist i diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup.

112 https://www.facebook.com/xhelalc



Komuna e Manastirit

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 792 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 95 385 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (88,71%)<br>Shqiptarë (4,36%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 31 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 618 668 311 |
| Adresa | 1 Maji nr. 61<br>Manastir |
| Telefoni | 047/ 234 234 |
| Ueb-faqja | http://www.bitola.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË MANASTIRIT



*Zoran Ilioski (VMRO-DPMNE)*[113] është në kryerje e sipër të mandatit të dytë si deputet në Kuvendin e RM. Për herë të parë në këtë funksion u zgjodh në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Ilioski është anëtar i Komitetit Ekzekutiv të partisë. Para se të zgjidhet për deputet ai e ka ushtruar funksionin e drejtorit të Ndërmarrjes Publike "Ujësjellësi". Ilioski është elektro-inxhinier i diplomuar. Ai ka 55 vjet.

113 https://www.facebook.com/zoranilioskibitola/






*Jorgo Ognenovski (kandidat i pavarur)*[114] është aktor profesionist. Ka themeluar firmë për produksionin e filmave dhe TV novelave. Gjithashtu, është edhe themelues i Organizatës Humanitare "Për shëndet më të mirë" – Manastir, e cila është dedikuar për nevojat e spitalit të Manastirit. Paraprakisht ka qenë producent i 4 filmave artistik në Hollivud, SHBA, nga të cilët njëri në bashkëproduksion me Ministrinë e Kulturës të Republikës së Maqedonisë. Ka diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në Shkup. Ka 62 vjet.



*Natasha Petrovska (LSDM)*[115] është këshilltare e Komunës së Manastirit dhe koordinatore e grupit të këshilltarëve të LSDM në Këshillin e Komunës. Paraprakisht në një mandat ka qenë anëtare e Këshillit Ekzekutiv të LSDM, ndërsa në dy mandate ka qenë anëtare e Këshillit Ekzekutiv të Organizatës Komunale në Manastir. Ajo është magjistre për menaxhment dhe resurse njerëzore në Universitetin për Turizëm dhe Menaxhment, ndërsa punon si profesoreshë e matematikës në Shkollën Teknike të Manastirit "Gjorgji Naumov". Shkollën e mesme e ka kryer në Gjimnazin "Josip Broz Tito" në Manastir. Ka lindur në vitin 1971 në Manastir.



*Qirço Tashkov (kandidat i pavarur)*[116] është kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Manastirit. Është i punësuar në SHA ELEM Njësia rajonale KEM Manastir.

114 https://www.facebook.com/jorgo.ognenovski
115 https://www.facebook.com/SoLjubovZaBitola/
116 https://www.facebook.com/Ќирчо-Ташков-1936150186642999/




*Komuna e Velesit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 464 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 55 108 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (84,86%)<br>Shqiptarë (4,17%)<br>Turq (3,13%)<br>Romë (1,45%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 906 299 344 |
| Adresa | Panko Brashnar nr. 1<br>Veles |
| Telefoni | 043/ 232 966 |
| Ueb-faqja | http://www.veles.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË VELESIT



*Ace Kocevski (LSDM)*[117] në të kaluarën ka qenë kryetar i Komunës së Velesit në dy mandate nga viti 2000 deri në vitin 2009, nënsekretar në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale nga viti 1999 deri në vitin 2000. Ai ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën kohore nga viti 1994 deri në vitin 1998. Gjatë studimeve ka qenë kryetar i Organizatës Rinore të Universitetit "Shën Cirili e Metodi" nga viti 1982 deri në vitin 1983. Për nga vokacioni ai është inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë. Ka 56 vjet.

117 https://www.facebook.com/kocevskiace/





*Sllavço Çadiev (VMRO-DPMNE)*[118] është kryetar i Komunës së Velesit i zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Para se të zgjidhet në këtë funksion ai ka qenë anëtar dhe kryetar i Këshillit të Komunës së Velesit edhe atë në dy mandate, përkatësisht nga viti 2005. Çadievi është magjistër i defektologjisë – surdolog dhe punon në ISHP Spitali i Përgjithshëm Veles, reparti ORL. Ai është nënkryetar i Lidhjes së Defektologëve të Maqedonisë, bashkëpunëtor shumëvjeçar i Lidhjes së Personave të Shurdhër dhe Personave me Dëgjim të Dëmtuar të Republikës së Maqedonisë dhe i Entit për Persona të Shurdhër "Koço Racin" – Manastir, si dhe i zyrës rajonale të Lidhjes së Personave të Shurdhër dhe Personave me Dëgjim të Dëmtuar dhe Lidhjes së Personave të Verbër në Veles. Ka diplomuar në Fakultetin e Defektologjisë në Beograd ka 58 vjet.

*Goce Çushkov (LPM)* është anëtar i mëparshëm i VMRO-DPMNE. Në karrierën e tij të punës, mes tjerash, ka qenë edhe drejtor shumëvjeçar i Agrokombinatit "Llozar" në Veles. Shkollën e mesme e ka kryer në Gjimnazin "Koço Racin" në Veles. Ka lindur në vitin 1956 në Veles.

118 https://www.facebook.com/cadievslavco/

*Komuna e Gjevgjelisë*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 485 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 22 988 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (96,82%)<br>Serbë (1,6%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | 733 066 292 |
| Adresa | Dimitar Vllahov nr. 4<br>Gjevgjeli |
| Telefoni | 034/ 213 843 |
| Ueb-faqja | http://gevgelija.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GJEVGJELISË



*Sasho Pockov (LSDM)*[119] është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik dhe është magjistër i shkencave ekonomike. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009 Sasho Pockov ka qenë bartës i listës së këshilltarëve të LSDM, ndërsa pastaj është bërë këshilltar në Këshillin e Komunës së Gjevgjelisë në mandatin 2009 – 2013. Në vitin 2009 ai është zgjedhur për kryetar të Organizatës Komunale të LSDM Gjevgjeli. Ka lindur në vitin 1966 në Gjevgjeli.



*Ivan Frangov (VMRO-DPMNE)*[120] është në kryerje e sipër të mandatit të dytë si kryetar i Komunës së Gjevgjelisë. Paraprakisht, nga viti 2007 ka punuar si udhëheqës i Seksionit tatimor në Drejtorinë e të Ardhurave Publike në Gjevgjeli. Nga viti 2002 deri në vitin 2007 ka punuar në kompaninë private "Sollun 53" SHA Gjevgjeli, fillimisht si udhëheqës i marketit, ndërsa pastaj si anëtar ekzekutiv i bordit të drejtorëve. Ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Shkup, dega tregtia e jashtme dhe marketingu. Ka 47 vjet.

119 https://www.facebook.com/sashopockov/
120 https://www.facebook.com/frangovivan/



*Komuna e Gostivarit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 519 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 81 042 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (66,68%)<br>Maqedonas (19,59%)<br>Turq (9,86%)<br>Romë (2,76%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 31 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 096 684 000 |
| Adresa | Braqa Ginoski nr. 61<br>Gostivar |
| Telefoni | 042/ 213 511 |
| Ueb-faqja | http://www.gostivari.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GOSTIVARIT



*Asaf Ademi (BESA)*[121] është ish-ambasador i Republikës së Maqedonisë në Danimarkë deri në vitin 2016. Para se nominohet për ambasador në vitin 2009 ka punuar si këshilltar i ministrit të Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Paraprakisht, në periudhën kohore nga viti 2007 deri në vitin 2009 Ademi ka qenë udhëheqës i Sektorit për planifikim urbanistik dhe mjedis jetësor në Komunën e Gostivarit. Në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2007 ka qenë udhëheqës i Sektorit për zhvillimin ekonomik të komunës, ndërsa prej viti 2004 deri në vitin 2005 ka qenë këshilltar i kryetarit të komunës për infrastrukturë. Ademi është inxhinier i diplomuar. Ai e ka titullin e magjistrit.

121 https://www.facebook.com/asaf.ademi



*Nevzat Bejta (BDI)*[122] është kryetar i Komunës së Gostivarit i zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013, paraprakisht ka qenë kryetar i komunës në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2009. Nga viti 2011 deri në shkurt të vitit 2013 ka qenë ministër i Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Në vitin 2005 u zgjodh për nënkryetar të Komunës së Gostivarit dhe kryetar i BNJVL. Në periudhën kohore nga viti 2002 deri në vitin 2005 ka qenë deputet në Kuvendin e RM. Në vitin 2000 u zgjodh për këshilltar në Këshillin e Komunës së Gostivarit. Paraprakisht ka punuar si profesor i historisë në fshatin Çegran dhe në Gostivar. Ka diplomuar në Fakultetin Filozofik në Prishtinë në Katedrën e Historisë ndërsa ka magjistruar në Universitetin e Tiranës. Ai ka 55 vjet.



*Shpat Iseini (Koalicioni Aleanca për Shqiptarët)*[123] është kryetar i Forumit rinor të partisë politike Rilindja Demokratike Kombëtare. Ai është student i shkencave politike në Universitetin e Evropës Juglindore. Ka 25 vjet.



*Selajdin Izairi (PDSH)*[124] është politikolog dhe është anëtar i kryesisë qendrore të partisë. Ka lindur në fshatin Çegran - Gostivar.

122 https://www.facebook.com/NevzatBejtaFaqjaZyrtare/
123 https://www.facebook.com/shpat.iseini.3
124 https://www.facebook.com/PDSH-Dega-Gostivar-Zgjedhjet-Lokale-2017-175041466403620/

*Lenka Jovanovka (PSDM)*



*Dafina Stojanoska (VMRO-DPMNE)*[125] është deputete në Kuvendin e RM e zgjedhur në zgjedhjet e vitit 2016. Para se të zgjidhet për deputete, Stojanoska ka qenë këshilltare në Komunën e Gostivarit e zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Nga muaji qershor 2015 deri në muajin korrik të vitit 2017 Stojanoska ka qenë anëtare e Komitetit Ekzekutiv të VMRO-DPMNE. Ajo është stomatologe e diplomuar dhe magjistrante. Ka 43 vjet.




*Arben Taravari (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[126] është ministër aktual i Shëndetësisë. Para se të nominohet në këtë funksion ka punuar si mjek. Ai është bashkëpunëtor i lartë shkencor i lëndës Neurologji, në Klinikën Universitare për Neurologji. Nga viti 2011 në Klinikën Universitare të Neurologjisë u zgjodh për shef të repartit për migrena, dhimbje koke dhe për sindroma të tjera, si dhe kryetar i bordit të Klinikës Universitare për Neurologji. Taravari është autor i 8 librave nga fusha e neurologjisë të cilët përdoren si manual për studentët e mjekësisë në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. Ai ka 44 vjet

125 https://www.facebook.com/Дафина-Стојаноска-1799978110245044/
126 https://www.facebook.com/arbentaravari.mk/



*Komuna e Dibrës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 145 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 19 542 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (58,07%)<br>Maqedonas (20,01%)<br>Turq (13,73%)<br>Romë (5,53%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 15 |
| Buxheti për vitin 2016 | 279 204 000 |
| Adresa | 8 Shtatori nr. 72<br>Dibër |
| Telefoni | 046/ 831 196 |
| Ueb-faqja | http://www.dibra.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË DIBRËS



*Arben Agolli (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[127] është i punësuar në IPSH Pediatria në Dibër. Me profesion është mjek pediatër.



*Dragan Klopçevski (VMRO-DPMNE)*[128] është mjek në Shtëpinë e Shëndetit në Dibër. Ai ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, ndërsa arsimin e mesëm e ka kryer në Gjimnazin e Dibrës.

127 https://www.facebook.com/dr.arbenagolli
128 https://www.facebook.com/Драган-Клопчевски-311904212552932/





*Ruzhdi Lata (BDI)*[129] është kryetar i Komunës së Dibrës, i zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Para zgjedhjes në këtë funksion ai ka ligjëruar në Katedrën për Filologji Orientale në Universitetin Shtetëror të Tetovës nga viti 2009 dhe myfti i Myftinisë së Dibrës. Në Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë punon nga viti 1995, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup punon në periudhën kohore nga viti 1993 deri në vitin 1995 dhe përsëri nga viti 2009 deri më sot. Nga viti 1980 deri në vitin 1991 punon në Bashkësinë Fetare Islame, ndërsa ka ligjëruar edhe në Universitetin e Prishtinës. Ka përkthyer vepra nga gjuha arabe në gjuhën turke dhe gjithashtu ka publikuar vepra të tij. Ka diplomuar në Katedrën për Gjuhë Orientale në Fakultetin Filologjik pranë Universitetit të Prishtinës, ku ka magjistruar për shkenca filologjike. Ka 63 vjet.

*Petrit Klenja (PDSH)*




*Xhemail Çupi (BESA)*[130] është profesor në Universitetin e Prishtinës. Ai është doktor i shkencave politike në Universitetin e Evropës Juglindore në Shkup, ndërsa ka punuar edhe si klerik në BFI në rajonin e Dibrës.



*Shkëlqim Xhafa (Koalicioni Aleanca për Shqiptarët)*[131] është kryetar i degës në Dibër i partisë Uniteti. Ai, me profesion është ekonomist. Ka kryer Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës.

129 https://www.facebook.com/mr.ruzhdi.lata
130 https://www.facebook.com/xhemail.cupi.5
131 https://www.facebook.com/shkelqimxhafa2/

Komuna e Dellçevës

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 423 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 17 505 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (95,04%)<br>Romë (3,72%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 15 |
| Buxheti për vitin 2016 | 287 115 000 |
| Adresa | Svetozar Markoviq nr. 1 Dellçevë |
| Telefoni | 033/ 411 550 |
| Ueb-faqja | http://www.delcevo.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË DELLÇEVËS



*Goran Trajkovski (LSDM)*[132] është këshilltar në listën e këshilltarëve të LSDM në Komunën e Dellçevës. Në zgjedhjet e kaluara lokale, Goran Trajkovski ishte bartës i listës së këshilltarëve të LSDM. Në periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2013 ai është Kryetar i Organizatës Komunale të LSDM në Dellçevë.



*Ivan Sokollov (VMRO-DPMNE)*[133] është anëtar i Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacion. Në periudhën kohore nga viti 2006 deri në vitin 2014 ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Kullosat. Ka kryer arsim të mesëm. Ka 56 vjet.

132 https://www.facebook.com/GoranTrajkovskiZaDelcevo/
133 https://www.facebook.com/ivansokolovmk



Komuna e Kavadarit

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 1132 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 38 741 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (96,79%)<br>Romë (1,75%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | 811 013 000 |
| Adresa | Sheshi Marshall Tito p.n. Kavadar |
| Telefoni | 043/ 416 130 |
| Ueb-faqja | http://www.kavadarci.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KAVADARIT

*Verica Arsova (BPRM)*



*Boris Davidov (kandidat i pavarur)*[134] ka qenë këshilltar në Komunën e Kavadarit në periudhën kohore 2009-2013. Për një kohë të gjatë ka punuar si profesor, ndërsa më pas është marrë me biznes privat, duke bërë tregti me Turqinë dhe Kinën. Paraprakisht ka qenë oficer ushtarak në Pula, ndërsa më vonë është punësuar edhe në Komunën e Kavadarit. Ka diplomuar në Akademinë Ushtarake në Beograd, ka 70 vjet.



*Mitko Jançev (VMRO-DPMNE)*[135] është pronar dhe drejtor i SHPTSH Kozhuvçanka nga Kavadari, kompani private për prodhimin e ujit mineral në Maqedoni. Me profesion është inxhinier-gjeolog i diplomuar në Universitetin "Goce Dellçev"- Shtip, ndërsa studimet e magjistraturës i ka kryer në degën e shkencave teknike, metrologji, mineralogji dhe gjeokimi. Ai ka 36 vjet.

134 https://www.facebook.com/boris.davidov.73
135 https://www.facebook.com/MitkoJanchev/



*Betiane Kitev (LSDM)*[136] është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Paraprakisht, në mandatin 2009-2013 ai ka qenë këshilltar në Komunën e Kavadarit. Ai është magjistër i shkencave politike të Fakultetit Juridik në Shkup, ndërsa në muajin tetor të vitit 2008 ka diplomuar në Katedrën për Studime politike në të njëjtin fakultet. Ka lindur në vitin 1985 në Shkup.

136 https://www.facebook.com/Бетиан-Китев-274855852624468/

*Komuna e Kërçovës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 839 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 56 734 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (54,51%)<br>Maqedonas (35,74%)<br>Turq (5,28%)<br>Romë (2,87%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 518 683 000 |
| Adresa | Boris Kidriç nr. 1<br>Kërçovë |
| Telefoni | 045/ 223 001 |
| Ueb-faqja | http://www.kicevo.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KËRÇOVËS




*Fatmir Dehari (BDI)*[137] është kryetar i Komunës së Kërçovës. Në këtë funksion është zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Paraprakisht, në periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2013 ishte kryetar i Komunës së Osllomesë, e cila në vitin 2013 me Ligjin për ndarje territoriale iu bashkëngjit Kërçovës bashkë me Zajasin, Drugovën dhe Vraneshticën. Para vitit 2009 e ka ushtruar funksionin zëvendësminister i MPB dhe zëvendësdrejtor i SSHK, ndërsa para se ta marr funksionin e kryetarit të komunës ka qenë drejtor i NP Postat e Maqedonisë NJR Kërçovë. Ka diplomuar në Fakultetin e Arsimit Fizik pranë Universitetit të Prishtinës. Ka 42 vjet.



*Vllatko Sajkoski (VMRO-DPMNE)*[138] është ish anëtar i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve gjatë periudhës kohore nga viti 2011 deri në vitin 2014. Ai është jurist i diplomuar në Fakultetin Juridik në Shkup. Gjatë periudhës kohore nga viti 2006-2008, ka punuar si drejtor i NP për Furnizim me Ujë "Studençica" – Kërçovë. Ka lindur në vitin 1976 në Ohër.

137 https://www.facebook.com/Fatmir-Dehari-Faqja-Zyrtare-149762858516336/
138 https://www.facebook.com/VSajkoski/

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 382 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 38 092 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (93,12%)<br>Romë (5,12%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | 524 375 400 |
| Adresa | Rade Kratovçe nr. 1<br>Koçan |
| Telefoni | 033/ 274 001 |
| Ueb-faqja | http://www.kocani.gov.mк |

*Komuna e Koçanit*

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KOÇAN



*Ratko Dimitrovski (VMRO-DPMNE)*[139] është kryetar aktual i Komunës së Koçanit, ndërkaq ai ishte kryetar komune edhe gjatë periudhës kohore 2009-2013, nga viti 2006 deri në vitin 2009 ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ndërkaq është edhe themelues i shtypshkronjës "Evropa 92", e cila është njëra nga shtypshkronjat më të mëdha në Maqedoni. Në periudhën kohore nga viti 1977 deri në vitin 1990 ka punuar në shtypshkronjën "Kiro Dandaro" – Manastir dhe "Mlladost" – Koçan. Ka fituar diplomë për inxhinieri grafike në Zagreb. Dimitrovski ka 60 vjet.



*Nikollço Ilijev (LSDM)*[140] është sipërmarrës nga Koçani dhe drejtor i Kompanisë INT. Ai nuk është anëtar i LSDM, megjithatë është kandiduar si kandidat mbipartiak nga ana e organeve partiake.

*Metodi Jovanov (PSDM)*

139 https://www.facebook.com/RatkoDimitrovski/
140 https://www.facebook.com/Nikolco-Ilijev-174501533098459/



| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 481 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 20 820 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (96,06%)<br>Romë (3,21%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 19 |
| Buxheti për vitin 2016 | 355 338 500 |
| Adresa | Shën Joakim Osogovski nr. 175<br>Kriva Pallankë |
| Telefoni | 031/ 372 130 |
| Ueb-faqja | http://www.krivapalanka.gov.mk |

*Komuna e Kriva Pallankës*

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KRIVA PALLANKËS



*Arsenço Aleksovski (VMRO-DPMNE)*[141] e ushtron mandatin e tij të dytë si kryetar i Komunës së Kriva Pallankës. Para zgjedhjes në këtë funksion, në zgjedhjet lokale të vitit 2009 ai ishte pronar i kompanisë private "Transhped trejd SHPKNJP" të cilën e ka themeluar dhe e drejton nga viti 2006. Paraprakisht, 13 vjet ka punuar në "Transhped komerc" si udhëheqës i filialit "Deve Bair". Në periudhën kohore nga viti 1986 deri në vitin 1991 ka punuar në Ekonominë e Pyjeve "Osogovë" në Kriva Pallankë. Parakrakisht, 2 vjet ka qenë inspektor i MPB. Ai është jurist i diplomuar. Ka 56 vjet.

141 https://www.facebook.com/Arsenco.Gradonacalnik/



*Borjanço Micevski (LSDM)*[142] është anëtar i Këshillit të Komunës së Kriva Pallankës dhe kryetar i Organizatës Komunale të LSDM Kriva Pallankë. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013, Borjanço Micevski është bartës i listës së këshilltarëve të Koalicionit Aleanca për ardhmërinë nga LSDM në Kriva Pallankë. Ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Shkup, dega Kimi. Është anëtar i këshillit lokal për parandalim nga Kriva Pallanka, si dhe i Këshillit Lokal për Platformë nacionale për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe katastrofat në nivel lokal dhe rajonal. Ka lindur në vitin 1971 në Kriva Pallankë.

142 https://www.facebook.com/borjanchom/

*Komuna e Kumanovës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 509 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 105 484 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (60,43%)<br>Shqiptarë (25,87%)<br>Serbë (8,59%)<br>Romë (4,03%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 33 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 793 766 626 |
| Adresa | 11 Tetori p.n.<br>Kumanovë |
| Telefoni | 031/ 475 800<br>031/ 438 633 |
| Ueb-faqja | http://www.kumanovo.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË KUMANOVËS



*Zoran Gjorgjievski (VMRO-DPMNE)*[143] e ushtron mandatin e tij të dytë si deputet në Kuvendin e RM. Në këtë funksion, për herë të parë është zgjedhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Gjorgjievski kandidohet për herë të dytë për kryetar të Komunës së Kumanovës pasi që nuk u zgjodh në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Paraprakisht ai ka qenë shef i Repartit Kirurgjik në Spitalin e Përgjithshëm të Kumanovës. Në periudhën kohore nga viti 2002 deri në vitin 2010 ai ishte shef i Sektorit Kirurgjik. Ka kryer Fakultetin e Mjekësisë, ndërsa ka specializuar për kirurgji të përgjithshme. Ka 58 vjet.

143 https://www.facebook.com/drzorangjorgjievski/



*Maksim Dimitrevski (LSDM)*[144] është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë i zgjedhur në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2016. Ai është anëtarë shumëvjeçar i partisë dhe anëtar i udhëheqësis së LSDM në Komunën e Kumanovës. Maksim Dimitrievski për disa vite e ka ushtruar funksionin e kryetarit të Këshillit të Komunës së Kumanovës, prej ku ka dhënë dorëheqje për shkak të nominimit për deputet. Krahas angazhimit politik, ai është sipërmarrës privat që nga viti 1998. Ka lindur në vitin 1975 në Kumanovë.



*Bashkim Osmani (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[145]



*Driton Sulejmani (BESA)*[146] është anëtar i kryesisë së partisë politike BESA. Arsimin e mesëm e ka kryer në Gjimnazin "Goce Dellçev" në Kumanovë. Ka studiuar në Fakultetin e Biznes Administratës në Universitetin e Evropës Juglindore. Sulejmani ligjëron në Shkollën e Mesme "Cvetan Dimov" në Shkup.

*Besnik Memeti (PDSH)*

144 https://www.facebook.com/Maksim-Dimitrievski-590981394365638/
145 https://www.facebook.com/Bashkim-Osmani-913318788820470/
146 https://www.facebook.com/driton.sulejmani.906



*Komuna e Negotinës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 414 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 19 045 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (92,48%)<br>Serbë (3,26%)<br>Romë (2,36%)<br>Turq (1,26%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 15 |
| Buxheti për vitin 2016 | 550 921 000 |
| Adresa | Aco Axhi Ilov 2<br>Negotinë |
| Telefoni | 043/ 361 045 |
| Ueb-faqja | http://negotino.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË NEGOTINËS

*Gjorgji Ajtov (kandidat i pavarur)*



*Toni Dellkov (LSDM)*[147] është anëtar i Këshillit të Komunës së Negotinës gjatë periudhës kohore 2013-2017. Ai është sipërmarrës privat dhe ish-sportist, hendbollist në KH "Povardarie".

147 https://www.facebook.com/pg/delkovtoni



*Zllatko Penkov (VMRO-DPMNE)*[148] gjatë 6 viteve të fundit punon si udhëheqës i autorizuar në NJR Negotinë. Arsimin fillor e ka kryer në SHF "Goce Dellçev" në Negotinë, ndërsa arsimin e mesëm në Gjimnazin "Josip Broz Tito" në Negotinë. Ka diplomuar në Universitetin "Cirili e Metodi", Shkup, në Fakultetin e Bujqësisë. Posedon përvojë shumëvjeçare të punës në kompani private. Përvojën e tij në prodhimtarinë bujqësore e ka fituar duke kryer aktivitete pune në DZP Dubrovo nga Dubrovo. Ka punuar edhe në projekt të BE për Regjistrin Nacional të vreshtarisë pranë MBPEU NJR Negotinë. Ka lindur në Negotinë në vitin 1971.

148 https://www.facebook.com/zlatko.penkov.9





*Komuna e Ohrit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 390 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 55 749 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (84,93%)<br>Shqiptarë (5,31%)<br>Turq (1,26%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 108 502 627 |
| Adresa | Dimitar Vllahov 57<br>Ohër |
| Telefoni | 046/ 262 492 |
| Ueb-faqja | http://www.ohrid.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË OHRIT



*Jovan Stojanoski (LSDM)*[149] është anëtar shumëvjeçar i LSDM dhe koordinator i grupit të këshilltarëve të LSDM në Komunën e Ohrit. Ai është profesor në Fakultetin për Turizëm dhe Hoteleri në Ohër nga viti 2003. Ka diplomuar dhe magjistruar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Ka doktoruar në fushën e Turizmit Ndërkombëtar në Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir. Ka lindur në vitin 1970.



*Stevçe Stevoski (kandidat i pavarur)*[150] ka diplomuar në Fakultetin për Siguri, ndërsa specializimi i tij është krimi i organizuar në ndërmarrjet shtetërore dhe publike. Stevçe Stevoski ka lindur në vitin 1967, në fshatin Elshan të Ohrit.

149 https://www.facebook.com/prof.dr.jovan.stojanoski/
150 http://ohridpress.com.mk/?p=73794



*Mitko Tilevski (VMRO-DPMNE)*[151] është doktor në Spitalin Special për Ortopedi dhe traumatologji "Shën. Erazmo" - Ohër. Deri para një kohe, Tilev e ka ushtruar funksionin e drejtorit të këtij institucioni shëndetësor. Ai, gjatë periudhës kohore nga viti 1998 deri në vitin 2002 ka qenë deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga VMRO-DPMNE. Tilev është specialist-pediatër dhe ka kryer Fakultetin e Mjekësisë. Ka 55 vjet.

151 https://www.facebook.com/mitkotilevski/



*Komuna e Prilepit*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 1194 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 76 768 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (92,35%)<br>Romë (5,77%)<br>Turq (1,19%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 27 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 165 284 000 |
| Adresa | Prilepsi braniteli p.n.<br>Prilep |
| Telefoni | 048/ 401 701 |
| Ueb-faqja | http://www.prilep.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË PRILEPIT



*Ilija Jovanoski (LSDM)*[152] është koordinator i grupit të këshilltarëve të LSDM në Këshillin e Komunës së Prilepit në përbërjen nga viti 2013-2017. Me profesion është doktor, ndërsa në vitin 2017 Ilija Jovanoski është caktuar si Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Prilep. Ai është nënkryetar i Shoqatës së Mjekëve të Maqedonisë nga viti 2002. Ka lindur në vitin 1956 në Prilep.



*Marjan Risteski (VMRO-DPMNE)*[153] e ushtron mandatin e tij të tretë si kryetar i Komunës së Prilepit. Për herë të parë është zgjedhur për kryetar komune në zgjedhjet lokale të vitit 2005. Nga viti i njëjtë është anëtar i Bordit Drejtues të BNJVL. Para se të bëhet kryetar i komunës, ka punuar si inspektor komunal në vetëqeverisjen lokale në Prilep. Ka diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në Prilep. Ka 45 vjet.

152 https://www.facebook.com/ilija.jovanoski.90
153 https://www.facebook.com/gradonacalnikpp/

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 739 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 16 825 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (76,07%)<br>Turq (10,68%)<br>Shqiptarë (9,13%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 15 |
| Buxheti për vitin 2016 | 300 071 623 |
| Adresa | Sheshi - Car Samoil nr. 20<br>Resnjë |
| Telefoni | 047/ 551 481 |
| Ueb-faqja | http://www.resen.gov.mk |

*Komuna e Resnjës*

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË RESNJËS



*Zhivko Gosharevski (LSDM)*[154] është anëtar i Këshillit të Komunës së Resnjës nga zgjedhjet lokale të vitit 2013. Ai është anëtar shumëvjeçar i LSDM. Zhivko Gosharevski është pronar i ordinancës private stomatologjike.



*Gjoko Strezovski (VMRO-DPMNE)*[155] për herë të parë e ushtron mandatin e tij si kryetar i Komunës së Resnjës. Para zgjedhjes në këtë funksion në zgjedhjet lokale të vitit 2013 ai ka punuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si zëdhënës në SPB Manastir, por për shkak të kandidaturës për kryetar të komunës e ka pezulluar marrëdhënien e tij të punës. Paraprakisht ka punuar edhe si këshilltar i lartë në kabinetin e ministrit të Punëve të Brendshme, si dhe si shef i OPB Resnjë. Strezovski ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe është magjistër për menaxhment të arsimit. Ka 53 vjet.

154 http://www.ohridsky.com/живко-гошаревски-е-кандидатот-на-сдсм/
155 https://www.facebook.com/Ѓоко-Стрезовски-512017292217770/



| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 507 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 65 375 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (56,85%)<br>Maqedonas (32,09%)<br>Turq (5,72%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 27 |
| Buxheti për vitin 2016 | 914 947 000 |
| Adresa | Sheshi – Nënë Tereza p.n.<br>Strugë |
| Telefoni | 046/ 781 223 |
| Ueb-faqja | http://www.struga.gov.mk |

*Komuna e Strugës*

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË STRUGËS



*Vasill Ashtallkoski (LSDM)*[156] është menaxher i diplomuar për doganë dhe shpedicion në Fakultetin për Turizëm dhe Hoteleri në Ohër. Arsimin e mesëm e ka kryer në SHMK “Niko Nestor” – Strugë. Ka punuar në pozita të ndryshme në sektorin privat dhe joqeveritar. Nga viti 2017 është emëruar si zëvendësdrejtor në INK në Strugë. Ka lindur në vitin 1976 në Strugë.




*Ramiz Merko (BDI)*[157] është ministër pa resor në Qeveri, i angazhuar për investime të huaja. Para se të caktohet në këtë funksion, në periudhën kohore nga viti 2014 deri në zgjedhjet e vitit 2016 ka qenë deputet në Kuvendin e RM. Paraprakisht, në periudhën kohore nga viti 2005 deri në vitin 2013 Merko në dy mandate të njëpasnjëshme ka qenë kryetar i Komunës së Strugës. Nga viti 2003 deri në vitin 2005 ka qenë udhëheqës i Fondit për Shëndetësi në Strugë, ndërsa nga viti 1983 deri në vitin 1999 ka qenë referent i lartë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë. Ai është ekonomist i diplomuar. Ka 60 vjet.

156 https://www.facebook.com/Васил-Ашталкоски-Кандидат-за-градоначалник-на-општина-Струга-349623068811442/
157 https://www.facebook.com/Ramiz-Merko-Faqja-Zyrtare-1470970386454894/



*Nasto Palioski (LPM)*[158] është pensionist, ndërsa ka qenë ish-nënkryetar i komitetit jashtëkufitar të VMRO-DPMNE për Evropën. Në vitin 1999 Palioski është zgjedhur për kryetar të Kongresit Maqedonas për Evropën. Ai jeton në Munih tanimë 40 vjet.




*Ziadin Sela (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[159] është deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në legjislaturën aktuale, pozitë për shkak të të cilës dha dorëheqje nga funksioni kryetar i Komunës së Strugës, të cilën e ushtroi gjatë periudhës kohore 2013-2016. Paraprakisht, Ziadin Sela ka qenë deputet në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës kohore 2011-2013. Ai është lider i partisë politike "Aleanca për Shqiptarët". Arsimin e mesëm e ka kryer në Prishtinë, ndërsa studimet i ka vazhduar në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Tiranës. Ka lindur në vitin 1972 në fshatin Livadhi të Strugës.



*Sejad Sollakoski (VMRO-DPMNE)*[160] me profesion është doktor. Arsimin e lartë e ka kryer në Fakultetin e Mjekësisë në Pleven të Bullgarisë, dega mjekësi e përgjithshme. Selakoski është i punësuar në IPSH Poliklinika Meniks në Labunisht si mjek amë. Anëtar i VMRO-DPMNE është nga viti 2014. Ka 37 vjet.

[158] https://www.facebook.com/nasto.palioski.3
[159] https://www.facebook.com/ZiadinS/
[160] https://www.facebook.com/solakoskisejad/



*Komuna e Strumicës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 32 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 54 676 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (32,09%)<br>Turq (6,87%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 075 947 734 |
| Adresa | Sando Masev nr. 1<br>Strumicë |
| Telefoni | 034/ 348 030 |
| Ueb-faqja | http://www.strumica.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË STRUMICËS



*Marjan Bajraktarov (VMRO-DPMNE)*[161] është kirurg oral me ordinancë stomatologjike private në Strumicë. Në periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Strumicës, ndërsa nga viti 2005 deri në vitin 2007 ka qenë kryetar i organizatës komunale të VMRO-DPMNE në Strumicë. Bajraktarov është stomatolog i diplomuar, specialist për kirurgji orale. Ai ka 52 vjet.



*Kosta Janevski (LSDM)*[162] është deputet nga radhët e LSDM në Kuvendin e Pepublikës së Maqedonisë. Para se të bëhet deputet, Kosta Janevski ka qenë anëtar i Këshillit të Komunës së Strumicës nga zgjedhjet lokale të vitit 2013. Me profesion Janevski është Specialist për mjekësi interne. Ka lindur në vitin 1960 në Shtip.

[161] https://www.facebook.com/MarjanBajraktarov/
[162] https://www.facebook.com/kostajanevski4/

*Komuna e Tetovës*

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 1080 $km^2$ |
| Numri i banorëve | 86 580 |
| Struktura etnike e popullsisë | Shqiptarë (70,32%)<br>Maqedonas (23,16%)<br>Romë (2,72%)<br>Turq (2,17%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 31 |
| Buxheti për vitin 2016 | 1 967 097 578 |
| Adresa | Dervish Cara p.n.<br>Tetovë |
| Telefoni | 044/ 511 930 |
| Ueb-faqja | http://www.tetova.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË TETOVËS



*Teuta Arifi (BDI)*[163] është kryetare e Komunës së Tetovës, e zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Në periudhën kohore nga viti 2011 deri në shkurt të vitit 2013 ka qenë zëvendëse e kryetarit të Qeverisë, e angazhuar për çështje evropiane. Ka paraqitur dorëheqje nga kjo pozitë për shkak të kandidimit për kryetar të Komunës së Tetovës. Paraprakisht, nga viti 2002 deri në vitin 2011 ka qenë deputete në Kuvendin e RM. Ajo është doktore e shkencave filologjike. Një vit ka ligjëruar në Fakultetin Filologjik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi", ndërkohë që ka qenë edhe profesoreshë në Universitetin e Evropës Juglindore, ku nga viti 2001 deri në vitin 2006 është edhe dekane në Fakultetin Pedagogjik. Para se ty hyjë në politikë ka qenë aktive në disa organizata qytetare. Arifi është shkrimtare dhe autore e disa punimeve shkencore. Ka 47 vjet.

163 https://www.facebook.com/teutaarifiofficial/





*Bardhyl Dauti (PDSH)*[164] është deputet në Kuvendin e RM. Në këtë funksion është zgjedhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016. Ai është nënkryetar i PDSH. Dauti është doktor i shkencave ekonomike, ka doktoruar në Universitetin e Lubjanës. Ligjëron në Universitetin për biznes dhe teknologji në Prishtinë dhe në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Ka 35 vjet.



*Bilal Kasami (BESA)*[165] është kryetar i partisë politike BESA. Ka diplomuar, magjistruar dhe doktoruar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Shën Cirili e Metodi" në Shkup. Nga viti 2000 deri në vitin 2004 Bilal Kasami ka punuar në Drejtorinë e Doganave të Republikës së Maqedonisë, ndërsa nga viti 2004 deri në vitin 2006 ka ushtruar funksionin e sekretarit shtetëror në Ministrinë e Ekonomisë. Në vitin 2009 ka punuar në sektorin privat, ndërsa nga viti 2009 dhe deri në vitin 2011 ka punuar si profesor në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik. Ka lindur në vitin 1975 në Tetovë.



*Goran Manojllovski (VMRO-DPMNE)*[166] është deputet në Kuvendin e RM i zgjedhur në zgjedhjet e vitit 2016. Paraprakisht, në zgjedhjet lokale të vitit 2013 është kandiduar për kryetar të Komunës së Tetovës. Ai është kryetar i Organizatës Komunale të VMRO-DPMNE në Tetovë. Manojlloski është doktor, specialist internist, kardiolog intervent. Ka 40 vjet.



*Adnan Neziri (Partia politike Aleanca për Shqiptarët)*[167] ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës. Arsimin e mesëm e ka kryer në Gjimnazin "Kiril Pejçinoviq" në Tetovë. Gjatë periudhës kohore nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka punuar si udhëheqës i financave në Komunën e Tetovës. Neziri ka qenë kryetari i parë i degës së Lëvizjes për Reforma në PDSH të udhëhequr nga Ziadin Sela.

164 http://sobranie.mk/demokratska-partija-na-albancite-2016-ns_article-bardulj-dauti-16.nspx
165 https://www.facebook.com/bilallkasami1/
166 http://sobranie.mk/vmro-dpmne-2016-ns_article-goran-manojloski-16.nspx
167 https://www.facebook.com/adnannezirii

Komuna e Shtipit

| | |
|---|---|
| Sipërfaqja | 556 km$^2$ |
| Numri i banorëve | 47 796 |
| Struktura etnike e popullsisë | Maqedonas (87,19%)<br>Romë (4,59%)<br>Vlleh (4,34%)<br>Turq (2,66%) |
| Numri i anëtarëve të këshillit | 23 |
| Buxheti për vitin 2016 | 916 879 000 |
| Adresa | Vasill Gllavinov p.n. Shtip |
| Telefoni | 032/ 266 600 |
| Ueb-faqja | http://www.stip.gov.mk |

## KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË SHTIPIT



*Bllagoj Boçvarski (LSDM)*[168] është deputet nga radhët e LSDM në përbërjen aktuale parlamentare dhe nënkryetar i LSDM nga viti 2017. Ka diplomuar në Fakultetin Arkitektonik në Shkup. Anëtarë i LSDM është nga viti 2002, ndërsa nga viti 2013 është anëtarë i Këshillit Ekzekutiv të partisë. Në vitin 2017 është anëtar i Këshillit Qendror. Para se të bëhet deputet ka punuar si arkitekt në kompani private ndërtimi. Ka lindur në vitin 1985 në Shtip.

168 https://www.facebook.com/bocvarski





*Ilço Zahariev (VMRO-DPMNE)*[169] është kryetar i Komunës së Shtipit, i zgjedhur në zgjedhjet lokale në vitin 2013. Para zgjedhjes në këtë funksion ka qenë drejtor i Byrosë për barna, funksion të cilin e ka ushtruar dy herë, herën parë në periudhën kohore nga viti 2001 deri në vitin 2003 dhe nga viti 2006 deri në vitin 2013. Në vitin 2005 dhe 2006 ka qenë anëtar dhe kryetar i Këshillit të Komunës së Shtipit. Në periudhën nga viti 1985, ndërsa me ndërprerje deri në vitin 2006, ka punuar si udhëheqës i njësisë punuese barnatore në Qendrën Mjekësore në Shtip. Gjithashtu, ka qenë profesor inordiner në Shkollën e Mesme të Mjekësisë. Ai është magjistër i farmacisë. Zahariev është 56 vjeçar.

169 https://www.facebook.com/ilcozahariev1/

| KOMUNA | KANDIDATË PËR KRYETAR TË KOMUNËS | KANDIDATË TË PARAQITUR |
|---|---|---|
| Haraçinë | Isuf Bislimi<br>Ali Ismail<br>Milikije Halimi<br>Isen Ramadani | BDI<br>Lëvizja BESA<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Partia politike Aleanca për Shqiptarët |
| Berovë | Nikolla Atanasov<br>Xvonko Pekevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Bogdanci | Nikolla Roglev<br>Bllazhe Shipov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Bogovinë | Minur Asani<br>Berzah Bejtullahu<br>Elvir Iseni<br>Albon Xhemaili<br>Vebi Xhemaili | Lëvizja BESA<br>BDI<br>PDSH<br>Partia politike Aleanca për Shqiptarët<br>PPD |
| Bosilevë | Zoran Zimbakov<br>Lupço Kolev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Bërvenicë | Seljatin Jusufi<br>Enver Pajaziti<br>Mirko Stojanovski<br>Stojan Todoroski | Lëvizja BESA<br>Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |

| | | |
|---|---|---|
| Vallandovë | Pero Kostadinov<br>Stojan Manolev<br>Nikolçe Çurlinovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Vasilevë | Marjan Janev<br>Vanço Stojanov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Vevçan | Sasho Jankoski<br>Cvetomir Ugrinoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Vinicë | Ivica Dimitrov<br>Martin Pavllov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Vrapçisht | Erdal Ahmedi<br>Sami Aliji<br>Daut Demiri<br>Rexhep Rexhepi<br>Gajur Rushiti<br>Isen Shabani | PDTM<br>PDSH<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Lëvizja BESA<br>BDI<br>Partia politike Aleanca për Shqiptarët |
| Gradsko | Robert Beshovski<br>Ivançe Ivanov<br>Ligur Kocev<br>Zhaklina Çaushevska | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Grup zgjedhësish<br>Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Debërcë | Jadranka Biban<br>Zoran Nogaçeski<br>Igor Trajkoski | Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |

| | | |
|---|---|---|
| Demir Kapi | Trajçe Dimitriev<br>Llazar Petrov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Demir Hisar | Lupço Bllazhevski<br>Marjançe Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Dojran | Toni Ajcev<br>Ango Angov<br>Snezhana Maneva<br>Borçe Stamov | Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Dollnen | Erol Abdiu<br>Exhevit Ajdaroski<br>Peco Vajgaleski<br>Zekirija Jusufi<br>Bilal Karishik<br>Ismet Qamili<br>Xhemil Qamili | PDSH<br>Lëvizja për Unitet Nacional të Turqve<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Partia politike Aleanca për Shqiptarët<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Lëvizja BESA<br>BDI |
| Zhelinë | Sali Ajdini<br>Reshat Alii<br>Fatmir Izairi<br>Blerim Sejdi | PDSH<br>Partia politike Aleanca për Shqiptarët<br>BDI<br>Lëvizja BESA |
| Zelenikovë | Borçe Gievski<br>Aleksandar Manevski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |

| | | |
|---|---|---|
| Zërnovc | Kiro Kocev<br>Vanço Mitev<br>Metodi Nikollov<br>Bllazhe Stankov | Partia Socialdemokrate e Maqedonisë - PSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Ilinden | Martina Ivkovska<br>Zhika Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Jegunoc | Orhan Amiti<br>Darko Bllazheski<br>Besar Emini<br>Toni Koceski | BDI<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Lëvizja BESA<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Karbinci | Zoran Minov<br>Jordan Nasev<br>Goran Paunov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Lëvizja Popullore për Maqedoni |
| Konçe | Bllagoj Iliev<br>Bllagoj Jovanov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Kratovë | Mite Andonovski<br>Lupço Bojaxhiev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Krivogashtan | Toni Zatkoski<br>Rubinco Shefteroski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |

| | | |
|---|---|---|
| Krushevë | Gjorgji Damçeski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Tome Hristoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Likovë | Bekim Afuzi | Partia politike Aleanca për Shqiptarët |
| | Erkan Arifi | BDI |
| | Bardhyl Destani | PDSH |
| | Shaban Zendeli | Lëvizja BESA |
| | Hadi Osmani | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Llozovë | Aco Vellkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Gorjan Ivanov | Lëvizja Popullore për Maqedoni |
| | Jordan Ilievski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Mavrovë dhe Rostushë | Alim Bilali | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Nahmir Gale | Grup zgjedhësish |
| | Medat Kurtovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Makedonska Kamenicë | Darko Mitevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Sonja Stamenkova | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Makedonski Brod | Millosim Vojneski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Zharko Zllateski | Grup zgjedhësish |
| | Zhivko Siljanoski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Dragisha Terzioski | Partia Socialdemokrate e Maqedonisë - PSDM |

| | | |
|---|---|---|
| Mogilë | Jasmina Gullevka | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Stevo Pivkovski | Grup zgjedhësish |
| | Zorançe Sakurmovski | Lëvizja Popullore për Maqedoni |
| Novaci | Llazar Kotevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Lube Kuzmanovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Peco Micevski | Grup zgjedhësish |
| Novo Sellë | Blllazho Vellkov | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Boro Stojçev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Dragan Trajkov | Lëvizja Popullore për Maqedoni |
| Petrovec | Zvonko Cvetkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Borçe Mitevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Pehçevë | Igor Popovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| | Dragan Trençovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Pllasnicë | Shpresim Ajroski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Ismail Jahoski | BDI |
| Probishtip | Dragan Atanasov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| | Goran Stoilkovski | Grup zgjedhësish |
| | Toni Tonevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |

| | | |
|---|---|---|
| Radovish | Jure Gjorgjiev<br>Gerasim Konzullov<br>Sashko Nikollov | Grup zgjedhësish<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Rankovc | Robert Simonovski<br>Ivica Toshevski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Grup zgjedhësish |
| Rosoman | Branko Janev<br>Stojançe Llazov | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Sveti Nikollë | Sasho Vellkovski<br>Zoran Tasev | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Sopisht | Dalibor Bogdanovski<br>Stefçe Trpkovski | Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE |
| Nagoriçan i Vjetër | Elena Jaqimoviq<br>Zhaklina Jovanovska<br>Millosh Stojmanovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>Lëvizja Popullore për Maqedoni |
| Studeniçan | Mexhit Imeri<br>Femi Jonuzi<br>Rexhep Memeti<br>Akija Mustafovski<br>Azem Sadiki | Partia politike Aleanca për Shqiptarët<br>BDI<br>Lëvizja BESA<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM<br>PDSH |

| | | |
|---|---|---|
| Tearcë | Isen Asani<br>Nevzat Velijii<br>Vojo Gogovski<br>Amir Elezi<br>Ruhan Ilazi<br>Bobi Petrushevski | BDI<br>Partia politike Aleanca për Shqiptarët<br>VMRO-DPMNE<br>Lëvizja BESA<br>PDSH<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Qendra Zhupë | Arijan Ibraim<br>Nevaip Ismail | Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Çashkë | Zoran Zdravevski<br>Goranço Panovski<br>Goran Stojanovski | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Lëvizja Popullore për Maqedoni<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Çeshinovë-Obleshevë | Goranço Zashov<br>Goranço Krstev | Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE<br>Koalicioni i udhëhequr nga LSDM |
| Çuçer Sandevë | Jovan Pejkovski<br>Aco Popovski<br>Goran Çekalloviq | Grup zgjedhësish<br>Grup zgjedhësish<br>Lëvizja Popullore për Maqedoni |

# ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË TË VITIT 2017 - REZULTATE, FUSHATA, VLERËSIME

## HYRJE

Më 15 tetor të vitit 2017 u mbajtën zgjedhjet lokale të gjashtat me radhë nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë. Zgjedhjet u realizuan në 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit, me ç'rast sipas sistemit të shumicës u votua për kryetarë të komunave dhe për kryetar të Qytetit të Shkupit, ndërsa anëtarët e këshillave u zgjodhën sipas modelit proporcional. Personat e sëmurë dhe të pamundur, personat në arrest shtëpiak dhe të burgosurit në institucionet ndëshkuese-korrektuese votuan një ditë para mbajtjes së dy rretheve, përkatësisht më datë 14 dhe 28 tetor. Në votim dolën gjithsej 1.079.876 nga gjithsej 1.814.644 votues të regjistruar në Listën e zgjedhësve, me çka dalja në rrethin e parë ishte 59,51%. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve, dalja u zvogëlua dhe ishte 51,92%. Krahasuar me zgjedhjet e kaluara lokale të muajit mars të vitit 2013 kur dalja ishte 66,81% në rrethin e parë dhe 64,9% në rrethin e dytë.[170]

Zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë, sipas dinamikës paraprake, mbaheshin në çdo katër vjet në gjysmën e dytë të muajit mars. Mirëpo, për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe proceseve gjatë periudhës kohore 2016 dhe 2017, zgjedhjet lokale në vitin 2017 u prolonguan dhe u mbajtën në muajin tetor. Procesin e votimit e zbaton administrata treshkallëshe zgjedhore e udhëhequr nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) si trup i zgjedhur profesional, pastaj komisionet komunale të zgjedhjeve, si organe joprofesionale dhe 3.480 këshilla zgjedhorë të cilët i zbatuan zgjedhjet në vendet e votimit.

Për 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit gjithsej garuan 223 kandidatë për kryetarë të komunave. Të pavarur ose në koalicion, me kandidatë

170 Shih: Dalja në zgjedhje lokale, Komisioni Zgjedhor i Zgjedhjeve. Dalja në rrethin e parë: https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1 Dalja në rrethin e dytë: https://rezultati.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1 (vizita e fundit: 14 nëntor 2017)

të tyre për kryetarë të komunave morën pjesë 17 subjekte politike, prej të cilave 3 koalicione dhe 14 parti politike: Koalicioni "Për një Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët (Uniteti, RDK)", VMRO-DPMNE[171], Bashkimi Demokratik për Integrim, Opsioni Qytetar për Maqedoni, Lëvizja BESA, Lëvizja për Bashkimin Nacional të Turqve, Partia Demokratike Shqiptare, Partia Demokratike e Turqve nga Maqedonia, Levica, Lëvizja Popullore për Maqedoni, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, Lidhja e Romëve nga Maqedonia, Partia Social-demokrate e Maqedonisë, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas, (BPRM). Për anëtarët e këshillave të komunave dhe këshillit të Qytetit të Shkupit gjithsej u paraqitën 373 lista për kandidatë për këshilltarë nga gjithsej 19 subjekte politike.[172]

Zgjedhjet lokale u shpallën më 6 gusht, me ç'rast filluan të rrjedhin afatet për realizimin e tyre. Fushata zgjedhore sa i përket rrethit të parë zyrtarisht filloi më 25 shtator dhe zgjati deri më 13 tetor në mesnatë. Fushata për rrethin e dytë vazhdoi menjëherë pas ditës së zgjedhjeve më datë 15 tetor dhe zgjati deri më 27 tetor në mesnatë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale u mbajt më 29 tetor, ndërsa rivotim kishte vetëm në Komunën e Çairit, i cili u mbajt më 12 nëntor. Këto zgjedhje i vëzhguan gjithsej 6.082 vëzhgues. Prej tyre 5.609 vëzhgues vendor dhe 473 të huaj[173]. Vlerësimi i përgjithshëm i vëzhguesve është se zgjedhjet lokale ishin mirë të menaxhuara dhe u zbatuan në një atmosferë të qetë, me incidente të izoluara dhe me mangësi të caktuara në disa prej vendeve të votimit. Si një nga vërejtjet theksohet mosrespektimi i ndarjes midis shtetit dhe partisë, veçanërisht përmes premtimeve

[171] VMRO-DPMNE në mënyrë të pavarur mori pjesë në Komunën e Tearcës.

[172] Përveç 17 subjekteve të cekura politike, kandidatë të tyre për këshilltarë paraqitën dy subjekte plotësuese politike, përkatësisht dy koalicione: Besa, Aleanca për Shqiptarët i udhëhequr nga BDI (në Manastir, Ohër dhe Gazi Babë) dhe nga Femih Bejllurov në Gazi Babë.

[173] Tabela e vëzhguesve të akredituar – Zgjedhje lokale 2017, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I akesesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zMVB-KUEdVQjZkTnM/view (vizita e fundit: 09.11.2017)

që i dha kryeministri për mbështetjen qeveritare të komunave me kryetar komune nga partia në pushtet. Raportimi mediatik gjatë mbulimit të kandidatëve në mënyrë të përgjithshme është përshkruar si i paanshëm e që e ka ndihmuar debatin politik. Partitë në pushtet zgjedhjet i vlerësuan si të ndershme dhe demokratike, ndërsa për partitë opozitare këto zgjedhje janë jolegale.

Zgjedhjet, në mënyrë drastike, e ndryshuan proporcionin e kryetarëve të komunave midis dy partive më të mëdha politike VMRO-DPMNE dhe LSDM. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 57 vende të kryetarëve të komunave e që është për 53 kryetarë të komunave më shumë nga zgjedhjet e kaluara. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 5 vende të kryetarëve të komunave, përkatësisht 51 më pak në krahasim me zgjedhjet paraprake. BDI fitoi 10 vende të kryetarëve të komunave e që është për 4 më pak në krahasim me zgjedhjet paraprake. Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, e cila si subjekt i veçantë politik, për herë të parë mori pjesë në këto zgjedhje lokale, fitoi 3 vende të kryetarëve të komunave, nga një kryetar komune fituan BESA, PDSH dhe PDT, ndërsa 3 vende të kryetarëve të komunave i fituan kandidatë të pavarur.[174]

Në vazhdim të këtij Manuali është prezantuar një vështrim i detajuar lidhur me: fushatën zgjedhore, të ardhurat dhe shpenzimet e partive dhe koalicioneve gjatë fushatës zgjedhore, raportimin e mediave, rezultatet e zgjedhjeve, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të zgjedhësve, vlerësimin e zgjedhësve nga vëzhguesit dhe nga partitë politike, si dhe konkluzionet përmbledhëse për ciklin e përgjithshëm zgjedhor.

[174] Shih: Rezultatet e zgjedhjeve lokale, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Rezultatet nga rrethi i parë: https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1. Rezultate nga rrethi i dytë:https://rezultati.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1. (vizita e fundit: 14 nëntor 2017)

## FUSHATA ZGJEDHORE DHE FINANCIMI

Fushata për rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, zyrtarisht filloi më 25 shtator dhe zgjati deri më 13 tetor në mesnatë. Fushata për rrethin e dytë vazhdoi menjëherë pas ditës zgjedhore më 15 tetor dhe zgjati deri më 27 tetor në mesnatë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale u mbajt më 29 tetor. Një rivotim, përkatësisht rreth i tretë u mbajt vetëm në një vendvotim në Komunën e Çairit më 12 nëntor.

Partitë, në masë të madhe, i shfrytëzonin metodat e zakonshme për promovim, siç janë: mitingjet, takimet me qytetarë, fushata "nga dera në derë", reklamat televizive, ndërsa u vërejt edhe një përfaqësim më i madh në mediat sociale. Përveç faktit që një pjesë e madhe e kandidatëve zhvilluan fushatë pozitive, retorika e ashpër dhe negative nuk mungoi edhe kësaj radhe. Në fokus të fushatës ishin çështjet në lidhje me të dhënat për korrupsion të ish-funksionarëve dhe funksionarëve aktual, migrantët dhe refugjatët nga rajonet e krizës në botë, problemet me ndotjen e mjedisit jetësor, hapja e vendeve të punës, ekonomia, shpërngulja e të rinjve, si dhe probleme konkrete me të cilat ballafaqohen komunat.

Sipas Misionit monitorues të OSBE/ODIHR, gjatë fushatës zgjedhore partitë kishin mundësi lirisht t'i zhvillojnë fushatat e tyre, me ç'rast u respektua liria e bashkimit, tubimit dhe liria e të shprehurit. Megjithatë, Misioni pas rrethit të parë nënvizoi se ekzistojnë të dhëna kredibile për blerjen e votave, presion mbi votuesit dhe raste të izoluara të dhunës që ndodhën në periudhën parazgjedhore. Mediat e monitoruara ofruan mbulim të paanshëm të garuesve dhe e mbështetën mundësinë për debat politik. Edhe pse u vërejtën disa parregullsi procedurale, dita zgjedhore kryesisht kaloi në rregull, u prononcuan vëzhguesit. Theksohet se gjatë fushatës u regjistruan disa incidente të izoluara midis të cilave edhe sulmi ndaj Elvis Bajram, kandidat për kryetar të Komunës së Shuto Orizarës.

Gjatë periudhës së fushatës të rrethit të parë më 27 shtator në Kërçovë, në një sulm të armatosur u qëllua me armë zjarri, ndërsa dhjetë ditë më vonë ndërroi jetë Alit Abazi bartës i listës së pavarur të këshilltarëve, ndërsa u plagos edhe shefi i shtabit të tij zgjedhor Destan Abdiu. Prokuroria, e cila e hulumtoi ngjarjen, e hodhi poshtë motivimin politik dhe lidhjen e sulmit me procesin zgjedhor.[175]

Si pjesë e fushatës, përveç pjesëmarrjes dhe diskutimeve të rregullta mediatike, u organizuan më shumë ballafaqime mediatike midis kandidatëve për kryetarë të komunave në pjesën më të madhe të televizioneve me koncesione nacionale. Në këtë aspekt u vërejt refuzimi i kandidatëve të LSDM të marrin pjesë në debate të organizuara nga televizione siç janë "Nova" dhe "Alfa" të cilët këto media i perceptojnë si media që e mbështesin VMRO-DPMNE. Nga ana tjetër, kandidatë të VMRO-DPMNE refuzuan të marrin pjesë në debate të organizuara nga televizionet siç janë "Telma" dhe "24 Vesti", të cilat ata i perceptojnë si media që e mbështesin LSDM. Këto ishin shkaqet për të cilat nuk u realizua ballafaqimi i drejtpërdrejtë televiziv të kandidatit të LSDM dhe VMRO-DPMNE për kryetar të Qytetit të Shkupit midis Petre Shilegov dhe Koce Trajanovski.

Në këtë cikël zgjedhor përshtypje la ajo që kandidatët e partive më të mëdha, në pjesën më të madhe të tyre, u përmbajtën nga retorika sulmuese në bazë etnike. Përveç kësaj, një pjesë e partive i përkushtuan vëmendje edhe votuesve nga bashkësitë e tjera etnike. Kjo ishte më karakteristike për Koalicionin e udhëhequr nga LSDM i cili në disa komuna në mënyrë transparente i mbështeti kandidatët e BDI, siç ishte rasti në Komunën e Çairit, Tetovës dhe Strugës, ndërsa në komunat: Haraçinë dhe Shuto Orizarë me popullsi dominante të nacionalitetit shqiptar dhe rom propozoi edhe kandidatë të vet të cilët fituan në zgjedhje. Nga ana tjetër, BDI haptas e thirri anëtarësinë dhe

175 "Ndërroi jetë kandidati i pavarur nga Kërçova nëntë ditë pas sulmit" "Telma" 5 tetor 2017. I aksesshëm në: http://telma.com.mk/vesti/pochina-nezavisniot-kandidat-od-kichevo-devet-dena-po-napadot (vizita e fundit 15 nëntor 2017)

simpatizantët e saj në Shkup dhe Kumanovë t'i mbështesin kandidatët e LSDM. Karakteristikë e fushatës ishte edhe ajo se VMRO-DPMNE, në më shumë komuna me popullsi të përzier etnike, si dhe në më shumë media i plasonte sloganet e saj zgjedhor dhe materialet promovues edhe në gjuhën shqipe. Përjashtim nga kjo tendencë kishte fushata e partisë Aleanca për Shqiptarët e udhëhequr nga Ziadin Sela e cila u mbështet mbi bazën etnike. Në tre komuna, një pjesë e partive të shqiptarëve formuan koalicione dhe bashkërisht morën pjesë në fushatë. Partia BDI, Lëvizja Besa dhe Aleanca për Shqiptarët morën pjesë me lista të përbashkëta për këshilltarë në Komunën e Gazi Babës, Manastirit dhe Ohrit.

Koalicioni i udhëhequr nga LSDM e udhëhoqi fushatën si vazhdimësi të fushatës të zgjedhjeve parlamentare në dhjetor të vitit 2016 duke e përdorur sloganin e njëjtë "Jetë për të gjithë në Maqedoni". Në një pjesë të fushatës koalicioni përveç ofertës së zgjidhjeve të problemeve të qytetarëve, në një pjesë e vazhdoi edhe fushatën negative kundër oponentëve nga VMRO-DPMNE të filluar që nga zgjedhjet parlamentare, duke i ndërlidhur kandidatët me skandale korruptive ose me persona nga kjo parti për të cilët janë hapur hetime ose janë ngritur akuza. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fushatën e udhëhoqi me sloganin "Fillon epoka e re" dhe "Gjithmonë punë, gjithmonë Maqedoni". Gjithashtu, në një pjesë fushata u fokusua në ofertën e zgjidhjeve për problemet lokale, por edhe në përkujtimin e arritjeve paraprake të partisë. Ky koalicion, veç tjerash, u përpoq të kundërvihet me fushatë negative kundër konkurrentëve të saj, me atë që kandidatët e LSDM konkurrente i ndërlidhte me kinse rrezikun nga prurja e migrantëve dhe refugjatëve nga vendet e Lindjes së Afërt, si dhe me ndërlidhjen e kandidatëve dhe personave udhëheqës të LSDM me të dhëna për korrupsion. BDI fushatën promovuese të kandidatëve për kryetarë të komunave dhe të anëtarëve për këshillat komunal e udhëhoqi me sloganin "Për komunën që e duam". Në fushatë BDI përveç premtimeve për zgjidhjen e problemeve shumëvjeçare të bashkësive lokale, shpeshherë fokusohej edhe mbi vlera më të larta abstrakte, siç është "toleranca, solidariteti, pajtimi, konsenzualiteti, përgjegjësia, vendime të guximshme dhe fryma euro-amerikane", duke premtuar përkushtim në "ndërtimin e shtetit juridik dhe shoqërisë në të cilën do të sundoj ligji i barabartë për të gjithë". Lëvizja Besa fushatën e zhvilloi me sloganin "Për një jetë të re". Kandidatët në paraqitjet e tyre publike dhe në materialet promovuese u përqendruan në premtime për zgjidhjen e problemeve shumëvjeçare në komunat me popullatë dominante shqiptare. Partia shfrytëzoi edhe metoda të fushatës negative kundër konkurrentëve nga BDI duke i ndërlidhur ata me skandale korruptive. Aleanca për Shqiptarët fushatën e zhvilloi me sloganin "Me dije dhe guxim". Aktivitetet promovuese gjatë fushatës partia kryesisht i fokusoi ndaj qytetarëve të përkatësisë etnike shqiptare, madje në disa situata duke shfrytëzuar haptas vokabular nacionalist. Në një pjesë të fushatës u vërejt sjellje negative ndaj qytetarëve të përkatësive të tjera nacionale dhe ndaj partisë BDI.

Me monitorimin në kuadër të "Zgjedhja ime" të zbatuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) dhe IDSCS u ndoq prezenca në Internet[176] të kandidatëve të komunave. Karakteristikë për këto zgjedhje është që të gjithë kandidatët për komunat më të mëdha kishin profile të tyre në rrjetin social Fejsbuk, në të cilin i promovonin aktivitetet e tyre. Kandidatët, në pjesën më të madhe të tyre, nuk kishin Internet faqe të tyre personale, por një faqe e cila e përmblidhte të gjithë fushatën e partisë së tyre, përkatësisht koalicionit.

Nga analiza e realizuar të raporteve financiare për mjetet e shpenzuara në fushatë para rrethit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve lokale, të paraqitura në KSHZ, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) mund të konstatohet se partitë më të mëdha VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, Lëvizja Besa, PDSH,

176 Kandidatët në Facebook, "Zgjedhja ime". I aksesshëm në: http://mojotizbor.mk/izbori2017/kandidati/714-kandidatite-na-facebook-mk.html (Vizita e fundit: 13.11.2017)

Partia Aleanca për Shqiptarët, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët, OPQR dhe Levica gjithsej kanë shpenzuar 135.026.558 denarë (2.195.553 euro). Sipas raporteve të akesesshme[177] këto parti nga donacionet dhe pagesa e anëtarësisë gjithsej kanë grumbulluar 106.615.601 denarë (1.733.587 euro).

Nëse bëjmë një vështrim të veçantë, VMRO-DPMNE është partia e cila shpenzoi më së shumti gjatë fushatës edhe atë gjithsej 69.989.767 denarë (1.138.044 euro), përkatësisht përafërsisht sa gjysma e shumës së përgjithshme e cila është paraqitur si shumë e shpenzuar në fushatat zgjedhore nga të gjitha subjektet më të mëdha politike. VMRO-DPMNE paraqiti të ardhura gjatë fushatës nga donacione dhe pagesa e anëtarësisë prej 33.058.102 denarë (537.530 euro). Sipas të ardhurave të paraqitura LSDM është partia e cila grumbulloi më së shumti mjete nga donacionet, përkatësisht 52.765.931 denarë (857.982 euro). Kjo parti ka paraqitur se gjatë fushatës ka shpenzuar 31.203.177 denarë (506.368 euro).

BDI ka paraqitur se gjatë fushatës ka shpenzuar 21.303.915 denarë (346.405 euro), ndërsa grumbulloi 9.962.500 denarë (161.991 euro). Nga shpenzuesit më të mëdhenj është edhe Lëvizja Besa e cila në aktivitetet promovuese ka shpenzuar 7.081.719 denarë (115.149 euro), ndërsa nga donacione dhe pagesa e anëtarësisë ka paraqitur se ka grumbulluar 4.579.610 denarë (74.465 euro). Partia Aleanca për Shqiptarët ka paraqitur se në fushatën e saj ka shpenzuar 1,366,272 denarë (22,215 euro), përkatësisht një milion denarë më pak nga shuma e grumbulluar nga donacionet dhe pagesa e anëtarësisë e cila ishte 2.362.570 denarë (38,415 euro).

177 Raportet e partive politike, Enti Shtetëror i Revizionit. I aksesshëm në: http://www.dzr.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1073 (vizita e fundit: 14.11.2017)



Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike:

| Partia politike | Të ardhura të përgjithshme | Shpenzime të përgjithshme | Saldo |
|---|---|---|---|
| VMRO-DPMNE | 33.058.102 | 69.989.767 | -36.931.665 |
| LSDM | 52.765.931 | 31.203.177 | 21.562.754 |
| BDI | 9.962.500 | 21.303.915 | -11.341.415 |
| PDSH | 626.000 | 730.855 | -104.855 |
| BESA | 4.579.610 | 7.081.719 | -2.502.109 |
| LEVICA | 119.908 | 281.114 | -161.206 |
| Partia Politike Aleanca për Shqiptarët | 2.362.570 | 1.366.272 | 996.298 |
| Koalicioni Aleanca për Shqiptarët | 1.267.500 | 1.265.930 | 1.570 |
| OPQM | 1.873.480 | 1.803.809 | 69.671 |
| Gjithsej në denarë | 106.615.601 | 135.026.558 | -28.410.957 |
| Gjithsej në euro | 1.733.587 | 2.195.553 | -461.966 |

## MEDIA

Monitorimi mbi raportimin mediatik në lidhje me zgjedhjet u zhvillua nga çasti i shpalljes së zgjedhjeve dhe gjatë kohës së fushatës para dy rretheve të votimit nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive – ASHMAA, trup i cili është ligjërisht përgjegjës për monitorimin e mediave elektronike në procesin zgjedhor. Monitorimi i raportimit mediatik, në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës, sipas ASHMAA vë në dukje se shumica e mediave i respektojnë standardet gazetareske dhe mundësuan prezantimin e qëndrimeve të ndryshme për tema dhe çështje aktuale politike dhe shoqërore. Si përjashtim ASHMAA thekson se tek një pjesë më e vogël e mediave është regjistruar transmetimi i kontributeve të cilat janë kualifikuar si pseudo-ngjarje dhe pseudo-lajme të krijuara nga partitë

politike si premtime politike ose si kritika ndaj oponentëve politikë. Është nënvizuar se në dy shtëpi televizive vëllimi i kontributeve të këtilla për një opsion politik vë në dukje mosrespektimin e parimit profesional për trajtim të barabartë të perceptimeve të ndryshme.

Sa i përket periudhës së fushatës të rrethit të parë të zgjedhjeve lokale, e cila zgjati nga data 5 deri më 13 tetor, Agjencia ka vërejtur[178] se serviset programore në nivel shtetëror në përgjithësi siguruan kushte të barabarta për qasje deri te të gjitha format e prezantimit zgjedhor mediatik. Vërehet se një pjesë e madhe e tyre bënë përpjekje të organizojnë edhe ballafaqime debative të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Nga ana tjetër, vihet në dukje se një pjesë e kandidatëve morën pjesë në emisionet e posaçme informative tek disa media, ndërsa nuk iu përgjigjeshin ftesave të mediave tjera. Sipas ASHMAA mediat në gjuhën maqedonase në ditarët e tyre ishin fokusuar në raportimin e fushatave të dy koalicioneve, të cilët kishin numër më të madh të listave të konfirmuara me kandidatë për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë – njëri i udhëhequr nga LSDM, ndërsa tjetri nga VMRO-DPMNE. Mediat, të cilat njëkohësisht raportonin edhe në gjuhën shqipe edhe në atë maqedonase, kishin një qasje kuantitative më të balancuar gjatë raportimit. Edhe njëri edhe grupi tjetër, bënin përpjekje që në mënyrë kualitative të sigurojnë trajtim të barabartë.

Agjencia konstatoi se brenda periudhës së fushatës, para rrethit të parë të votimit, disa media, siç është TV Alfa, TV Alsat-M, TV Nova, TV 24 Vesti, TV Kompani 21-M, TV Star e shkelën Kodin Zgjedhor dhe kundër tyre ngriti procedura për kundërvajtje. Procedurë për kundërvajtje kundër TV Alfa është ngritur për shkak të mossigurimit të mbulimit të balancuar të zgjedhjeve lokale 2017, në programin e përgjithshëm, në dhjetë ditët e para të fushatë zgjedhore, si dhe për shkak të transmetimit të kontributeve me rezultate nga sondazhi i

178 Radiodifuzerët siguruan kushte të barabarta për qasje në programet në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, ASHMAA, 19.10.2017. I aksesshëm në: http://avmu.mk/радиодифузерите-обезбедија-еднакви/ (Vizita e fundit: 15.11.2017)



opinionit publik në lidhje me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, pas skadimit të afatit të përcaktuar ligjor.

ASHMAA konstatoi shkelje të Kodit Zgjedhor tek televizioni Alsat-M dhe TV Nova për shkak të tejkalimit të limitit për reklamim të paguar politik. Shkelja e TV 24 Vesti u konstatua për shkak të mosrespektimit të rregullave për shpalljen e rezultateve të sondazhit të opinionit publik, përkatësisht nuk janë theksuar të dhëna të detyrueshme për porositësin e sondazhit, për metodologjinë e aplikuar, madhësinë dhe strukturën e modelit të sondazhit dhe periudhën brenda së cilës është realizuar sondazhi. Procedura për kundërvajtje kundër TV Kompani 21-M dhe TV Star janë ngritur për shkak të transmetimit të reklamimit të paguar politik në programe të posaçme informative.

Gjatë mbulimit të fushatës para rrethit të dytë të votimit, e cila u zhvillua brenda periudhës nga 18 deri më 27 tetor, Agjencia konstatoi[179] se mediat e kanë zvogëluar intensitetin e raportimit. Së këtejmi, theksohet se dy media, TV-Nova dhe TV Alfa e kanë shkelur kërkesën për mbulim të paanshëm të zgjedhjeve. Tek këto media, në programin e përgjithshëm u konstatua njëanshmëri në favor të qëndrimeve dhe reagimeve të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Agjencia paralajmëroi ngritje të procedurave për kundërvajtje para gjykatës kompetente kundër këtyre dy televizioneve.

U konstatuan dy shkelje[180] të Kodit Zgjedhor tek dy media. Në rastin e parë bëhet fjalë për servisin e parë programor të radios maqedonase (Radio Shkupi) për shkak të transmetimit të deklaratave të ministrit të Bujqësisë, Lupço Nikollovski në emisionin për bujq gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Rasti i dytë ka të bëjë me TV Nova, e cila i shkeli kufizimet për reklamim të paguar politik. Televizioni dy herë – më 26

179 Numër i vogël i informacioneve nga fushata në rrethin e dytë, dy televizione nuk siguruan mbulim të paanshëm, ASHMAA, 03.11.2017. I aksesshëm në: http://avmu.mk/мал-обем-информации-од-кампањата-во-вт/ (Vizita e fundit: 15.11.2017)

180 U konstatuan dy shkelje të reja të Kodit Zgjedhor, ASHMAA, 30.10.2017. I aksesshëm në: http://avmu.mk/констатирани-две-нови-прекршувања-на/ (Vizita e fundit: 14.11.2017)

dhe më 27 tetor, ka transmetuar më shumë nga 8 minutat të lejuara për reklamim të paguar politik për program të transmetuar për orë reale për partitë politike opozitare.

ASHMAA vë në dukje se dispozita e Kodit Zgjedhor në lidhje me atë se si të ndahet koha në emisionet informative ditore të serviseve programore të Radiotelevizionit Maqedonas është jopërkatëse për raportimin gazetaresk të një servisi publik. Sipas kësaj dispozite, RTVM e ka për detyrë të siguroj qasje të barabartë në programin informativ, kështu që 30% të kohës do tua përkushtoj informacioneve për ngjarjet ditore nga vendi dhe bota, 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në pushtet, 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në opozitë dhe 10% të kohës për aktivitetet e partive politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvend. Sipas ASHMAA ky detyrim i krijon vështirësi servisit publik që t'i përmbahet funksionit të tij si servis publik i cili, para së gjithash, duhet t'i informoj qytetarët për të gjitha ngjarjet aktuale nga vendi dhe bota ose publikun ta privojë nga këto informacione në mënyrë që të mos e tejkaloj limitin prej 30%. Sipas Agjencisë një gjë e këtillë është vështirë e realizueshme duke e pasur parasysh se servisi doemos duhet t'u përmbahet këtyre rregullave, madje edhe në situata si në rrethin e dytë zgjedhor kur numri i kandidatëve ishte i vogël, përkatësisht i pamjaftueshëm që në mënyrë përmbajtësore të plotësohet përqindja e përcaktuar në program.[181]

Në lidhje me servsin publik RTVM dhe Kanalin e Kuvendit, Agjencia ka konstatuar se ata i kanë plotësuar obligimet e fushatës zgjedhore që të mundësojnë prezantim falas politik për pjesëmarrësit në zgjedhje. Sipas të dhënave nga monitorimi, këtë mundësi për prezantim falas e shfrytëzuan vetëm kandidatët për kryetarë të komunave nga Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe LSDM.

181 "Rregulla për mbulimin mediatik të proceseve zgjedhore (për prezantim të balancuar politik mediatik)". RTM, 29.12.2017. I aksesshëm në: http://mrt.com.mk/node/28766 (Vizita e fundit: 15.11.2017)



Nga ana e ASHMAA, u realizua edhe monitorimi mbi servisin publik radiodifuziv RTM brenda periudhave nga 5-13 tetor[182] dhe nga 18-27 tetor të vitit 2017[183]. U monitorua Servisi i parë programor RTM1, Servisi i dytë programor RTM2", Radioja maqedonase – Servisi i parë programor RM1 dhe Radioja maqedonase – Servisi i tretë programor – Programi në gjuhën shqipe RM3.

**Tabela 1: Përfaqësimi i subjekteve në zhanret informative (5 – 13 tetor, rrethi i parë) Burimi: ASHMAA**

| | RTM1 | | RTM 2 në gjuhën shqipe | | Radio maqedonase 1 | | RMSH në gjuhën shqipe | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete për fushatat e parive politike në pushtet** | | | | | | | | |
| | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja |
| **Koalicioni LSDM etj.** | 01:39:52 | 59,37 % | 00:55:05 | 32,63 % | 01:39:35 | 80,65 % | 00:24:41 | 31,84 % |
| **BDI** | 00:46:54 | 27,88 % | 01:15:37 | 44,79 % | 00:15:14 | 12,34 % | 00:29:16 | 37,76 % |
| **Aleanca për Shqiptarët** | 00:19:18 | 11,47 % | 00:36:53 | 21,85 % | 00:08:40 | 7,02 % | 00:16:40 | 21,50 % |
| **Koalicioni Aleanca për Shqiptarët** | 00:02:08 | 1,27 % | 00:01:15 | 0,74 % | / | / | 00:06:54 | 8,9 % |
| **Gjithsej** | 02:48:12 | 100 % | 02:48:50 | 100 % | 02:03:29 | 100 % | 01:17:31 | 100 % |
| **Aktivitete për fushatat e parive politike në opozitë** | | | | | | | | |
| **Koalicioni VMRO-DPMNE etj.** | 01:45:21 | 64,18 % | 00:54:42 | 32,69 % | 01:36:53 | 80,14 % | 00:25:09 | 38,49 % |
| **OPQM - Opsioni Qytetar për Maqedoninë** | 00:05:45 | 3,5 % | 00:01:21 | 0,81 % | 00:04:09 | 3,43 % | / | / |
| **Besa** | 00:35:43 | 21,76 % | 01:03:45 | 38,09 % | 00:10:23 | 8,59 % | 00:20:14 | 30,97 % |
| **PDSH – Partia Demokratike Shqiptare** | 00:17:20 | 10,56 % | 00:47:33 | 28,41 % | 00:09:29 | 7,84 % | 00:19:57 | 30,54 % |
| **Gjithsej** | 02:44:09 | 100 % | 02:47:21 | 100 % | 02:00:54 | 100 % | 01:05:20 | 100 % |

Për periudhën kohore 5-13 tetor mund të konstatohet se servisi publik edhe pse në krahasim me zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 i ka

182 Raport me shkrim për monitorimin e realizuar ".ASHMAA, 19.10.2017. I aksesshëm në: http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/08/Izvestai-od-nadzori-nad-izborno-mediumsko-izvestuvanje_19.10.2017.pdf (Vizita e fundit: 16.11.2017)

183 "Raport me shkrim për monitorimin e realizuar". ASHMAA, 03.11.2017. I aksesshëm në:http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/11/Поединечните-извештаи-за-радиодифузерите-за-периодот-од-18-до-27-октомври-2017-година.pdf (Vizita e fundit: 15.11.2017)

reduktuar dallimet e mbulimit të aktiviteteve të fushatave të partive politike në opozitë, prapëseprapë mund të konstatohet se të njëjtat akoma variojnë si ndërmjet serviseve të ndryshme në RTM, ashtu edhe ndërmjet partive politike. Sa u përket dallimeve midis partive në pushtet dhe në opozitë, Servisi i parë programor RTM1 ka siguruar 2 orë 48 minuta e 12 sekonda për partitë në pushtet, ndërsa 2 orë 44 minuta e 9 sekonda për partitë në opozitë. Servisi i dytë programor RTM2, programi në gjuhën shqipe, për aktivitetet e partive në pushtet ka siguruar 2 orë 48 minuta e 50 sekonda, ndërsa për partitë në opozitë 2 orë 47 minuta e 21 sekonda. Sa i përket Radios maqedonase – Servisi i parë programor dallimi është 3 minuta ndërmjet mbulimit të aktiviteteve të partive në pushtet në raport me partitë në opozitë. Së këtejmi, aktivitetet e fushatave të partive politike në pushtet kanë pasur 2 orë 3 minuta e 29 sekonda, ndërsa partitë në opozitë 2 orë e 54 sekonda. Në radion maqedonase – Servisi i tretë programor – programi në gjuhën shqipe dallimi është 12 minuta e 21 sekonda, e që është dallim më i madh në krahasim me serviset e tjerë. Sipas kësaj, në këtë Servis partitë në pushtet kanë pasur mbulim prej 1 orë 17 minuta e 31 sekonda, ndërsa partitë në opozitë 1 orë 5 minuta e 20 sekonda.

Në lidhje me dy partitë më të mëdha politike, në Servisin e parë programor RTM1 në aktivitetet për fushatat e Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka fituar thuaja se 6 minuta mbulim më të madh, në krahasim me ato të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM. Në Servisin e dytë programor RTM2, thuaja se nuk ekziston dallim, por megjithatë Koalicioni i udhëhequr nga LSDM ka pasur 23 sekonda mbulim më të madh, në krahasim me Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Në radion maqedonase - Servisi i parë programor, mbulim më të madh kanë pasur aktivitetet e fushatave të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM (1 orë 39 minuta e 35 sekonda). Në krahasim me Koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE (1 orë 35 minuta e 53 sekonda). Në rastin e Radios maqedonase – Servisi i tretë programor – Programi në gjuhën shqipe dallimi është 28 sekonda në dobi të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, i cili ka pasur 25 minuta e 9 sekonda në krahasim me Koalicionin e udhëhequr nga LSDM, i cili ka pasur 24 minuta e 41 sekondë.

**Tabela 2: Përfaqësimi i subjekteve në zhanret informative (18 – 27 tetor 2017, rrethi i dytë) Burimi: ASHMAA**

| | RTM1 | | RTM 2 në gjuhën shqipe | | Radio maqedonase 1 | | RMSH në gjuhën shqipe | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete për fushatat e parive politike në pushtet** | | | | | | | | |
| | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja | Kohëzgjatja | Përqindja |
| **Koalicioni LSDM etj.** | 00:28:28 | 55,84 % | 00:17:07 | 31,58 % | 00:29:16 | 83,07 % | 00:03:05 | 16,43 % |
| **BDI** | 00:14:19 | 28,08 % | 00:27:35 | 50,89 % | 00:14:19 | 16,93 % | 00:10:31 | 56,04 % |
| **Aleanca për Shqiptarët** | 00:08:12 | 16,08 % | 00:09:30 | 17,53 % | / | / | 00:05:10 | 27,53 % |
| **Gjithsej** | 00:50:59 | 100 % | 00:54:12 | 100 % | 00:35:14 | 100 % | 00:18:46 | 100 % |
| **Aktivitete për fushatat e parive politike në opozitë** | | | | | | | | |
| **Koalicioni VMRO-DPMNE etj.** | 00:30:14 | 60,41 % | 00:17:24 | 33,26 % | 00:28:33 | 97,11 % | 00:01:08 | 13,44 % |
| **Besa** | 00:13:26 | 26,84 % | 00:26:35 | 50,81 % | 00:00:51 | 2,89 % | 00:04:29 | 53,16 % |
| **PDSH – Partia Demokratike Shqiptare** | 00:06:23 | 12,75 % | 00:08:20 | 15,93 % | / | / | 00:02:49 | 33,40 % |
| **Gjithsej** | 00:50:03 | 100 % | 00:52:19 | 100 % | 00:29:24 | 100 % | 00:08:26 | 100 % |

Nga monitorimi i realizuar mbi servisin publik në periudhën 18-27 tetor 2017, Servisi i parë programor RTM1 ka siguruar 50 minuta e 59 sekonda për partitë në pushtet, ndërsa 50 minuta e 3 sekonda për partitë nga opozita. Servisi i dytë programor RTM2, Programi në gjuhën shqipe, për aktivitetet e partive në pushtet ka siguruar 54 minuta e 12 sekonda, ndërsa për partitë në opozitë 52 minuta e 19 sekonda. Një dallim më i madh mund të vërehet në Radion maqedonase – Servisi i parë programor dhe në Radion maqedonase - Servisi i tretë programor – Programi në gjuhën shqipe. Në rastin e Radios maqedonase – Servisi i parë programor 6 minuta është dallimi ndërmjet mbulimit të aktiviteteve të partive në pushtet në krahasim me partitë në opozitë. Së këtejmi, aktivitetet e fushatave të partive politike në pushtet kanë pasur 35 minuta e 14 sekonda, ndërsa partitë në opozitë kanë pasur 29 minuta e 24 sekonda. Në Radion maqedonase - Servisi i tretë programor – Programi në gjuhën

shqipe dallimi është akoma më i madh, në të vërtetë partitë në pushtet kanë pasur mbulim prej 18 minuta 46 sekonda, ndërsa partitë në opozitë 8 minuta e 26 sekonda.

Sa u përket dy partive më të mëdha politike, në Servisin e parë programor RTM1 në aktivitetet e fushatave të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka pasur 1 minutë e 26 sekonda mbulim më të madh në krahasim me ato të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM. Në Servisin e dytë programor RTM2, Programi në gjuhën shqipe, ky dallim është 24 sekonda. Situata është e kundërt në Radion maqedonase – Servisi i parë programor dhe në Radion maqedonase- Servisi i tretë programor – Programi në gjuhë shqipe ku dallimi është 1 minutë e 43 sekonda, përkatësisht 1 minutë e 57 sekonda në dobi të Koalicionit të udhëhequr nga LSDM.

Në lidhje me reklamimin e paguar politik[184] të subjekteve politike, që po ashtu monitorohet nga Agjencia, është konstatuar se në të dy rrethet e fushatës zgjedhore pjesë më të madhe të reklamimit të paguar politik ka pasur Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE (rreth 177 orë), pastaj Koalicioni i udhëhequr nga LSDM (rreth 70 orë), pastaj pason BDI (rreth 17 orë) dhe Besa (rreth 12 orë). Nga televizionet në nivel shtetëror më së shumti reklama janë transmetuar në TV Nova dhe në TV Sitel. Nga ana tjetër, lë përshtypje që përderisa shumica e televizioneve kishin reklamim të paguar politik, në vëllime të ndryshme dhe nga parti të ndryshme, televizioni Nova u fokusua mbi një burim dominant të reklamave. Me fjalë të tjera, nga gjithsej rreth 38 orë transmetim të reklamimit të paguar politik në këtë televizion, në kohën e dy rretheve zgjedhore, madje 37 orë i janë përkushtuar reklamave të Koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE, ndërkaq vetëm 1 orë partisë OPQM.

184 Pasqyra e reklamimit të paguar politik për periudhën 25 shtator – 13 tetor, ASHMAA. I aksesshëm në: http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/10/Pregled-za-plateno-politicko-reklamiraranje-za-vreme-na-prv-krug-od-lokalni-izbori.pdf (Vizita e fundit 14.11.2017).
Pasqyra e reklamimit të paguar politik për periudhën 18-27 tetor, ASHMAA. I aksesshëm në: http://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/11/Прегледот-на-платеното-политичко-рекламирање.pdf (Vizita e fundit: 14.11.2017)

**Tabela 3: Përfaqësimi i subjekteve në zhanret informative (25 shtator – 27 tetor 2017) Burimi: ASHMAA**

| | 24 Vesti | | Alsat - M | | Alfa | | Kanal 5 | | Sitel | | Telma | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | I | II | I | II | I | II | I | II | I | II | I | II |
| **VMRO-DPMNE etj.** | 03:55:51 | 01:04:43 | 02:24:38 | / | 17:32:01 | 02:45:54 | 04:57:56 | 01:03:46 | 15:32:20 | 02:45:46 | 02:12:24 | 01:06:41 |
| **LSDM etj.** | 10:31:18 | 02:41:14 | 05:59:29 | 01:34:14 | / | / | 08:34:07 | 01:27:56 | 07:31:27 | 01:46:41 | 05:04:55 | 00:45:42 |
| **BDI** | / | / | 07:16:39 | 02:49:35 | 00:06:44 | / | / | / | / | / | / | / |
| **PDSH** | / | / | / | / | 00:03:22 | / | / | / | / | / | / | / |
| **OPQM** | 00:39:00 | / | / | / | 00:02:26 | / | 00:17:57 | / | 00:34:43 | / | / | / |
| **Lëvizja Popullore për Maqedoni** | 00:06:15 | / | / | / | 00:02:00 | / | / | / | 00:06:34 | / | / | / |
| **BESA** | / | / | 01:12:23 | 00:48:48 | 00:00:34 | / | / | / | / | / | / | / |
| **Aleanca për Shqiptarët** | / | / | 00:46:20 | / | 00:04:12 | / | / | / | / | / | / | / |
| **PPD** | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| **Partia Demokratike Shqiptare** | / | / | / | / | 00:00:34 | / | / | / | / | / | / | / |

## REZULTATET E ZGJEDHJEVE LOKALE 2017

Në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, i cili u mbajt më 15 tetor të vitit 2017, në votim dolën gjithsej 1.079.876 nga gjithsej 1.814.644 votues të regjistruar në listën e zgjedhësve, me çka dalja në rrethin e parë ishte 59,51%[185]. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve, dalja u zvogëlua dhe ishte 51,92%.[186] Në krahasim me zgjedhjet e kaluara lokale nga muaji mars i vitit 2013 dalja në rrethin e parë ishte 66,81% dhe në rrethin e dytë 64,9%. Dalja në këto zgjedhje lokale gjithashtu ishte më e ulët edhe nga dalja në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat u mbajtën më 11 dhjetor të vitit 2016 e cila ishte 66,79%. Në rrethin e parë, për zgjedhjen e kryetarëve të komunave dhe kryetarit të Qytetit të Shkupit për fletëvotime të pavlefshme u shpallën gjithsej 57.023 (4,3%). Nga fletëvotimet për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit, si të pavlefshme u shpallën gjithsej 65.048 fletëvotime (5%).

Për 80 komuna dhe për Qytetin e Shkupit garuan gjithsej 223 kandidatë për kryetarë të komunave. Në mënyrë të pavarur ose në koalicion me kandidatë të tyre për kryetarë të komunave morën pjesë 17 subjekte politike prej të cilave 3 koalicione dhe 14 parti politike: Koalicioni "Për një Maqedoni më të mirë" i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët (Uniteti, RDK), VMRO-DPMNE[187], Bashkimi Demokratik për Integrim, Opsioni Qytetar për Maqedoni, Lëvizja BESA, Lëvizja për Bashkimin Nacional të Turqve, Partia Demokratike Shqiptare, Partia Demokratike e Turqve nga Maqedonia, Levica, Lëvizja Popullore për Maqedoni, Partia për Prosperitet Demokratik, Partia Politike Aleanca për Shqiptarët, Lidhja e Romëve Nga Maqedonia, Partia Social-demokrate e Maqedonisë, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM). Për anëtarë të këshillit të komunave dhe Qytetit të Shkupit gjithsej ishin paraqitur 373 lista të kandidatëve për këshilltarë nga gjithsej 19 subjekte politike.[188]

Numri më i madh i kandidatëve për kryetarë të komunave u paraqit nga LSDM dhe Koalicioni (gjithsej 70), ndërsa me lista të tyre të kandidatëve mori pjesë edhe VMRO-DPMNE (në koalicion), BDI, OPQM, Lëvizja BESA, Lëvizja për Bashkim Nacional të Turqve, (LBNT), Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë (PDTM), Koalicioni "Aleanca për Shqiptarët", LEVICA, Lëvizja Popullore për Maqedoni (LPM), Partia për Prosperitet Demokratik (PPD), Partia Politike "Aleanca për Shqiptarët", Lidhja e Romëve të Maqedonisë (LRM), Partia Social-demokrate e Maqedonisë (PSDM) dhe Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM). Përveç partive politike të lartpërmendura, morën pjesë edhe 22 kandidatë për kryetarë të komunave të mbështetur nga grup zgjedhësish. Sa u përket kandidatëve për këshilltarë, u paraqitën gjithsej 373 lista për këshilltarë prej të cilave 45 nga grupi i zgjedhësve.

Në rrethin e parë të zgjedhjeve u zgjodhën kryetarët e 45 komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Në rrethin e dytë të zgjedhjeve u votua për kryetarët e 35 komunave, ndërsa rivotim, përkatësisht rreth të tretë, kishte vetëm në Komunën e Çairit në një vendvotim që u mbajt më 12 nëntor.

Në dy rrethet, numër më të madh të vendeve të kryetarëve të komunave fitoi LSDM në 57 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. VMRO-DPMNE fitoi 5 vende të kryetarëve të komunave, BDI 9, Partia Politike "Aleanca për Shqiptarët" 3, ndërsa nga një kryetar komune fituan BESA, PDSH dhe

185 Shih: Dalja në zgjedhjet lokale, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Dalja në rrethin e parë: https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1 (vizita e fundit 14 nëntor 2017)

186 Dalja në zgjedhjet lokale, rrethi i dytë Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I aksesshëm në: https://rezultati.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1 (vizita e fundit: 14 nëntor 2017)

187 VMRO-DPMNE mori pjesë në mënyrë të pavarur në Komunën e Tearcës.

188 Përveç 17 subjekteve të theksuar politike, kandidatë të tyre për këshilltarë paraqitën dy subjekte të tjera politike, përkatësisht dy koalicione BESA, Aleanca për Shqiptarët i udhëhequr nga BDI (në Manastir, Ohër dhe Gazi Babë) dhe nga Femih Bejllurov në Gazi Babë.

PDT, ndërsa 3 vende të kryetarëve të komunave i fituan kandidatët e pavarur. Pas rivotimit më 12 nëntor BDI fitoi edhe një vend të kryetarit të komunës, me çka kjo parti në këto zgjedhje fitoi gjithsej 10 vende të kryetarëve të komunave.[189]

Për zgjedhjen e këshilltarëve të komunave LSDM fitoi 422.522 vota (39,1%). VMRO-DPMNE fitoi 335.769 vota (31%), BDI fitoi 89.724 vota (8,3%), Partia Politike "Aleanca për Shqiptarët" 49.125 (4,5%), BESA 46.493 (4,3%), PDSH 16.865 (1,56%), PDT 10.239 (0,9%) dhe LPM 4.506 (0,4%) vota. Rrjedhimisht me këtë, LSDM fitoi gjithsej 552 vende të këshilltarëve, VMRO-DPMNE 432, BDI 127, BESA 63, Partia Aleanca për Shqiptarët 63, PDSH 23, PDT 17, LPM dhe LRM 7 këshilltarë, Koalicioni i përbërë nga BDI, Aleanca për Shqiptarët dhe BESA në Manastir, Gazi Babë dhe Ohër fitoi gjithsej 4 këshilltarë në të tri komunat, OPQM, LBNT dhe LEVICA fituan nga tre këshilltarë. Nga dy këshilltarë fitoi Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Koalicioni Për Ardhmëri më të Mirë i udhëhequr nga Femih Bejllurov, ndërsa PPD fitoi një këshilltar.[190]

Për zgjedhjen e këshilltarëve në Qytetin e Shkupit, LSDM fitoi 122.711 vota (43,7%), VMRO-DPMNE - 96.922 vota (34,5%), BDI - 17.100 (6,1%), Lëvizja BESA - 13.882 (4,9%), Aleanca për Shqiptarët - 6.972 (2,4%), LEVICA 5922 (2,1%). Sipas kësaj, nga gjithsej 45 vende të këshilltarëve në Këshillin e Qytetit të Shkupit, LSDM fitoi 21, VMRO-DPMNE - 17, BDI – 3, Lëvizja BESA - 2, Aleanca për Shqiptarët – 1 dhe LEVICA – 1 këshilltar.[191]

189 Komunikatë për rezultatet e sublimuara nga votimi sipas komunave", Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 30.10.2017. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zcktLTGhMcEJxX1k/view (vizita e fundit: 08.11.2017)

190 Rezultate, Këshilli i komunave, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I aksesshëm në: https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r2&eu=All&m=All&ps=All (vizita e fundit: 14 nëntor 2017)

191 Rezultate, Këshilli i Qytetit të Shkupit, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. I aksesshëm në: https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r4&eu=All&m=All&ps=All (vizita e fundit: 14 nëntor 2017)



Pasqyra tabelore e numrit të vendeve të fituara për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë:

| **Subjekti politik** | **Numri i kryetarëve të komunave** | **Numri i këshilltarëve** |
|---|---|---|
| Koalicioni i udhëhequr nga LSDM | 57 | 552 |
| Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE | 5 | 432 |
| BDI | 10 | 127 |
| Partia politike Aleanca për Shqiptarët | 3 | 63 |
| BESA | 1 | 63 |
| PDSH | 1 | 23 |
| PDT | 1 | 17 |
| LPM | 0 | 7 |
| LRM | 0 | 7 |
| Koalicioni BDI, Aleanca për Shqiptarët dhe BESA | 0 | 4 |
| OPQM | 0 | 3 |
| LBNT | 0 | 3 |
| LEVICA | 0 | 3 |
| Koalicioni Aleanca për Shqiptarët | 0 | 1 |
| Koalicioni për Ardhmëri më të Mirë | 0 | 1 |
| PPD | 0 | 1 |
| Të pavarur | 3 | 37 |

## MBROJTJA E TË DREJTËS SË ZGJEDHJES

Kodi Zgjedhor e garanton mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes. Sipas Kodit Zgjedhor, çdo paraqitës i listës së kandidatëve dhe çdo zgjedhës ka të drejtë të parashtroj kundërshtim deri te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nëse konsideron se e drejta e tij është cenuar. Kundërshtimet nga ana paraqitësve të listave kanë të bëjmë me procedurën e votimit, sublimimin dhe përcaktimin e rezultateve, ndërsa zgjedhësit mund të paraqesin kundërshtim nëse gjatë procedurës u është cenuar e drejta e zgjedhjes. Procedura, e cila zhvillohet për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes, është urgjente, kështu që paraqitja e kundërshtimit dhe padisë në këtë rast mund të dërgohet me postë.

Kundërshtimet të cilët paraqitësit e listave i paraqesin në KSHZ doemos duhet t'i paraqesin në afat prej 48 orësh pas përfundimit të votimit, përkatësisht pas publikimit të rezultateve preliminare, ndërsa KSHZ e ka për detyrë, në afat prej 48 orësh pas pranimit të kundërshtimit, të miratoj vendim. Me vendimin të cilin e ka miratuar KSHZ njoftohet paraqitësi i kundërshtimit përmes postës elektronike, ndërsa vendimi konsiderohet se është se është dërguar në afat prej pesë orësh nga dërgimi i shkresës elektronike. Paraqitësi i kundërshtimit, për të cilin është marr vendim negativ në kuadër të KSHZ, ka të drejtë, në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit, të paraqes padi në Gjykatën Administrative. Gjykata medoemos duhet të miratoj vendim në afat prej 48 orësh pas pranimit të padisë. Gjykata Administrative mund ta konfirmoj ose ta modifikoj vendimin e KSHZ, me ç'rast vendimet e saj janë të plotfuqishme, përkatësisht kundër të njëjtave nuk mund të paraqitet ankesë ose ndonjë lloj tjetër të mjetit juridik.

Në rast të cenimit të së drejtës së zgjedhjes të zgjedhësit, i njëjti mund të paraqes kundërshtim në KSHZ në afat prej 24 orësh, ndërsa KSHZ e ka për detyrë të miratoj vendim në afat prej 4 orësh pas pranimit të kundërshtimit. Vendimi i KSHZ mund të ankimohet, kështu që në afat prej 24 orësh pas pranimit të aktvendimit mund të paraqitet padi në Gjykatën Administrative. Nëse afatet janë në rrjedhë e sipër dhe ndërpriten gjatë procesit të votimit, ndërsa vendimi është pozitiv për zgjedhësin, të njëjtit do t'i mundësohet ta realizoj të drejtën e tij të votës.[192]

Pas mbajtjes së rrethit të parë të zgjedhjeve lokale më 15 tetor të vitit 2017, në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve u paraqitën gjithsej 47 kundërshtime në lidhje me procedurën e votimit nga katër paraqitës: Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE paraqiti 43 kundërshtime[193], 2 kundërshtime paraqiti Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas (BPRM), ndërsa nga 1 kundërshtim paraqitën Aleanca për Shqiptarët (A/SH) dhe LEVICA.[194] Të gjitha kundërshtimet e paraqitura u refuzuan nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Në Gjykatën Administrative u paraqitën gjithsej 28 padi kundër vendimeve të KSHZ. Prej tyre, 24 padi i paraqiti VMRO-DPMNE, 2 padi BPRM dhe nga një padi Aleanca për Shqiptarët (A/SH) dhe LEVICA. Të gjitha paditë e paraqitura u hodhën poshtë nga ana e Gjykatës Administrative.

Pas mbajtjes së rrethit të dytë më 29 tetor, gjithsej 102 kundërshtime u paraqitën në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve nga ana e tre paraqitësve: Lëvizja BESA paraqiti 89 kundërshtime, Aleanca për Shqiptarët (A/SH) paraqiti 12 kundërshtime dhe Lëvizja Popullore për Maqedoni paraqiti një kundërshtim. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i i hodhi poshtë të gjitha kundërshtimet, ndërsa në Gjykatën Administrative u paraqitën 11 padi nga Aleanca për Shqiptarët (A/SH), katër padi nga Lëvizja BESA

192 KAS, IDSCS, Manual për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë të vitit 2016, edicioni i dytë i plotësuar. I aksesshëm në: http://www.kas.de/wf/doc/kas_47271-1522-2-30.pdf?161206080843

193 Para mbajtjes së mbledhjes së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kundërshtimeve të datës 19 tetor 2017, VMRO-DPMNE i tërhoqi tre kundërshtime, ndërsa në mbledhje tërhoqi edhe një kundërshtim.

194 "Raporti për kundërshtimet e paraqitura për procedurën e votimit, sublimimi dhe konfirmimi i rezultateve të votimit sipas listave të kandidatëve për kryetarë të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe sipas listave të kandidatëve për anëtarë të këshillave të komunave dhe Qytetit të Shkupit, i mbajtur më datë 15 tetor 2017". Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 18 tetor 2017. I aksesshëm në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zMzQ2alR4Q29FRUE/view (vizita e fundit: 10 nëntor 2017)

dhe një nga Lëvizja Popullore për Maqedoni. Gjykata Administrative i hodhi poshtë 15 padi, ndërsa e pranoi një padi të Lëvizjes BESA. Me pranimin e kësaj padie, votimi nga rrethi i dytë u përsërit në vendvotimin 2901 në Komunën e Çairit meqë numri i zgjedhësve të regjistruar në atë vendvotim kishte mundësi ta ndryshoj rezultatin përfundimtar në këtë komunë. Rivotimi u mbajt më 12 nëntor.[195]

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE NGA VËZHGUESIT

Zgjedhjet i vëzhguan gjithsej 6.082 vëzhgues. Prej tyre 5.609 vëzhgues vendor dhe 473 të huaj. Numër më të madh të vëzhguesve të akredituar vendor kishte Asociacioni Qytetar MOST me 2917 vëzhgues, pastaj Shoqata e Qytetarëve SHAH "Sinergjia" – Shtip me 2337 vëzhgues, CIVIL – Qendra për Liri me 207 vëzhgues, Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare OHRI – Shkup me 125 vëzhgues, Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional – QMBI Shkup me 17 vëzhgues dhe 6 vëzhgues nga Qendra Maqedonase për Kulturë dhe Zhvillim.[196] Në këto zgjedhje lokale kishte 3712 vëzhgues vendor më pak në krahasim me zgjedhjet paraprake lokale.

Si edhe në zgjedhjet paraprake lokale, më së shumti vëzhgues të huaj kishte Misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR me 289 vëzhgues, Ambasada e SHBA 35 vëzhgues, Delegacioni i Bashkimit Evropian 23 vëzhgues, Qendra Studimore Ndërkombëtare për zgjedhje 18 vëzhgues, Këshilli i Evropës 13 dhe Misioni i OSBE në Shkup 10 vëzhgues. Numër më të vogël të vëzhguesve kishte Zyra për Ndërlidhje e NATO-s në Shkup, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Malit të Zi, komisionet qendrore të zgjedhjeve nga Bullgaria dhe Kosova, Fondacioni Ndërkombëtar i Sistemeve Zgjedhore, si dhe Ambasada e Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Britanisë së Madhe, Irlandës Veriore, Italisë, Kosovës, Federatës Ruse, Sllovakisë, Hungarisë, Francës, Holandës, Zvicrës dhe Suedisë.

Krahas vëzhguesve vendor dhe të huaj, zgjedhjet u vëzhguan edhe nga 20 gazetarë të akredituar të huaj, nga Agjencia për Lajme nga Kosova, Al Xhazira Ballkans, Asoshieted Press, Zëri i Amerikës, Agjencia Informative Ruse TASS dhe nga TV Koha Vision.[197]

Në deklaratën e OSBE/ODIHR në lidhje me të dhënat dhe konkluzionet preliminare nga rrethi i parë theksohet se mbajtja e zgjedhjeve ka kontribuar në përforcimin e besimit ndaj procesit demokratik, me ç'rast zgjedhjet janë zhvilluar në një ambient konkurrent, kandidatët kanë pasur mundësi të zhvillojnë fushatë pa kufizime dhe janë respektuar liritë themelore. Vërejtjen e Misionit, sa i përket procesit zgjedhor, rezultojnë nga të dhëna kredibile për blerjen e votave, presion ndaj votuesve dhe rasteve të izoluara të dhunës. Në këto zgjedhje, Misioni monitorues i OSBE/ODIHR u fokusua mbi kornizën juridike dhe sistemin zgjedhor, administratën zgjedhore, fushatën zgjedhore, si dhe mbi financimin dhe mediat.[198]

Për votimin i cili u zhvillua një ditë më parë, më datë 14 tetor, ishin regjistruar 5025 persona të sëmurë dhe të pamundur, 1882 votues në burgje dhe 9 persona të zhvendosur brenda vendit. Votimi u vlerësua si i rregullt në më shumë pjesë të vendit, me parregullsi të caktuara, veçanërisht në pjesën e numërimit dhe sublimimit të votave. Votimin, nga shtëpia, i cili u mbajt më 14 tetor, OSBE/ODIHR e vlerësoi si të keq në 14 nga 96 raste të monitoruara. Fshehtësia e votimit është shkelur në 13 raste, ndërsa në 7 raste është theksuar se këshilli zgjedhor nuk e ka

195 Informacione të detajuara për të gjitha kundërshtimet dhe statusi i tyre janë të aksesshën në pjesën e veçantë të ueb-faqes së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve: https://prigovori.sec.mk/.

196 Tabela e vëzhguesve të akredituar – Zgjedhjet lokale 2017, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. E aksesshme në: https://drive.google.com/file/d/0B8ZpCwro9h-zMVBK-UEdVQjZkTnM/view (Vizita e fundit: 09 nëntor 2017)

197 Ibid.

198 Shih që të dy raportet e Misionit të OSBE/ODIHR – Misioni Monitorues Ndërkombëtar për Zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë, Zgjedhje lokale, 15 tetor 2017. Raport për të dhënat preliminare dhe konkluzionet,. Shkup 16 tetor 2017 dhe Zgjedhje lokale, rrethi i dytë, 29 tetor 2017. Raport për të dhënat preliminare dhe konkluzionet. Shkup 30 tetor 2017. I aksesshëm në: http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/339261 (Vizita e fundit 13 nëntor 2017)

përdorur paravanin për votim. Në disa burgje, për shkak të mospasjes së letërnjoftimeve të vlefshme, të dënuarit nuk janë përfshirë në listën e zgjedhësve. Për rrethin e dytë, votimi i parakohshëm u zhvillua më datë 28 tetor dhe u vlerësua pozitivisht në të gjitha 9 burgjet dhe në 40 nga 44 votimet e vëzhguara nga shtëpia. Si edhe në rrethin e parë, vlerësimi negativ ndërlidhet me fshehtësinë komprometuese të votimit dhe mungesën e kutisë së votimit.[199]

Në raportin e OSBE/ODIHR theksohet se periudha parazgjedhore e zgjedhjeve lokale u zhvillua në një mjedis i cili, në përgjithësi, e siguron respektimin e lirive themelore dhe të drejtën e shprehjes. OSBE/ODIHR potencon se nga ana e bashkëbiseduesve ishte vërejtur përmirësimi i atmosferës dhe i zhvillimit të fushatave. Tek partitë e mëdha, ishte vërejtur ndërlidhja e çështjeve nacionale të stabilitetit dhe integrimit me çështjet lokale si furnizimi me ujë, kanalizimi dhe infrastruktura. Megjithatë, për mitingjet është vënë në dukje shfrytëzimi i mesazheve negative nga ana e VMRO-DPMNE, ndërsa në masë më të vogël edhe nga LSDM. Në rrethin e dytë, fushata është intensifikuar disa ditë para votimit. Nga ana e disa partive është manifestuar shqetësimi për shkak se kryeministri ka premtuar mbështetje qeveritare për komunat me kryetarë të komunave të Koalicionit në pushtet, me ç'rast vihet në dukje mosrespektimi i parimeve të ndarjes, midis shtetit dhe partisë, në kundërshtim me obligimet të cilat rezultojnë nga anëtarësimi në OSBE.[200]

Sa i përket punës së administratës zgjedhore u vlerësua se e njëjta ka siguruar situatë, në të cilën votuesit kanë pasur mundësi t'i realizojnë të drejtat e tyre. Megjithatë, u vërejt se Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve i ka munguar transparenca e mirëfilltë sepse, ndonëse mbledhjet kanë qenë publike, megjithatë vendimet materiale janë miratuar me dyer të mbyllura. Në mënyrë plotësuese, vërejtje u dhanë edhe në drejtim të asaj se nuk janë publikuar me kohë në ueb-

[199] Ibid.
[200] Ibid.

faqen e KSHZ të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me zgjedhjet, si dhe se është vonuar fushata për edukimin e zgjedhësve. Në raportin për rrethin e dytë të zgjedhjeve vërehet se KSHZ e ka përmirësuar transparencës e tij midis dy rretheve, por megjithatë, vërehet se KSHZ nuk ka planifikuar në mënyrë përkatëse trajnime shtesë, edukim të votuesve dhe mbështetje financiare për 10 komunat me llogari të bllokuara. Lidhur me komisionet komunale zgjedhore (KKZ), vihet në dukje se transparenca e tyre ka variuar, me ç'rast misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR ka hasur në transparencë të pamjaftueshme tek 30 KKZ. Në rrethin e dytë, puna e tyre vlerësohet si pozitive, por theksohet se në më së paku një rast është vërejtur arbitrariteti politik.[201]

Raporti për të dhënat preliminare dhe konkluzionet e trajton edhe mjedisin mediat gjatë kohës së zgjedhjeve. U vlerësua se mediat janë të ndara politikisht dhe se reformat mediatike, të cilat burojnë nga amendamentet e Kodit Zgjedhor të vitit 2015 dhe 2016 akoma nuk janë zbatuar. Sipas rezultateve të monitorimit të misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR se ndonëse radiodifuzeri ka siguruar hapësirë për kandidatët, megjithatë vetëm 26 kandidatë e kanë shfrytëzuar këtë mundësi të TVM1, ndërsa asnjëri nga kandidatët që e flasin gjuhën shqipe nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi të TVM2. Vihet në dukje se informimi i RTM i ka shpërfillur partitë më të vogla politike dhe kandidatët e pavarur, me çka TVM1-shit i janë dhënë gjithsej 13% të mbulimit, ndërkaq LSDM-së i janë dhënë 37% të mbulimit të përgjithshëm, VMRO-DPMNE-së 32%, BDI-së 11% dhe BESA 7%. Tek mediat private vërehet mbulimi dominant i Koalicionit të udhëhequr nga LSDM me 47%, VMRO-DPMNE 29% dhe BDI me 17%. Në përgjithësi, vihet në dukje se mediat e monitoruara private kanë demonstruar tone neutrale ndaj kandidatëve. Së këtejmi, u vërejt se LSDM gjatë fushatës ka dhënë reklama me mesazhe negative. Në monitorimin, midis rrethit të parë dhe të dytë, u vërejt prezencë më e balancuar e subjekteve politike në servisin radiodifuziv publik me çka 25% i është përkushtuar LSDM, 24% VMRO-DPMNE, 20% BDI, 15%

[201] Ibid.

BESA dhe 9% Aleancës për Shqiptarët (A/SH). Tek kanalet private LSDM është përfaqësuar me 40% të kohës së parashikuar për mbulim informativ, VMRO-DPMNE me 35%, BDI dhe Aleancës për Shqiptarët me 9%, BESA me 4% dhe PDSH me 2%. Në këtë rreth vihen në dukje shfrytëzimi i reklamave të paguara me mesazhe me tone negative nga ana VMRO-DPMNE, ndërsa kohë pas kohe edhe nga LSDM.[202]

Vlerësimi preliminar i Asociacionit Qytetar MOST ishte se rrethi i parë i zgjedhjeve lokale u zhvillua në atmosferë të ndershme dhe demokratike, me çka qytetarëve iu mundësua që lirshëm ta japin votën e tyre. Megjithatë, janë vërejtur një sërë parregullsish më të vogla të izoluara në procesin zgjedhor, siç është fotografimi i fletëvotimeve, prezenca e paautorizuar e personave në objektet ku zhvillohej votimi, probleme teknike me materialin zgjedhor, si dhe mosrespektimi i procedurës së votimit (përfshirë edhe votimin familjar) dhe probleme të shkaktuara nga votuesit. MOST e përsëriti vlerësimin për zgjedhje të mbajtura në një atmosferë të ndershme dhe demokratike edhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve, me parregullsi të ngjashme të izoluara. Për të dy rrethet MOST vuri  në dukje punën e shpejtë dhe efikase të institucioneve, si dhe reagimin në kohë të këshillave zgjedhorë dhe policisë gjatë rasteve të izoluara të shkeljes së rregullave zgjedhore.[203]

Bashkimi Evropian u ndërlidh me të dhënat preliminare të OSBE/ODIHR për zgjedhjet lokale, me çka ato i vlerësoi si konkurrente dhe të zhvilluara në një atmosferë në të cilën janë respektuar liritë fundamentale, me parregullsi të caktuara. BE i inkurajoi qytetarët që të gjitha parregullsitë t'i denoncojnë tek institucionet kompetente, si dhe i thërriti të gjithë aktorët relevantë t'i implementojnë rekomandimet e OSBE/ODIHR, me çka do të mundësohet përmirësimi plotësues i kapaciteteve të institucioneve relevante për ciklet e ardhshme

[202] Ibid.

[203] "Deklarata preliminare", Asociacioni Qytetar MOST, 16 tetor 2017. E aksesshme në: http://most.org.mk/?option=com_k2&view=itemlist&task=category&id=165:2017&Itemid=95&lang=mk (Vizita e fundit: 13 nëntor 2017)

zgjedhore.[204] Ambasada e SHBA-së në Maqedoni, gjithashtu, iu referua të dhënave të OSBE/ODIHR se zgjedhjet ishin konkurrente dhe se respektimi i lirive fundamentale ka kontribuar në drejtim të procesit demokratik. Sipas Ambasadës, të dhënat e OSBE/ODIHR janë konsistente me ato të ekipeve të Ambasadës amerikane, të cilët i vëzhguan zgjedhjet në rrethin e parë dhe të dytë. Nëse qytetarët konsiderojnë se ka parregullsi të caktuara Ambasada i inkurajon qytetarët të njëjtat t'i denoncojnë pranë institucioneve kompetente. Ambasada e thërriti Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe trupat e tjerë relevantë qeveritarë, ta shfrytëzojnë periudhën që pason në mënyrë që t'i adresojnë rekomandimet e OSBE/ODIHR të cilat rezultojnë nga zgjedhjet e vitit 2016 dhe 2017, me çka në mënyrë plotësuese do të përforcohet procesi zgjedhor.[205]

## VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE NGA PARTITË POLITIKE

Menjëherë pas mbylljes së vendeve të votimit, rezultatet fillestare treguan se LSDM udhëheq në masë të konsiderueshme në raport me VMRO-DPMNE. Edhe pse ekzistonin vlerësime të ndryshme nga parti të ndryshme politike, megjithatë ishte evidente se partitë, një pjesë e koalicionit në pushtet, procesin zgjedhor e vlerësuan si të ndershëm dhe demokratik, ndërsa partitë e opozitës akuzuan për një sërë parregullsish. Përjashtim nga kjo ndarje ishte partia politike Aleanca për Shqiptarët, e cila si anëtare e koalicionit qeveritar akuzoi për parregullsi dhe presione nga pushteti gjatë votimit në më shumë komuna.

[204] "Deklarata e Zëdhënësit për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë". Servisi Evropian për Aksion të Jashtëm, 31 tetor 2017. E aksesshme në: https://eeas.europa.eu/delegations/former-yugoslav-republic-macedonia/34834/statement-spokesperson-municipal-elections-former-yugoslav-republic-macedonia_en (Vizita e fundit: 14 nëntor 2017)

[205] Komunikatë e Ambasadës së SHBA për zgjedhjet lokale në tetor të vitit 2017", Ambasada e SHBA në Maqedoni, 31 tetor 2017. E aksesshme në: https://mk.usembassy.gov/u-s-embassy-statement-october-2017-municipal-elections/ (Vizita e fundit: 14 nëntor 2017)

Fill pas publikimit të rezultateve preliminare, LSDM shpalli fitore në më shumë komuna dhe paralajmëroi kthesë të madhe sa u përket vendeve të kryetarëve të komunave. Po atë natë, LSDM organizoi festë për fitoren zgjedhore në platon para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë prej ku Kryetari i partisë, Zoran Zaev, deklaroi: "Ju përgëzoj për lirinë. Populli ynë e di se çka është e drejtë – të jemi të bashkuar në një shoqëri për të gjithë. Vetëm në këtë mënyrë do të ecim përpara".[206] LSDM këto zgjedhje i vlerësoi si të ndershme dhe demokratike, në të cilat qytetarët për herë të parë, pas një periudhe të gjatë, patën mundësinë të votojnë në zgjedhje të ndershme dhe demokratike, sipas vullnetit të tyre të lirë dhe pa presione. Sipas tyre, zgjedhjet treguan se si duket vullneti i qytetarëve kur votohet lirshëm dhe pa presione. Pas reagimit të VMRO-DPMNE se zgjedhjet kishin një numër të madh të parregullsive, ata e thërritën VMRO-DPMNE të mos kërkoj justifikime për dështimin zgjedhor, por t'i përgëzojë qytetarët për zgjedhjet e qeta, të ndershme dhe të lira.[207] Vlerësimin për cilësinë e zgjedhjeve, LSDM e përsëriti edhe për rrethin e dytë të datës 29 tetor dhe deklaruan se qytetarët përsëri votuan në zgjedhje të ndershme dhe demokratike, me ç'rast vendosën për ndryshime.[208]

VMRO-DPMNE zgjedhjet i vlerësoi si të parregullta dhe akuzoi për falsifikim zgjedhor. Në pres-konferencën e VMRO-DPMNE, kryetari i partisë Nikolla Gruevski deklaroi: "Dita e zgjedhjeve kaloi me një numër të madh parregullsish, uzurpim të resurseve, presione, blerje të votuesve, transportim të organizuar të qytetarëve deri te vendet e votimit dhe manipulime me fletëvotimet, vjedhje të votave." Ai paralajmëroi se partia thellësisht do t'i analizoj shkaqet, të cilat krahas parregullsive kanë penguar të fitohet rezultat më i mirë i zgjedhjeve.[209]

206 "LSDM feston, VMRO-DPMNE përjetoi debakël të rëndë". Deutsche Welle, 15 tetor 2017. I aksesshëm në: http://p.dw.com/p/2lsFh (Vizita e fundit: 14 nëntor 2017)
207 "LSDM: Rezultatet e zgjedhjeve treguan se si duken komunat kur votohet lirisht". A1 On, 20 tetor 2017. I aksesshëm në: http://a1on.mk/archives/806935 (Vizita e fundit: 14 nëntor 2017)
208 "LSDM shpalli fitore në 10 komuna, Taravari feston në Gostivar". MKD.mk, 29 tetor 2017. I aksesshëm në: https://www.mkd.mk/makedonija/politika/sdsm-proglasi-pobeda-vo-10-opshtini-taravari-slavi-vo-gostivar (Vizita e fundit: 14 nëntor 2017)
209 "Gruevski – zgjedhje jodemokratike, hapat e ardhshëm pas zgjedhjeve". Evropa e Lirë, , 15 tetor 2017. I aksesshëm në: https://www.slobodnaevropa.mk/a/28796289.html (Vizita e fundit: 14 nëntor 2017)



